

VENDIM
Nr. 50, datë 29.1.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË BASHKIMIT
EVROPIAN, NË LIDHJE ME PROGRAMIN VJETOR KOMBËTAR PËR SHQIPËRINË, PËR
VITIN 2018, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË ASISTENCËS SË PARAANËTARËSIMIT
(IPA II)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me Programin Vjetor Kombëtar për Shqipërinë, për vitin 2018, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE FINANCIMI
KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si “Komisioni” i cili vepron në emër të Bashkimit Evropian, më poshtë i referuar si “Unioni”,

nga njëra anë dhe

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në vijim, i referuar si “Përfituesi IPA II”, i përfaqësuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

nga ana tjetër,

bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Programi

1. Unioni bie dakord të financojë dhe përfituesi IPA II bie dakord të pranojë financimin e Programit në vijim:

Programi Vjetor i Veprimit për Shqipërinë, për vitin 2018;

Numri i angazhimit global (CRIS): 2018/040-211 objektivi 1;

Numri i angazhimit global (CRIS): 2018/040-215 objektivi 2.

Ky Program financohet nga Buxheti i Unionit, sipas aktit themelor në vijim: Instrumenti për Asistencën e Paraanëtarësimit, IPA II.¹

2. Kostoja totale e llogaritur e këtij programi është 152,413,671 euro dhe kontributi maksimal i Unionit në këtë Program, gjithashtu, është vendosur 94,100,000 euro.

Ky Program kërkon kontribut financiar nga të dyja palët, përfituesi IPA II dhe Unioni. Lista e kontributeve përkatëse financiare gjendet në shtojcën I.

3. Programi do të zbatohet në përputhje me përshkrimin e parashikuar në shtojcën I që detajohet më tej në dokumentet e veprimit, për të cilat do të bihet dakord nëpërmjet shkëmbimit të letrave ndërmjet Komisionit dhe përfituesit IPA II.

¹ Rregullorja (BE) nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 mars 2014, mbi krijimin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), GZ L 77, 15.3.2014, faqe 11.

Neni 2

Periudha e ekzekutimit dhe periudha e zbatimit operacional

1. Periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi, siç përcaktohet në nenin 12, të shtojcës II (Kushtet e përgjithshme) është vendosur për 12 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi

2. Kohëzgjatja e periudhës së zbatimit operacional, siç përcaktohet në nenin 12, të shtojcës II (Kushtet e përgjithshme) është caktuar për 6 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 3

Adresat dhe komunikimi

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes së Financimit do të bëhen me shkrim dhe do t'i referohen shprehimisht këtij Programi, siç përcaktohet në nenin 1(1) dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

1. Për Komisionin

Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR)

Drejtoria D

Rue de la Loi 15

B-1049 Bruksel

Belgium (Belgjikë)

Adresa funksionale *email-it*: NEAR-D4@ec.europa.eu

2. Për përfituesin IPA II

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Bulevardi “Gjergj Fishta”, nr. 6

Tiranë, Shqipëri

Adresa *email-it*: info@mfa.gov.al

Neni 4

Pika e kontaktit e OLAF-it

Pika e kontaktit të përfituesit IPA II që gëzon kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane Antimashtrim (OLAF), me qëllim që të lehtësojë aktivitetet operacionale të OLAF-it, do të jetë z. Bejko Late - Ministria e Financave - Drejtoria e Inspektimit Financiar (Bejko.Late@financa.gov.al).

Neni 5

Marrëveshja Kuadër

Programi do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, mbi marrëveshjet për zbatimin e asistencës financiare të Unionit për Shqipërinë, sipas Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), i cili ka hyrë në fuqi në datën 16 prill 2015 (në vijim e referuar si “Marrëveshja Kuadër”). Marrëveshja e Financimit plotëson dispozitat e Marrëveshjes Kuadër. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të Marrëveshjes së Financimit nga njëra anë dhe dispozitave të Marrëveshjes Kuadër nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi.

Neni 6

Shtojcat

1. Marrëveshja e Financimit përbëhet nga:

a) këto kushte të veçanta;

b) shtojcë I: Programi Kombëtar i Veprimit për Shqipërinë për vitin 2018, ku përshkruhen hollësisht objektivat, rezultatet e parashikuara, aktivitetet, përshkrimi i detyrave të besuara për zbatimin e buxhetit dhe buxheti i Programit;

c) shtojcë IA: Mbështetje Buxhetore - BE për Reformën në Drejtësi;

d) shtojcë II: Kushtet e përgjithshme;

e) shtojcë III: Model raporti vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II, sipas neneve 58 dhe 59(1) të Marrëveshjes Kuadër;

f) shtojcë IV: Model raporti financiar, sipas nenit 59(2) të Marrëveshjes Kuadër;

g) shtojcë V: Specifikimet minimale të sistemit të kontabilitetit me bazë shtimi.

2. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të shtojcave nga njëra anë dhe dispozitave të kushteve të veçanta nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të shtojcës I dhe/ose shtojcës IA nga njëra anë dhe dispozitave të shtojcës II nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të shtojcës I nga njëra anë dhe dispozitave të shtojcës IA nga ana tjetër, e para do të ketë përparësi.

Neni 7

Dispozita që përjashtojnë ose plotësojnë shtojcën II

Transferrat me monedha të huaja do të llogariten sipas kursit të ditës kur njoftohet krediti/kredia në llogarinë e Thesarit nga Banka e Shqipërisë. Kursi i këmbimit valutor për qëllime raportimi - tabela fiskale e qeverisë - do të konsiderohet kursi i shkëmbimit monetar i caktuar nga Banka e Shqipërisë në ditën kur kryhet transferimi i vlerës së monedhave të huaja - shkëmbimi i huaj fiks i lekut i përcaktuar në vendimin nr. 66, datë 30 gusht 2006, i Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë, dhe dispozitat e mëvonshme.

Nuk është e mundur të rishpërndahen fondet midis shumës prej 64,000,000 eurosh të numrit të angazhimit global 2018/040-211 dhe shumës prej 30,100,000 eurosh të numrit të angazhimit global 2018/040-215.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi, për vitin 2018, hyn në fuqi në datën kur është nënshkruar nga pala e fundit, jo më vonë se data 31 dhjetor 2019.

Kjo Marrëveshje Financimi hartohet në dy kopje në gjuhën angleze, njëra i dorëzohet Komisionit dhe kopja tjetër i dorëzohet Përfituesit IPA II.

Për Përfituesin IPA II:

Z. Sokol Dedja

Zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme

Koordinator Kombëtar i IPA-së

Bulevardi "Gjergj Fishta", nr. 6

Tiranë, Shqipëri

Datë 10.7.2019

Për Komisionin:

Znj. Genoveva Ruiz Calavera

Drejtor

Komisioni Evropian

DG NEAR / D

Rue de la Loi 15

B-1049 Brussels, Belgium (Belgjikë)

Datë 16.5.2019

INSTRUMENTI PËR PARAAANËTARËSIMIN (IPA II)
2014–2020

SHTOJCË IA
MBËSHTETJA BUXHETORE

Përmbledhje e veprimit

Qëllimi i këtij veprimi është të kontribuojë në forcimin e shtetit të së drejtës, zbatimin e ligjit dhe uljen e nivelit të korrupsionit në agjencitë qeveritare dhe sistemin gjyqësor. Gjithashtu, veprimi do të ndikojë në forcimin e pavarësisë, transparencës, eficiencës, llogaridhënies dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor shqiptar, në përputhje me standardet evropiane, si dhe përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e burgjeve.

Veprimi mbështet zbatimin e Strategjisë së Sektorit të Drejtësisë për një kuadër institucional të përmirësuar dhe për një eficiencë operationale të sistemit gjyqësor, edukim ligjor të konsoliduar, si dhe specializim të gjyqtarëve dhe personelit të gjyqësorit; rritje të eficiencës së sistemit të drejtësisë penale dhe të masave antikorrupsion; përmirësim të funksionimit të sistemit gjyqësor, duke përdorur procedura moderne, sisteme TI dhe pajisje elektronike e mjete për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut në sistemin e burgjeve; edhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të profesionistëve të ligjit.

Identifikimi i veprimit	
Titulli i programit të veprimit	Programi i Veprimit për Shqipërinë, IPA 2018
Titulli i veprimit	BE për reformën në drejtësi
ID-ja e veprimit	IPA 2018/040211 /Shqipëri/BE për reformën në drejtësi
Informacioni për sektorin	
Spektori i IPA II	Shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore
Spektori DAC	15130 - Zhvillimi ligjor dhe juridik
Buxheti	
Kostoja totale	42 milionë euro
Kontributi i BE-së	42 milionë euro
Linja buxhetore	22.02.01.01
Menaxhimi dhe zbatimi	
Metoda e zbatimit	Menaxhim direkt
Delegacioni i BE-së i ngarkuar	Shqipëri
Përgjegjësitë e zbatimit	Ministria e Drejtësisë (MD) si Koordinatori Kombëtar për reformën në sektorin e drejtësisë, si dhe institucionet e tjera përkatëse, përgjegjëse për zbatimin e reformës në drejtësi Ministria e Financave dhe Ekonomisë (koordinatori për mbështetjen buxhetore sektoriale)
Vendi	
Zonat që përfitojnë nga ky veprim	Shqipëria
Afati kohor	
Afati për nënshkrimin e Marrëveshje/ve të Financimit me Përfituesin IPA II	Jo më vonë se data 31 dhjetor 2019
Afati për nënshkrimin e marrëveshjeve të delegimit me menaxhim të tërthortë	3 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit
Afati për mbylljen e prokurimeve dhe kontratave të grantit	3 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit, me përjashtim të rasteve të përmendura në nenin 189(2) të Rregullores Financiare
Afati për zbatimin	6 vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit

operacional	
Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit (data deri kur ky program duhet të anulohet ose të mbyllet)	12 vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit

Objektivat/ treguesit e politikave (formulari DAC)			
Qëllimi i përgjithshëm i politikave	Nuk synohet	Objektivi i rëndësishëm	Objektivi kryesor
Rritje e pjesëmarrjes/ qeverisje e mirë	☐	☐	X
Ndihma për mjedisin	X	☐	☐
Barazia gjinore (duke përfshirë gratë për zhvillimin)	☐	x	☐
Zhvillim i tregut	X	☐	☐
Shëndeti riprodhues, amënor, i të sapolindurve dhe i fëmijëve	X	☐	☐
Treguesit e Konventës së RIO-s	Nuk synohet	Objektivi i rëndësishëm	Objektivi kryesor
Diversiteti biologjik	X	☐	☐
Luftimi i dezertifikimit	X	☐	☐
Lehtësim të ndryshimeve klimatike	X	☐	☐
Përshtatje me ndryshimet klimatike	X	☐	☐

LISTA E SHKURTIMEVE

AAASK	Agjencia për Administrimin e Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara
DHA	Dhoma e Apelit
KBF	Komiteti i Birësimit të Fëmijëve
PV	Plan veprimi
AWEN	Rrjeti i fuqizimit të grave
KPA	Kodi i Procedurave Administrative
GJK	Gjykata Kushtetuese
MSIRGJ	Menaxhimi i Sistemit Informativ, sipas rasteve gjyqësore
KM	Këshilli i Ministrave
QBZ	Qendra e Botimeve Zyrtare
ILSHC	Instrumenti Lehtësues për Shoqërinë Civile
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
DG NEAR	Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit
EDIHR	Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut
EITI	Iniciativa për Transparencën e Industrive Nxjerrëse
ERP	Programi për Reformën Ekonomike
DBE	Delegacioni i Bashkimit Evropian
EURALIUS	Konsolidimi i Sistemit Gjyqësor në Shqipëri
IML	Instituti Mjekoligjor
DGE	Drejtoria e Përgjithshme e Zbatimit
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
GP	Prokurori i Përgjithshëm
PP	Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm
GJL	Gjykata e Lartë
KLD	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
KLD	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
HIDAA	Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin të Pasurive

KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
ILD	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimeve
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IMO	Veprimtaria Ndërkombëtare Monitoruese
IPA	Instrumentet e Paraanëtarësimit
DSIK	Dokumenti Strategjik Indikativ Kombëtar
TIC	Qendra për Teknologjinë e Informacionit
JAC	Këshilli i Emërimeve në Drejtësi
JHA	Drejtësia dhe Punët e Brendshme
LGBTI	Lesbikë, gej, biseksualë, transgjinorë dhe interseks
NNJ	Ndihma e Ndërsjellë Juridike
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

MFE Ministria e Financës dhe Ekonomisë

MD Ministria e Drejtësisë

PBA Plani Buxhetor Afatmesëm

BKH Byroja Kombëtare e Hetimeve

DHKA Dhoma Kombëtare e Avokatit

NKN Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve

DHKPGJP Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë

SKZHI Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

ZABGJ Zyra për Administrimin e Buxhetit të Gjyqësorit

OBS Anketimi mbi Buxhetimin e Hapur

PAMECA Konsolidimi i Agjencive Ligjzbatuese

RAP Reforma në Administratën Publike

KP	Komisioneri Publik
PEFA	Shpenzimet publike dhe llogaridhënia financiare
MFP	Menaxhimi i financave publike
SHP	Shërbimi i Provës
ROM	Monitorimi i bazuar te rezultatet
MBS	Mbështetja buxhetore sektoriale
KSHNJ	Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike
SND	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë, 2017–2020
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SPAK	Strukturat e Posaçme Antikorrupsion
TADAT	Vlerësimi i administrimit të taksave
VLТ	Vlerësimi i legjislacionit mbi transparencën

UN CEDAW Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas
 PNUD Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

UNIFEM Fondi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë

1. ARSYETIMI

PROBLEMET DHE ANALIZA E GRUPEVE TË INTERESIT

Sistemi shqiptar i drejtësisë është përballur me sfida të shumta që nga miratimi i Kushtetutës në vitin 1998, të cilat kanë të bëjnë me integritetin, pavarësinë, eficiencën, përgjegjshmërinë dhe transparencën që kanë sjellë mungesën e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Këto **sfida janë trajtuar në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra, pa një qasje të koordinuar dhe pa një zgjidhje të unifikuar**. Gjatë gjithë këtyre viteve është përgatitur një sasi e madhe legjislacioni dhe janë ngritur një sërë institucionesh. Për të mbështetur institucionet e sistemit të drejtësisë, institucione të reja janë prezantuar në mënyrë graduale, të tilla si: shërbimi i provës, përmbaruesit privatë dhe ndihma ligjore në vitin 2008. Zgjidhja alternative e konflikteve në formën e ndërmjetësimit u prezantua përgjatë vitit 2011, ndërsa gjykatat administrative filluan të funksiononin në vitin 2013, në dy shkallë: shkallën e parë dhe atë të apelit. Një kolegji administrativ i veçantë është krijuar në Gjykatën e Lartë për aktgjykimet e nivelit të tretë.

Janë bërë përpjekje për të mbështetur sistemin e drejtësisë me sisteme të teknologjisë së informacionit. Që nga viti 2005 një sistem informacioni i integruar për menaxhimin e çështjeve është vënë në zbatim në gjykata dhe mbulon si çështjet civile dhe penale. Megjithatë, ky sistem nuk i ka përmbushur të gjitha pritshmëritë dhe nuk iu ka siguruar gjykatave një sistem të mirëfilltë të menaxhimit të çështjeve. Që nga viti 2012 sistemet e regjistrimit digjital audio janë instaluar gati në të gjitha gjykatat në vend, duke përfshirë dhe Arkivin Qendror të Regjistrimeve Digjitale Audio. Një sistem menaxhimi i çështjeve, CAMS, është zhvilluar dhe instaluar në zyrat e prokurorisë së Shqipërisë. Gati i gjithë legjislacioni që rregullon funksionimin e institucioneve të mësipërme, të cilat përbëjnë dhe sistemin e drejtësisë, kanë qenë objekt i ndryshimeve të vazhdueshme apo i korrigjimeve të plota. Nuk janë hartuar në mënyrë të saktë dhe kanë importuar modele të huaja pa i shqyrtuar përpara dhe që të mund t'i përshtatnin duke pasur parasysh nevojat dhe kapacitetet e brendshme. Si rezultat i konflikteve midis sistemeve të ndryshme ligjore, sistemi shqiptar i drejtësisë vazhdon të jetë në tranzicion, ende i paorientuar, si dhe nuk është koherent.

Në vitin 2011, gjatë një përpjekjeje për një qasje të koordinuar të sistemit të drejtësisë, Këshilli i Ministrave miratoi Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe planin e saj të veprimit për vitin 2011–2013, i cili synonte të rriste aksesin ndaj drejtësisë dhe të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Zbatimi i kësaj Strategjie kontribuoi në përmirësimin e funksionimit të një sërë institucionesh të sistemit të drejtësisë. Ato u orientuan drejt eficiencës funksionale të institucioneve, bashkëpunimit dhe koordinimit të aktivitetit të tyre. Strategjia dhe Plani i Veprimit përfunduan fazën e tyre të zbatimit në fund të vitit 2013. Analiza e zbatueshmërisë së Strategjisë tregoi që ishte zbatuar në një shkallë të gjerë. Megjithatë, sistemi i drejtësisë vazhdon ende të përballët me sfida dhe probleme të mëdha. Një numër i rëndësishëm ndërhyrjesh të nevojshme në legjislacion nuk u miratuan në atë kohë, të tilla si: ligji për Gjykatën Kushtetuese, ligji për Ministrinë e Drejtësisë, ligji për Zyrën e Administrimit të Buxhetit etj.

Në rrethana të tilla, një **Komision Parlamentar *Ad Hoc* mbi Reformën në Drejtësi** u krijua në nëntor të vitit 2014 dhe udhëhoqi punën e tij në tri faza kryesore.

Gjatë **fazës së parë**, Komisioni krijoi një grup me ekspertë të nivelit të lartë që do të mund të kryenin një analizë të sistemit të drejtësisë në Shqipëri dhe të përgatiste një dokument analitik, i cili detajonte rezultatet kryesore mbi problemet e identifikuara në sistemin e drejtësisë.

Problemet kryesore të identifikuara në dokumentin analitik janë të lidhura ndarjen e pamjaftueshme të pushteteve, veçanërisht, midis ekzekutivit dhe gjyqësorit; kriteret dhe procedurat e emërimeve për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme; statusit të gjykatësve dhe prokurorëve; procesi i procedimeve disiplinore për gjykatësit dhe prokurorët; aftësitë e dobëta administrative në sektorin e drejtësisë; shpërndarja e pamjaftueshme e buxhetit për infrastrukturën e gjykatave dhe pagat e gjyqtarëve dhe niveli fillestar dhe edukimi i vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët.

Roli ekskluziv i ministrit të Drejtësisë për të iniciuar procedimet disiplinore kundër gjyqtarëve është konsideruar si problematik dhe që binte ndesh me parimet e BE-së. Procesi i emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka qenë i pamjaftueshëm, jotransparent dhe pa rregulla të qarta për mbarëvajtjen e procesit. Caktimi i gjyqtarëve të **Gjykatës së Lartë**, përfundimi i mandatit të tyre, qëndrimi në detyrë përtej mandatit, largimi nga detyra, dorëheqja dhe përgjegjësitë disiplinore të një gjyqtari rezultuan si problematike. Në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë mungesat ishin të lidhura me pushtetin e saj për rishikimin e vendimeve dhe juridiksionin fillestar të cilat u bënë të ditura.

Në përgjithësi, gjykimi i çështjeve nga gjykatat në të tria nivelet nuk do të garantonte plotësisht **gjykimin në një kohë të arsyeshme**. Statusi i gjyqtarëve nuk është i rregulluar qartë nga legjislacioni. Njëkohësisht, legjislacioni nuk ka qenë i qartë në lidhje me procedurat dhe kriteret për caktimin e gjyqtarëve, vlerësimin e tyre profesional dhe zhvillimin e karrierës. Sistemi i pagave, shpërblimeve dhe kontributi shoqëror dhe shëndetësor i gjyqtarëve nuk u është përgjigjur nevojave të tyre për një trajtim financiar dinjitoz, si dhe natyrës së përgjegjësive të funksionit të gjyqtarit dhe të shkallës së tyre të vështirësive.

Nuk ka kriteret kushtetuese themelore për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilët zgjidhen nga Asambleja. Kërkohej që minimumi i maxhorancës të jetë 36 vende për votimin e tyre në Asamble dhe nuk kanë siguruar pavarësinë e tyre.

Njëkohësisht, Kushtetuta, gjithashtu, nuk ka specifikuar kriteret themelore, të cilat duhet të kenë një kandidat për Prokuror të Përgjithshëm. Kërkohej aprovimi i Asamblesë me një minimum votash të shumicës (36 vende) dhe nuk kanë të siguruar mbështetjen nga legjislativi apo pavarësinë. Organizimi hierarkik ka shkaktuar konflikt midis prokurorëve të niveleve të ndryshme. Mungesa e llogaridhënies së Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm vazhdon që të mbetet një shqetësim.

Megjithëse është konceptuar si një organ përfaqësimi i prokurorëve, Këshilli i Prokurorisë nuk ka ndikim të rëndësishëm në karrierën e prokurorëve, emërimin, transferimin, disiplinimin dhe promovimin e tyre. Opinionet e tij janë vetëm të natyrës këshilluese dhe nuk kanë fuqi veprimi mbi Prokurorin e Përgjithshëm. Nuk funksionon si një organ i pavarur legjislativ nga autoriteti i Prokurorit të Përgjithshëm dhe nuk ka fuqi vendimmarrëse.

Shkolla e Magjistraturës dhe ndikimi i saj në formimin e gjykatësve dhe prokurorëve të ardhshëm është një histori suksesi. Megjithatë, ky institucion, për sa u përket kushteve të trajnimit fillestar po has vështirësi në rekrutimin e kandidatëve, për shkak të vështirësive në vlerësimin e kriterëve të integritetit, etikës, sjelljes sociale dhe morale, ndershmërisë etj. Në lidhje me trajnimin e vazhdueshëm, është vënë re që ka një mungesë ndërgjegjësimi të gjyqtarëve dhe të prokurorëve për nevojën e trajnimit të vazhdueshëm. Një problem tjetër kryesor i identifikuar në Shkollën e Magjistraturës është mungesa e mjedisve të përshtatshme dhe të nevojshme për akomodimin e studentëve dhe organizatave për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm.

Problemi kryesor i identifikuar, për sa u përket sistemit të burgjeve, lidhet me kushtet fizike të burgjeve dhe mbipopullimin e tyre. Ka një mungesë të institucioneve të përshtatshme për ekzekutimin e masave edukuese dhe mjekësore, duke e bërë këtë të fundit gati të pamundur. Për më tepër, ndryshimet e vazhdueshme të stafit të burgjeve dhe policisë së trajnuar kanë çuar në kufizime në efektivitetin e tyre.

Shërbimi i Provës nuk është përkufizuar në statusin e Kodit të Procedurave Penale dhe pozita e tij procedurale nuk ka qenë e qartë nga ana ligjore. Alternativat e tjera ndaj burgosjes nuk janë të mirërregulluara në ligjin ekzistues. Nuk ka një sërë rregullash të qarta në lidhje me hartimin e një raporti

vlerësimi nga shërbimi i provës, prokuroria apo gjykata. Praktika ka treguar që në pak raste të mëparshme të gjykimit, prokurorët apo gjykatësit kanë treguar një raport vlerësimi nga shërbimi i provës.

Sistemi i **ndihmës ligjore** ka rezultuar joefektiv në një sërë çështjesh, duke përfshirë dhe pagesat e ulëta brenda sistemit dhe ato që janë paguar nga buxheti i gjykatave apo i zyrës së prokurorit. Ndhma ligjore ka rezultuar problematike edhe me përzgjedhjen e avokatëve që prezumohet të ofrojnë ndihmën ligjore.

Në përgjithësi, çështjet e identifikuar në lidhje me **profesionin ligjor** lidhen me profesionin, performacën eficiente për të garantuar një shërbim sa më të mirë për qytetarët, rolin e zyrave për kriteret hyrëse në profesion, si dhe përgjegjshmërinë për ushtrimin e lirë të profesionit.

Sa më sipër është një përshkrim i qartë që ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë janë bërë rast pas rasti dhe këto ndërhyrje kanë qenë të pakoordinuara midis tyre dhe të fragmentuara. Për të trajtuar të gjitha sa më sipër nga një pikëpamje rregulluese dhe për të ndërmarrë një qasje të përgjithshme për reformën e drejtësisë, **në fazën e dytë**, bazuar në rezultatet e Dokumentit Analitik të Komisionit Parlamentar *Ad Hoc* për Reformën në Drejtësi, është miratuar me vendimin nr. 15, datë 30.7.2015, “**Strategjia për reformën e sistemit të drejtësisë dhe plani i saj i veprimit**”. Kjo Strategji përcakton objektivat e përgjithshëm dhe specifike të reformës në sistemin e drejtësisë dhe ndërhyrjet e nevojshme kushtetuese dhe ligjore për arritjen e këtyre objektivave. Plan i Veprimit është më shumë një listë me aktivitete për t’u kryer dhe ndërhyrje ligjore që fillojnë nga amendamentet kushtetuese e deri tek amendamentet e ligjeve të tjera të aprovuara, të cilat kanë riformuar strukturën e sistemit të drejtësisë, duke krijuar institucione të reja dhe duke ristrukturuar ato ekzistueset. Plan i Veprimit i komisionit parlamentar është plotësisht i përqendruar në nismat legislative.

Gjatë **fazës së tretë**, pas miratimit të **amendamenteve kushtetuese**, me ligjin nr. 76/2006 të 21 korrikut 2016, si një arritje e parë e reformës në drejtësi, Komisioni filloi hartimin dhe dorëzoi për miratim të komponentëve të tjerë të paketës legislative. Kjo paketë e parë e ligjeve është miratuar pas amendamenteve të Kushtetutës dhe përfshin, si një çështje prioritare, legjislacionin që duhet në mënyrë më urgjente, të tilla si: ligji nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Mbi vlerësimin e përkohshëm të gjykatësve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 95/2016, datë 6.10.2016, “Mbi organizimin dhe funksionimin e institucioneve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”; ligji nr. 97/2016, datë 6.10.2016, “Mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 97/2016, datë 6.10.2016, “Mbi organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 98/2016, datë 6.10.2016, “Mbi organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 99/2016, datë 6.10.2016, “Mbi disa ndryshime në ligjin për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji nr. 115/2016, datë 3.11.2016, “Mbi organizmat qeverisës të sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Aktiviteti i Komisionit Parlamentar *Ad Hoc* mbi Reformën në Drejtësi përfundoi në dhjetor 2016. Të gjitha draftet e ligjeve të përgatitura deri në atë ditë u kaluan në Komisionin e Ligjeve për një shqyrtim të mëtejshëm. Në vijim të paketës së parë të ligjeve, gjatë vitit 2017, një numër i rëndësishëm ligjesh u amenduan ose u vunë në zbatim për herë të parë. Këto ishin: Kodi Penal dhe Kodi i Procedurave Penale, Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit, Kodi i Procedurave Civile dhe ligji “Mbi deklarinimin e auditimit të aseteve, detyrimeve financiare të personave të përzgjedhur dhe disa punonjësve publikë”, ligji “Mbi parandalimin e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër aseteve”, ligji “Mbi masat kundër financimit të terrorizmit”, ligji “Mbi parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit”, ligji “Mbi mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, ligji “Mbi përgjimin e komunikimeve elektronike”, ligji “Tarifat e gjykatave në Republikën e Shqipërisë”, ligji “Mbi ndihmën ligjore të garantuar nga shteti” dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”.

Miratimi i paketës së parë të ligjeve mundësoi fillimin e zbatimit të reformës në drejtësi. Kështu, hapi i parë ishte që të fillonte vlerësimi i përkohshëm i gjyqtarëve dhe i prokurorëve, i njohur edhe si procesi i vetëingut i cili synonte ‘pastrimin’ e gjyqësorit dhe prokurorisë nga zyrtarët e korruptuar.

Më 17 qershor 2017 Parlamenti votoi një listë të konsoliduar të 27 kandidatëve të përzgjedhur nga një komitet *ad hoc* në një sesion plenar të jashtëzakonshëm më 14 dhe 17 qershor 2017. Mbi të gjitha, procesi kompleks i votimit u udhëhoq pa kundërshtime nga anëtarët *ad hoc* të komisionit, me praninë e plotë të mediave.

Procesi i vetëingut udhëhiqet nga një Komision i Pavarur i Kualifikimit, i përbërë nga 12 komisionerë të organizuar në katër panele me tre anëtarë secili dhe me një mandat 5-vjeçar; dhe me një Dhomë të Specializuar të Apelit që do të shqyrtojë apelit kundër vendimeve të Komisionit të dorëzuar nga të vlerësuarit apo nga Komisioneri Publik. Është i përbërë nga 7 gjyqtarë me një mandat 9-vjeçar, i ndarë në panele të përbëra nga 5 anëtarë. Komisionerët Publikë, të përzgjedhur për një mandat 5-vjeçar, kanë të drejtë që të apelojnë vendimet e Komisionit brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit përpara Dhomës së Apelit. Këto organe kushtetuese janë përgjegjëse për rivlerësimin e pohimeve të aseteve, vlerësimit të origjinës së tyre dhe të aftësisë në punë, nëpërmjet një procedure hetimi administrative të gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, dhe zyrtarëve të tjerë, siç janë parashikuar në nenet përkatëse të aneksit të amenduar të Kushtetutës.

Organet e vetëingut kanë hyrë në fuqi në vjeshtë të vitit 2017 dhe shumata e para janë tërhequr në nëntor të vitit 2017. Që nga fillimi i procesit, disa gjyqtarë dhe prokurorë kanë dorëzuar dorëheqjen e tyre, si pasojë e presionit të vetëingut. Subjektet e para që kanë prioritet të kalojnë vetëingun janë 54. Dëgjesa e parë është mbajtur më 21 mars 2018. Procedimi i ngadaltë dhe dorëheqjet e gjyqtarëve po e prekin sistemin e drejtësisë si të tërë. Kështu, aktiviteti i Gjykatës Kushtetuese është pezulluar, për shkak të paaftësisë për të formuar kuorumin e duhur për vendimmarrje, sepse disa anëtarë të saj nuk e kanë kaluar procesin e vetëingut.

Efektet tjetër i procesit të vetëingut është i lidhur me vendosjen e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, të tilla si: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorëve dhe Inspektorati i Lartë i Drejtësisë. Vendosja e institucioneve të reja do të bëhet e mundur vetëm pasi një numër i mjaftueshëm i kandidaturave nga gjyqtarë dhe prokurorë që po konkurrojnë për një pozicion kalojnë vetëingun me sukses dhe më pas përzgjidhen sipas procedurave. Krijimi i institucioneve të reja është objektiv tjetër i rëndësishëm për zbatimin e reformës. Ai do të mendojë krijimin e një strukture të specializuar (gjykata, prokuroria dhe zyra hetimore) për të luftuar korrupsionin, riorganizimin e shërbimit të prokurorit, riorganizimin e hartës gjyqësore, rritjen e statusit për gjyqtarët dhe prokurorët, përmirësimin e sistemit për luftimin e korrupsionit, rritjen e aksesit ndaj drejtësisë nëpërmjet sistemit të ndihmës ligjore të përmirësuar dhe rishikimin e tarifave të gjykatave etj., duke ngritur në këtë mënyrë themelet e një sistemi drejtësie të përgjegjshëm dhe të ndershëm.

Reforma e përgjithshme e sektorit të drejtësisë është e bazuar në **Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planin e saj të Veprimit**, e miratuar më 2 nëntor 2016 nga Këshilli i Ministrave. Kjo Strategji përfshin dhe Strategjinë parlamentare dhe jep një panoramë të plotë se çfarë duhet për këtë reformë dhe sistemin e plotë të drejtësisë. Është dokumenti kryesor politik për reformën në sektorin e drejtësisë dhe përmban një sërë aktiviteteve ligjore për të identifikuar aktivitetet ligjore, administrative dhe të natyrës organizuese. Ai vendos periudhën kohore kur këto veprime do të zbatohen dhe se çfarë është më e rëndësishme bazohet nga vlerësimet financiare të kostove që nevojiten, në mënyrë që reforma të shkojë përpara.

Çështjet dhe nevojat kryesore të identifikuar nga Strategjia e drejtësisë dhe që duhen trajtuar në afate të shkurtra dhe afatmesme, janë si më poshtë:

- ngritja e institucioneve të reja për sistemin e drejtësisë;
- edukimi ligjor i aktorëve kryesorë të sistemit të drejtësisë;
- sigurimi i infrastrukturës për institucionet e sistemit të drejtësisë;
- sigurimi i sistemit të teknologjisë së informacionit të menaxhimit të çështjeve për gjykatat dhe institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë;
- përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese për institucionet e sistemit të drejtësisë;
- rritja e aksesit ndaj drejtësisë;
- rritja e statusit të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- lufta ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke ngritur një strukturë të veçantë të policisë, prokurorisë dhe nivelit të gjykatave;
- reduktimi i mbipopullimit dhe përmirësimi i kushteve për sistemin e burgjeve për të burgosurit;
- përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera të varësisë;
- rritja e shërbimeve dhe e veprimit të ofruar për shërbimet ligjore falas.

Këto nevoja janë përpunuar më hollësisht dhe janë mbuluar nga objektivat e Strategjisë në faqen 15.

Veprimet mbështetëse të BE-së, të deritanishme ose ato që do të fillojnë së shpejti, do të trajtojnë disa nga çështjet e mësipërme, duke u përqendruar më shumë tek institucionet e reja të sistemit të

drejtësisë, sistemi gjyqësor penal, duke përfshirë edhe shërbimet e prokurorisë dhe sistemit të burgjeve, krijimin e strukturave të reja antikorrupsion etj. Në të njëjtën kohë, shumë nga qëllimet e këtyre ndërhyrjeve nën IPA II kanë mbetur ende duke plotësuar mungesat e ndërhyrjeve të mëparshme ose duke shtuar mbështetjen në të njëjtat fusha për të siguruar koherencë dhe qëndrueshmëri më të mëdha të përpjekjeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë.

Së fundi, më 17 prill 2017, duke ndjekur fillimin e suksesshëm për zbatimin e reformës së drejtësisë dhe rezultatet fillestare të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Komisioni Evropian ka rekomanduar që Këshilli të vendosë që negociatat e hyrjes me Shqipërinë të kushtëzohen nga progresi i arritur, duke ruajtur dhe thelluar momentin aktual të reformës.²

PËRSHTATSHMËRIA ME DOKUMENTIN STRATEGJIK TË IPA II DHE REFERENCAT E TJERA KRYESORE

Sipas pikëpamjes së politikave të përkufizuara në Strategjinë e fundit për Zgjerimin të vitit 2016, raportet vjetore të progresit dhe prioritetet qeveritare, IPA II duhet të përqendrohet në forcimin e sundimit të ligjit dhe sektorin e drejtësisë si prioritet strategjik. Progresi në këtë sektor do të sigurojë një të ardhme të qëndrueshme dhe demokratike për vendin, duke përfutur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga zhvillimi i saj socioekonomik, duke përfshirë edhe rritjen e investimeve të huaja. Në të njëjtën linjë me objektivat e Dokumentit Strategjik të Treguesve, 2014–2020, programi për mbështetjen e sektorit të drejtësisë do të asistojë, ndër të tjera, mbështetjen e reformave në fushën e sundimit të ligjit dhe të drejtave themelore. Lufta kundër korrupsionit, veçanërisht me sistemin gjyqësor, është një prioritet në këtë drejtim. Në të njëjtën kohë, mbështetje thelbësore do të sigurohet për të forcuar zbatueshmërinë e legjislacionit, veçanërisht për sa u përket luftës kundër korrupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe lëndëve narkotike.

Strategjia e Zgjerimit të BE-së, 2016, nënvizon marrjen e masave procedurale të nevojshme institucionale dhe legjislative, si hapa të rëndësishëm për miratimin e Strategjisë të reformës në drejtësi.

Në veçanti, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit përfshin parashikime mbi bashkëpunimin për të forcuar pavarësinë e gjyqësorit dhe përmirësuar efikasitetin e tij, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në mënyrë të ngjashme, përfundimet e përbashkëta të dialogut të 6-të të nivelit të lartë dhe prioritetet kyçe të vitit 2017, nënvizojnë rëndësinë e plotësimit të procesit të reformës në drejtësi, i cili duhet të jetë i përgjithshëm, gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm, të cilat janë thelbësore për të rritur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Sfidat më të mëdha me qëllimet e reformës, të përkufizuara në pesë fusha të periudhës në vazhdim, kanë përfshirë sundimin e ligjit, reformën në administratën publike, reformën elektorale, forcimin e ekonomisë së tregut dhe lirinë e shprehjes.

Politikat kombëtare për reformën në sistemin e drejtësisë të propozuara për t'u mbështetur në funksion të kësaj reforme duhet të kenë ndikim në të gjitha fushat e lartpërmendura. Me qëllim që të bëjnë më efektive mbështetjen me fonde IPA dhe të qëndrueshme, është nevojshme që përfshihen në një kuadër me kushte më të gjera strategjike, afatgjata. Pra, me prezantimin e IPA II, kujdes i veçantë do t'i jepet mbështetjes buxhetore sektoriale në krahasim me programimin e projekteve individuale. Mbështetja kontribuon dhe lehtëson ecjen përpara në procesin e anëtarësimit.

GATISHMËRIA E SEKTORIT PËR MBËSHTETJE BUXHETORE STABILITETI MAKROEKONOMIK

Siç theksohet në raportin vjetor 2018 të Komisionit Evropian, Shqipëria e ka përmirësuar stabilitetin e saj makroekonomik gjatë vitit 2017 dhe është përgatitur në mënyrë të moderuar për të zhvilluar një ekonomi tregu funksionale. Zhvillimi ekonomik është rritur me 3.9%, duke bërë që të jetë një nga rritjet ekonomike më të shpejta në rajon, duke reduktuar deficitin publik me 2% gjatë vitit 2017 dhe inflacioni të mbahet në 2%. Papunësia është ulur, por, gjithsesi është ende e lartë, veçanërisht për të rinjtë. Progres është bërë për të përmirësuar stabilitetin makroekonomik, perspektivat e rritjes dhe reformën në menaxhimin e financave publike që të ecin përpara. Ky evolucion është konfirmuar dhe në raportin e vitit 2017 të PEFA-s, duke treguar që më shumë se gjysma e treguesve PEFA janë përmirësuar. Megjithatë, sfida të mëdha mbeten dhe Shqipëria duhet të vazhdojë konsolidimin fiskal për të arritur objektivat e saj afatmesëm për reduktimin e borxhit publik dhe për të krijuar më shumë hapësira për manovra në politikën fiskale, si dhe për të fuqizuar kuadrin ligjor të menaxhimit të buxhetit. Reformat e

² http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-18-3403_en.htm

rëndësishme për të përmirësuar mjedisin e biznesit vazhdojnë, por kërkojnë përpjekje të mëtejshme për progres. Reforma e përgjithshme në drejtësi ka avancuar por ka nevoja që duhet të zbatohen në mënyrë të plotë.

Ligji i ri për falimentin hyri në fuqi dhe do të forcojë ende më shumë regjimin e pagesave të pashlyera. Niveli i papunësisë dhe i punësimit në mënyrë informale mbetet në nivele të larta. Në linjë të njëjtë me rekomandimet e Programit të Reformës Ekonomike (PRE) dhe në mënyrë që të mbështesin rritjen ekonomike afatgjatë gjatë vitit të ardhshëm, Shqipëria duhet t'u kushtojë vëmendje të veçantë: i. mbështetjes së konsolidimit financiar dhe forcimin e kuadrit ligjor të menaxhimit të buxhetit; ii. duke trajtuar nivelin e lartë të kredive me probleme; iii. përmirësimin e klimës së biznesit dhe zbatimin e ligjit të ri për falimentin; dhe iv. reduktimin e ekonomisë informale, duke përfshirë punën e padëkluar.

Zbatimi i mekanizmeve financiarë trevjeçarë me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka forcuar stabilitetin makroekonomik dhe reformat për nxitjen e rritjes ekonomike janë përfunduar në mënyrë të suksesshme në mars të vitit 2017. Në mars të vitit 2018 FMN-ja përfundoi misionin e parë të monitorimit pas programit, i cili ishte përqendruar te dobësitë dhe risqet. FMN-ja rekomandon që Shqipëria të vazhdojë përpjekjet e saj për të forcuar dhe për të rritur elasticitetin e ekonomisë së saj për të ulur borxhin publik dhe nevojat e huamarrjes, reforma në taksën e pronës dhe të zvogëlojë përjashtimet nga taksat, duke e bërë menaxhimin e financave publike më efikas dhe të modernizojë administratën tatimore, të zgjidhë mbifaturimin e borxhit të vonuar të bankës që pengon huadhënien dhe të shtyjë përpara me nisjen e kohëve të fundit, nismën e reformës së drejtësisë të mbështetur nga BE-ja dhe me reformat e tjera strukturore për të trajtuar shqetësimet qeverisëse dhe sistemin e drejtësisë joefikas.

Në vlerësimin e tij për Programin e Reformës Ekonomike të Shqipërisë (PRE), 2018–2020, Komisioni Evropian konfirmon që kuadri makroekonomik i prezantuar në PRE, gjatë janarit të vitit 2018 është koherent, i qëndrueshëm dhe i kuptueshëm në mënyrë të mjaftueshme dhe siguron bazat e përshtatshme për vlerësimin e politikave dhe diskutimeve. Pas performancës së ulët me të ardhurat gjatë vitit 2015, përmirësimet në të ardhurat, duke u mbështetur te parashikimi i dy viteve të fundit, sugjerojnë që qeveria ka procedurë më të mira në përdorim për çështjet makroekonomike dhe për vlerësimin e politikave të reja. Të ardhurat nga taksat janë rritur në mënyrë të konsiderueshme nga 22% e PPB-së në vitin 2013 në 26% në vitin 2017, ku të ardhurat e përgjithshme kanë arritur 28% të PPB-së. Tashmë është e dukshme që progresi në fushat e PFM-së është i kënaqshëm dhe reforma të ndryshme po ecin në mënyrë progresive dhe po vazhdojnë të zbatohen. Nëpërmjet Programit të Reformës Ekonomike është vendosur që në Shqipëri të konsolidohet sa më shumë rruga fiskale dhe të trajtohen dobësitë që rrjedhin nga borxhi i lartë publik që zë 71.2% të PPB-të në fund të vitit 2017 dhe krizave të mundshme të jashtme. Në përgjithësi, kërkesa e përshtatshmërisë dhe fakti që kemi një politikë makroekonomike të orientuar drejt stabilitetit, është përmbushur.

MENAXHIMI I FINANCEVE PUBLIKE

Qeveria ka zbatuar për të tretin vit radhazi Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike për vitin 2014–2020 dhe Planin e saj të Veprimit, qëllimi i së cilës është që të përmirësojë kornizën financiare, procesin e buxhetit, zbatimin e rregullave dhe të procedurave dhe menaxhimin e kujdesshëm të fondeve publike, si dhe të forcojë transparencën dhe mekanizmat e llogaridhënies. Raporti i fundit vjetor i monitorimit për vitin 2017, i botuar në mars 2018, thekson se që nga 14 treguesit e përgjithshëm të PFM-së, 8 prej tyre ishin plotësuar (57%), 5 nuk ishin plotësuar dhe një nuk kishte të dhëna të mjaftueshme. Në lidhje me treguesit e përgjithshëm specifikë që mbulojnë dhe 6 shtyllat e programit reformues të PFM-së, 19 nga 36 treguesit janë plotësuar (53%), shtatë nuk janë plotësuar dhe shtatë janë plotësuar në mënyrë të pjesshme ndërsa për tre tregues nuk kishte të dhëna të disponueshme. Nga 73 aktivitetet e mbetura për vitin 2015–2020, 18 u plotësuan gjatë vitit 2017, 54 ishin në progres dhe njëri do të fillojë këtë vit dhe një tjetër u braktis. Ka progres duke filluar me vitin 2016 dhe tregon një shkallë nxitimi. Nevoja për përmirësime në transparencë dhe gjithëpërfshirja e raportimit buxhetor dhe shqyrtimi është përmendur në mënyrë të veçantë nga SIGMA (Mbështetja për përmirësim në qeverisje dhe menaxhim). Megjithatë, një krahasim midis vendeve në rajon tregon që Shqipëria ka arritur pikë më të larta se sa vendet e tjera për planifikimin e buxhetit afatmesëm dhe treguesit në procesin e buxhetimit. Fondi Monetar Ndërkombëtar rekomandon që Shqipëria të ndjekë një konsolidim financiar më të shpejtë për të krijuar politika parandaluese, për shkak dhe të nivelit të lartë të borxhit publik (70 për qind e PPB-së në fund të vitit 2017, duke përfshirë dhe borxhet e qeverisë qendrore dhe lokale që

arrijnë 2.2% të PPB-së). Reformat në periudhën në vazhdim do të përqendrohen në planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit; forcimin e standardeve të kontrollit të brendshëm; parandalimin e borxheve në nivel qendror dhe lokal të qeverisjes; ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm; përmirësimin e planit dhe menaxhimit të investimeve; përmirësimin e rishikimit të prokurimeve publike dhe përputhjes me rregullat e prokurimit; dhënien e aksesit elektronik të thesarit për sa më shumë institucione; analizimin e risqeve fiskale të ndërmarrjeve në pronësi shtetërore. Në përgjithësi, kërkesa për përshtatshmërinë, e cila ka një program të besueshëm dhe të përshtatshëm për përmirësimin e financave publike, është vlerësuar si i plotësuar gjatë vitit 2017.

TRANSPARENCA DHE MBIKËQYRJA E BUXHETIT

Informacioni në lidhje me transparencën e buxhetit të Shqipërisë, si dhe me mekanizmat e mbikëqyrjes së tij është në përgjithësi i aksesueshëm. Kërkesat minimale për publikimin e buxhetit të vitit 2017, janë plotësuar, duke e publikuar buxhetin në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave³. Qeveria publikoi një buxhet për qytetarin në buxhetin e vitit 2017.⁴ Për herë të parë kërkesat për publikim dhe informacione shtesë janë përfshirë në ligjin organik të buxhetit. Qeveria botoi në vitin 2016 dhe 2017 dokumentet e rishikimit të buxhetit për Parlamentin në shqip dhe në anglisht. Qeveria për herë të parë botoi një listë të investimeve publike gjithëpërfshirëse të atashuara në buxhetin afatmesëm 2016–2018.⁵ Rezultati i Indeksit të Buxhetit të Hapur të Shqipërisë është 50 në Sondazhin e Buxhetit të Hapur (OBS) 2017. Ky shënon një përmirësim thelbësor nga viti 2015, kur rezultati ishte 38. Shqipëria publikon 7 nga 8 dokumente për buxhetin në një kohë të përshtatshme dhe zakonisht mungon raportimi për buxhetin e vjetor të mesëm. Pjesëmarrja e publikut në procesin e buxhetit mori vetëm 2 pikë nga 100 pikë në sondazhin e OBS-së për vitin 2017. Vlerësimi i Kodit të Transparencës Fiskale të FMN-së, i botuar gjatë janarit të vitit 2016, vërente se 10 nga 36 parimet e këtij kodi renditeshin si “të mira” ose të “avancuara” dhe 14 parime renditeshin si “bazë”. Megjithatë, në tetë fusha kërkesat themelore të Kodit nuk janë plotësuar.

Qeveria publikon informacion mbi nxjerrjen e naftës, gazit dhe mineraleve të tjera, kontributin e kësaj industrie për buxhetin e shtetit dhe shpërndarjen e shpenzimeve për këto të ardhura. Në dhjetor të vitit 2016, Iniciativa e Transparencës për Industrinë Nxjerrëse publikoi një udhërrëfyes të përfituesve të Shqipërisë, i cili vërente se si Shqipëria synon të zbulojë pronarët përfitues të kompanive aktive në sektorin e nxjerrjes. Qëllimi kryesor ishte që të promovonte transparencën, në mënyrë që të parandalohet korrupsioni, rritjen e ndërgjegjësimit midis qytetarëve për të kërkuar nga qeveria e tyre përdorimin me kujdes të të ardhurave fiskale dhe jo fiskale të gjeneruara nga zbulimi dhe shfrytëzimi i burimeve natyrore në Shqipëri. Në qershor të vitit 2017, EITTI vlerësoi Shqipërinë dhe konstatoi që kishte bërë progres të kënaqshëm. Të gjitha aspektet e kërkesave ishin zbatuar dhe qëllimi i përgjithshëm ishte arritur. Në përgjithësi, kërkesa për një buxhet transparent është plotësuar.

POLITIKA PUBLIKE

Në vijim të punës analizuese të Komisionit Parlamentar *Ad Hoc* të Reformës në Drejtësi, një grup pune ndërsektorial u krijua me një urdhër të ministrit të Drejtësisë për të përgatitur **Strategjinë e Drejtësisë Ndërsektoriale, për periudhën 2017–2021**. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë dhe Plani i Veprimit u miratuan me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 773, datë 2 nëntor 2016. Kjo Strategji përfshin qëllime dhe masa të qarta, të cilat do të ndërmerren në mënyrë që të përmirësojnë funksionimin e sistemit të drejtësisë deri në vitin 2021. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë është e bazuar në vlerësimin e arritjeve të Strategjisë pararendëse dhe te konkluzionet e punës analitike të zhvilluar nga Komisioni Parlamentar *ad hoc* për Reformën në Drejtësi, si dhe te konkluzionet e dokumenteve të tjera strategjike e te nevojat e identifikuar nga të gjitha grupet e interesit dhe dobësitë e identifikuar në sektorin e drejtësisë.

Objektivat dhe aktivitetet e strategjisë në sektorin e drejtësisë janë të mirëprojektuara për të trajtuar të gjitha nevojat e sektorit të drejtësisë, duke përfshirë dhe sfidat e këtij sektori gjatë zbatimit të reformës në drejtësi. Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë do të rishikohet në mënyrë të rregullt dhe plani i saj i veprimit do të rregullohet së bashku me progresin e zbatimit dhe ndryshimin e rrethanave. Një përditësim i Planit të Veprimit, i udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë, u krye gjatë vitit 2017 dhe

³ <http://www.financa.gov.al/al/legjislacioni/buxheti-thesariborxhi/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2016>

⁴ <http://www.financa.gov.al/al/legjislacioni/buxheti-thesariborxhi/buxheti/buxheti-i-qytetarit-2016>

⁵ http://www.ekonomia.gov.al/files/userfiles/Investimet_PBA_2016-2018.pdf

një përditësim i dytë u parashikua që do të ndodhte pas raportit të parë të zbatimit të fazës së parë, duke angazhuar palët e interesuara.

Kjo Strategji është e rëndësishme sepse synon mungesat kryesore dhe sfidat, siç janë përkufizuar në dokumentin analitik të përgatitur nga Komisioni Parlamentar *Ad Hoc* i Reformës në Drejtësi. Mungesat janë të lidhura me ndarjen e pamjaftueshme të pushteteve midis ekzekutivit dhe gjyqësorit; kriteret dhe procedurat e emërimit për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm; statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve; procesin e procedimeve disiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët; kapacitetet e kufizuara administrative; shpërndarjen e pamjaftueshme të buxhetit për infrastrukturën e gjykatave dhe pagat e tyre; edukimin fillestar dhe të vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët; korrupsionin e nivelit të lartë në gjyqësor dhe në degët e tjera të drejtave të njeriut në sistemin e burgjeve si rezultat i mbipopullimit të tyre dhe mungesës së qendrave të dënimit për të rinjtë dhe të sëmurët mendorë.

Strategjia në Sektorin e Drejtësisë është e lidhur me prioritetet e politikave kombëtare, siç është shkruar në shumë dokumente politikash dhe strategjish. Ajo trajton objektivat e SKZHI-së për sa i përket drejtësisë, e cila synon “të ndërtojë një vend të bazuar te sundimi i ligjit, të garantojë të drejtat e njeriut, me një sistem me drejtësi të hapur dhe të barabartë dhe që siguron që të ketë drejtësi për të gjithë”, si dhe objektivat për **Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2017–2020**, “për të vendosur një sistem drejtësie të pavarur, të përgjegjshëm dhe eficient në Shqipëri dhe i cili të jetë në gjendje që të japë një drejtësi të ndershme dhe transparente, si dhe të zbatojë legjislacionin e përafëruar në përputhje me EU *acquis*”. Ajo trajton, gjithashtu, dhe mungesat e nënvizuara të Progresraportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë në vitin 2017, në lidhje me krijimin e institucioneve të pavarura gjyqësore, duke ndjekur qasjen sektoriale të reformës në drejtësi nën Strategjinë Ndërsektoriale 2017–2020 dhe të sigurojë një qeverisje të përshtatshme, si dhe mekanizmat monitorues dhe raportues me anë të treguesve të mirëzhvilluar të përkrahur nga një mbështetje e përshtatshme financiare për zbatimin e saj. Ajo është e lidhur me Strategjinë Antikorrupsion, 2015–2020, në kuadrin “qasje represive”, e cila përfshin: përmirësimin e eficiencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit; përmirësimin e bashkëpunimit midis agjencive ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe në dënimin e korrupsionit; përmirësimin e kuadrit ligjor për ndjekjen e krimeve ekonomike dhe financiare; përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar ligjor dhe policor në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar. Strategjia merr parasysh Strategjinë Afatmesme të Prokurorisë shqiptare, 2015–2017, e cila është e përqendruar në rritjen e efektivitetit të hetimeve, forcimin e kapaciteteve hetimore profesionale dhe teknike, dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional etj.

Ajo është, gjithashtu, e lidhur me Strategjinë e Reformën në Administratën Publike, e cila synon forcimin e kapaciteteve të hartimit ligjor në lidhje me Drejtorinë e Kodifikimit dhe drejtoritë e tjera në Ministrinë e Drejtësisë. Ka, gjithashtu, një numër lidhjesh të tjera midis strategjisë RAP dhe reformës në shërbimin civil. Punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera të saj të varësisë, duke përfshirë dhe sistemin e burgjeve, janë kryesisht punonjës të shërbimit civil. Objektivat e mëposhtëm të Strategjisë RAP kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për përmirësimin e performancës së shërbimit civil në këto institucione. Përmirësimi i kapacitetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Drejtorisë së Kodifikimit do të mbështesë përafrimin e legjislacionit sektorial me Kodin e Procedurave Administrative (KPA) dhe do të sigurojë një zbatim të saktë të tij në administratën publike. Strategjia është, gjithashtu, e lidhur me **Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin e Qeverisjes Vendore, 2014–2020**, e cila ndër të tjera, do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në riorganizimin e hartës juridike dhe, si pasojë, edhe tek aksesin e drejtësisë për qytetarët.

Gjithashtu, Strategjia do të përfshijë nevojat e identifikuar nga të gjitha institucionet e interesuara. Çështjet gjinore dhe të pakicave, si dhe aksesin ndaj drejtësisë për grupet vulnerabël janë të përfshira qartë në disa veprime, por kanë nevojë për prioritetizim të mëtejshëm. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (2016–2020) e miratuar së fundi nga qeveria shqiptare, ka një qëllim strategjik në reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje dhe një mekanizmi kombëtar funksional mbi barazinë gjinore.

Duke iu referuar rëndësisë, reforma në drejtësi synon tetë objektiva kryesorë, të cilat përmbajnë një numër veprimesh, secili prej të cilave kërkon monitorim.

Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, eficiencës dhe përgjegjshmërisë së institucioneve të sistemit të drejtësisë është qëllimi kryesor i strategjisë së drejtësisë dhe i reformës në drejtësi. Ajo

përqendrohet te rritja e statusit për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në të gjitha nivelet dhe te rritja, forcimi dhe përmirësimi i organizimit të gjykatave dhe të administratës gjyqësore. Sipas këtij objekti, sistemi i drejtësisë do të qeveriset nga një sërë institucioneve të reja të drejtësisë, duke përfshirë JAC, HJC, HPC dhe HJI.

Objekti 2: Konsolidimi i arsimit ligjor dhe trajnimit, si dhe specializimi i magistratëve dhe personelit të gjykatave. Amendamentet kushtetuese njohin Shkollën e Magistraturës si organ kushtetues. Me rritjen e fushës së saj të trajnimeve, Shkolla e Magistraturës është institucioni përgjegjës në nivel kombëtar për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët, si dhe programet e trajnimit të vazhdueshëm për stafin e gjykatave të tjera, të tilla si kancelarët e gjykatave apo personelin juridik-administrativ.

Objekti 3: Përmirësimi i veprimit të sistemit gjyqësor, duke forcuar eficiencën, transparencën dhe aksesin sipas standardeve evropiane. Në këtë qëllim, legjislacioni mbi sistemin e njoftimeve, parandalimin e shtyrjes së gjyqeve, prezantimin e masave përshpejtuese, kriteret e filtrimit, publikimi elektronik i vendimeve të gjykatave etj., do të përmirësohet. Aksesin ndaj drejtësisë do të përmirësohet me anë të një sistemi pagesash të arsyeshme dhe proporcionale, të kombinuara me një sistem ndihme ligjore të ndershmë dhe falas për individët dhe grupet në nevojë.

Objekti 4: Rritja e eficiencës së sistemit të drejtësisë penale dhe masave antikorrupsion me anë të konsolidimit të misionit, statusit dhe funksionimit të institucioneve të drejtësisë penale. Reforma në drejtësi synon të rrisë pavarësinë e brendshme dhe të jashtme për prokurorët dhe zyrën e tyre, të një strukture të specializuar antikorrupsion në nivel kombëtar, të përbërë nga policë, prokurorë dhe gjykata, e cila do të vendosë që të luftojë krimin dhe korrupsionin, së bashku me përmirësimin e legjislacionit penal.

Objekti 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë, duke siguruar procedura të një sistemi elektronik modern dhe lehtësira për zhvillimin e një bashkëpunimi ndërkombëtar të fuqishëm. Sistemet e TI-së, për gjykatat, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, HPC dhe HJI do të krijohen, duke përfshirë dhe një Qendër të Teknologjisë së Informacionit. Një sistem i ri i menaxhimit të çështjeve do të zbatohet për gjykatat dhe për sistemin e menaxhimit të çështjeve nga shërbimet e prokurorëve, do të nxitet që të rrisë eficiencën në përpunimin e çështjeve me anë të Ndihmës Ligjore të Dyfishtë.

Objekti 6: Nxitja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin penal. Qëllimi kryesor i këtij objekti është mbrojtja e të drejtave të të burgosurve, sipas standardeve evropiane dhe ndërkombëtare. Mundësi punësimi për të burgosurit, programet e rehabilitimit dhe riintegrit, sipas praktikave më të mira, duke përfshirë dhe shpërndarjen e burimeve njerëzore të nevojshme. Burimet do të shpërndahen për të reduktuar mbipopullimin e burgjeve dhe qendrave të paraburgimit, për të plotësuar standardet evropiane dhe për të garantuar mbrojtjen e të drejtave themelore për të burgosurit me probleme të shëndetit mendor. Kjo Strategji do të përqendrohet në forcimin dhe përmirësimin e shërbimit të provës.

Objekti 7: Përmirësimi dhe funksionimi i Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë. Strategjia ka identifikuar që kapacitetet e departamenteve të ndryshme të Ministrisë duhet të forcohen, të tilla si: kapacitetet kodifikuese të departamenteve, bashkëpunimi ndërkombëtar i tyre, departamenti i integritetit të BE-së dhe departamenti i inspektimit i profesioneve të reja ligjore. Brenda departamentit të kodifikimit, duhet të ngrihet një sistem për të kryer vlerësime të ndikimit të legjislacionit dhe të sistemit për shqyrtimin e korrupsionit të legjislacioneve të hartuara. Ashtu si institucionet e varësisë, ekspertiza e specializuar për Institutin e Mjekësisë Ligjore do të zhvillohet dhe duhet të rriten kapacitetet profesionale dhe institucionale të Komisionit shqiptar për Birësimin.

Objekti 8: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit për profesionistët ligjorë dhe krijimi i një kuadri ligjor për arbitrazhin. Ndryshimet në legjislacionin për iniciimin e profesionit të avokatit dhe të noterit janë të nevojshme dhe do të përgatiten. Mekanizmat disiplinorë, si për avokatët, ashtu dhe për noterët, do të forcohen. Arsimimi fillestar dhe i vazhdueshëm për avokatët, noterët, përmbartuesit dhe ndërmjetësuesit do të zërrë një vend të veçantë, me qëllim që të rrisë aftësitë e tyre profesionale. Ndryshimet në legjislacion do të kenë, gjithashtu, si qëllim që të rrisin autonominë e dhomave përkatëse.

Reforma në sektorin e drejtësisë përfshin një plan veprimi, 2017–2021, i cili i mbulon të gjitha shtyllat kryesore. Treguesit, bazat dhe objektivat e treguesve do të përcaktohen gjatë vitit 2018.

Plani i Veprimit do të përshtatet mbi baza vjetore në mënyrë që të adaptohet në bazë të progresit të zbatimit të masave dhe të përditësohet, sipas planifikimit të buxhetit afatmesëm. Në raportin e parë të monitorimit, institucionet kanë raportuar nevojën për të rishikuar Strategjinë dhe Planin e saj të Veprimit, për vitin 2017–2021, në mënyrë që të përshtatet me nevojat reale dhe prioritetet e sistemit dhe institucioneve të drejtësisë.

Sipas raportit të monitorimit, nevoja për të rishikuar është e lidhur më shumë, me faktorë të tillë si:

- vonesat në krijimin e institucioneve të reja të drejtësisë, duke përfshirë HJC, HPC, HJI, SPAK dhe NBI;

- ndryshimin e rrethanave dhe përgjegjësiwe institucionale që do të kenë një ndikim në zbatimin e aktiviteteve;

- rishikimin e vlerave të kostove dhe shpërndarjen e përshtatshme të buxhetit;

- ndryshimin e menaxhimit dhe të angazhimit ndër grupet e interesit të përfshira në programin e reformës për të ndërmarrë detyrat e përcaktuara.

Për masat në Planin e Veprimit të cilat nuk janë të mbuluara financiarisht, institucioni përgjegjës do të planifikojë nevojat buxhetore përmes programeve përkatëse buxhetore, si pjesë e PBA-së dhe si pjesë e procesit vjetor të buxhetimit. Për më tepër, Këshilli i Ministrave në bashkëpunim me komunitetin e donatorëve do të identifikojë mundësitë për mbështetje financiare, për masat të cilat ende nuk janë financuar.

Strategjia për Sektorin e Drejtësisë është vlerësuar si **e besueshme**, sikurse detajohet më poshtë:

Që nga nëntori 2014, një marrëveshje politike në nivele të larta u arrit për të kaluar përgjegjësitë e hartimit dhe të miratimit të reformës së drejtësisë nga Ministria e Drejtësisë te Parlamenti.

Ky i fundit ka siguruar pjesëmarrje më të madhe nga të gjitha partitë politike, duke garantuar politikisht marrjen përsipër të reformës në drejtësi dhe duke shmangur etiketimin për reformën në drejtësi, si të jetë kryer ekskluzivisht nga qeveria, për shembull, krahu i pushtetit ekzekutiv.

Strategjia për sektorin e drejtësisë përmbledh në vetvete një Strategji nga Komiteti *Ad Hoc* Parlamentar për Reformën në Drejtësi, e cila është konsultuar me shoqërinë civile dhe publikun e gjerë. Gjithashtu, Strategjia e Sektorit të Drejtësisë është hartuar dhe miratuar nga një grup pune, i cili përfshinte të gjitha grupet e interesit në sektorin e drejtësisë, si dhe është mbështetur nga disa projekte asistencë teknike të financuara nga BE-ja, të cilat kanë kryer vlerësime dhe konsultime të mëtejshme me grupet e interesit në nivel operacional, duke përfshirë shoqërinë civile, në tetor 2015 dhe shtator 2016, duke lejuar kështu të ketë kohë të mjaftueshme për të marrë përgjigje. Komiteti *Ad Hoc* Parlamentar për Reformën në Drejtësi ka bashkëpunuar ngushtë me 10 organizata të shoqërisë civile, të cilat janë aktive në sektorin e drejtësisë, duke i ftuar ato rregullisht në tryezën e konsultimeve.⁶

Organizata të tjera të shoqërisë civile, gjithashtu, kanë luajtur rol aktiv, duke dërguar komente me shkrim për Komitetin *ad hoc*. Reagimet e tyre janë reflektuar në strategjinë finale. Në maj 2018, Kuvendi i Shqipërisë, në bazë të nenit 288, të ligjit nr. 115/2016, ka ngritur me vendimin nr. 74/208, Komisionerin e Pavarur për Koordinimin, Monitorimin. Ky Komision do të monitorojë zgjidhjen dhe emërimin e anëtarëve të institucioneve të sistemit të drejtësisë; do të koordinojë dhe do të kryejë zbatimin e ligjit nr. 115/2016, “Mbi institucionet shqiptare për fushën e drejtësisë” nga institucionet përkatëse; do të raportojë pranë Kuvendit në programin e zbatimit dhe do të regjistrojë raste të dështimeve të institucioneve përkatëse për të zbatuar ligjin.

Pra në përfundim mund të themi se hartimi i Strategjisë ishte një proces gjithëpërfshirës, i cili bëri pjesë të tij të gjitha institucionet përkatëse shtetërore apo joshtetërore.

Nivel i njëjtë pjesëmarrjeje dhe përfshirjeje është garantuar për zbatimin dhe për monitorimin e Strategjisë dhe të Planit të saj të Veprimit. Është ngritur një mekanizëm institucional i asistuar nga sekretariati teknik, nën leadershipin e Ministrisë së Drejtësisë.

Do të prodhohet dhe do të publikohet raporti i progresit vjetor për monitorimin e Planit të Veprimit. Këto raporte do të përfshijnë një analizë të arritjeve kundrejt synimeve. Raporti i parë monitorues, i cili do të monitorojë progresin e zbatimit të Planit të Veprimit për vitin 2017, u përgatit nga sekretariati teknik gjatë tremujorit të parë të vitit 2018. Raporti u miratua nga mekanizmi institucional më 18 prill 2018 dhe u publikua *online* në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë⁷.

⁶ <http://www.reformanedrejttesi.al/rrejt-i-organizatave-jofitimprur%C3%ABse>

⁷ <http://www.drejtesia.gov.al/al/prioritete/strategjia-ndersektoriale/plani-i-veprimit-te-strategjise-ndersektoriale-te-drejtetise>

Sipas raportit të parë, nga 201 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë, 59 ose 29% e totalit të aktiviteteve janë realizuar, 35 ose 18% janë në zbatim dhe për 107 të tjerat ose 53%, zbatimi nuk ka filluar ende. Shumica e aktiviteteve të cilat nuk kanë filluar zbatimin (65 nënaktivitete) bien nën përgjegjësinë e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, të cilat nuk janë ngritur ende. Raporti monitorues për vitin 2017 vlerëson se kostoja e 59 aktiviteteve të zbatuara në vitin 2017 është 2.7 milionë nga 5 milionë euro të shpenzuara nga sektori i drejtësisë në vitin 2017.

Qëndrueshmëria e ndërhyrjes varet nga faktorët politikë, financiarë dhe strukturorë. Reforma e plotë dhe gjithëpërfshirëse e miratuar me amendim të Kushtetutës është rezultat i negociatave politike dhe i marrëveshjeve midis partive politike, me mbështetjen domethënëse të komunitetit ndërkombëtar. Zbatimi i reformës për drejtësi, i cili po vijon, ka arritur tashmë progres pozitiv, sikurse përmendet më lart. Rivlerësimi i të gjithë gjyqtarëve dhe i prokurorëve (procesi i vetingut) ka filluar dhe ka filluar të japë rezultatet e para të prekshme. Ky proces, i cili ka mbështetjen nga të gjitha palët, kryhet nga një autoritet i pavarur është objekt i monitorimit ndërkombëtar dhe përputhshmëria e tij me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut është konfirmuar nga Komisioni i Venecias. Nën drejtimin e Komisionit Evropian, një Operacion Ndërkombëtar Monitorues është ngritur për të mbikëqyrur procesin gjatë gjithë periudhës së zbatimit.⁸ Këshilli për legjislacionin, i përbërë nga struktura dy partiake me prezantim të barabartë nga pala e maxhorancës dhe e opozitës, është ngritur në Parlament, me qëllim që të japë opinionin e tij për projektligjet, siç kërkohen nga Komitetet e tjera Parlamentare. Këshilli për legjislacionin po punon për të trajtuar ndërhyrjet e nevojshme në disa ligje kyçe të reformës së drejtësisë pas rishikimit nga Gjykata Kushtetuese. Qëndrueshmëria politike e reformës është përgjithësisht e siguar, por mbështetja e plotë politike dhe pronësia mbi zbatimin e reformës ende duhet të sigurohet nga të gjitha partitë politike.

Qëndrueshmëria e reformës, gjithashtu, varet nga ekzistenca e burimeve njerëzore të kualifikuara. Procesi i vetingut po kontribuon për të pastruar sistemin gjyqësor nga elementet e korrupsionit. Legjislacioni i ri saktëson procedurat e reja për rekrutimin e bazuar në meritë për stafin e institucioneve të reja që do të ngrihen. Reforma, gjithashtu, përfshin një rritje domethënëse të nismave trajnuese për stafin e ri ose atë ekzistues, duke u shtrirë me trajnime të vazhdueshme, kryesisht nën kujdesin e Shkollës së Magjistraturës, e dyfishuar me asistencë teknike nga ekspertët ndërkombëtarë. Masat që lidhen me forcimin e kapaciteteve që janë pjesë e Strategjisë do t'u mundësojnë - në periudhë afatmesme - institucioneve përgjegjëse kapacitete të mjaftueshme për të zbatuar planet e dakordësuara, me qëllim arritjen e objektivave.

Për sa i përket qëndrueshmërisë financiare, Strategjia e sektorit të drejtësisë është e lidhur me një Plan Veprimi të detajuar, i cili është i kostuar dhe pjesërisht i buxhetuar. Ekziston një numër çështjesh që lidhen me qëndrueshmërinë financiare, të cilat vijnë si rezultat i ndryshimeve në legjislacion, si dhe në strukturat institucionale të sistemit të drejtësisë që të çojnë në krijimin e institucioneve të reja; riorganizimin e të tjerave dhe përmirësimin e statusit të aktorëve të sistemit gjyqësor, kryesisht gjykatësve dhe prokurorëve, duke rritur rrogat e tyre dhe përfitime e garanci të tjera. Staf i ri i punësuar rrit rrogat aktuale dhe kostot e mirëmbajtjes për sistemet e reja TI krijojnë një barrë të vazhdueshme për buxhetin e shtetit. Kostot e përgjithshme për zbatimin e planit të veprimit, për periudhën 2017–2021, për reformën në sektorin e drejtësisë, janë vlerësuar 146 milionë euro, duke përfshirë 89 milionë euro kosto kapitali, si në tabelën 1.

Tabela 1. Vlerësimi fillestar i kostove për reformën në drejtësi sipas llojit të shpenzimeve në euro '000

Viti	2017	2018	2019	2020	2021	TOTALI	%
Kapitali	11 667	21 225	25 470	20 573	9 943	88 878	61%
Rrogat	5 286	5 346	12 066	12 106	12 106	46 911	32%
Trajnimet	450	95	155	77	65	842	0.6%
Shpenzime të tjera rrjedhëse	965	610	2 085	3 570	2 365	9 596	6.4%
Totali	18,368	27,276	39,776	36,326	24,479	146,227	100%

⁸ http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-18-3403_en.htm

Gjatë muajit maj 2017, plani i veprimit është rishikuar së bashku me kostot e vlerësuara. Shpenzimet kapitale (kostot e godinave të reja), afërsisht 50 milionë euro, janë hequr nga vlerësimi i kostove, duke i ulur ato në 98.4 milionë, si në tabelën 2.

Tabela 2. Kostot e rishikuara të reformës të vlerësuara nga lloji i shpenzimit në euro ‘000

	2017	2018	2019	2020	2021	TOTALI	%
Kapitali	6 667	14 425	9 836	5 240	3 619	39 787	40.4
Rrogat	5 286	5 346	12 066	12 106	12 106	46 911	47.7
Trajnimet	885	260	310	222	195	1 872	1.9
Shpenzime të tjera rrjedhëse	1 920	707	2 172	2 590	2 425	9 815	10
Totali	14 758	20 738	24 384	20 158	18 345	98 385	100

Burimi: Plani i Veprimit, 2017–2021

Sipas Planit të Veprimit, 59 milionë euro do të mbulohen nga fondet e buxhetit, duke përfshirë fondet rezervë prej rreth 41 milionësh. 2 milionë euro nga donatorët do të financojnë trajnimet, hendeuku financiar llogaritet të jetë rreth 35–37 milionë euro, për periudhën 2017–2021, ekuivalent me 38% të 98 milionë euro të vlerësuara si kosto. Fondet nga donatorët do të kërkohen për të mbyllur hendequn financiar.

Alokimet buxhetore për sektorin e drejtësisë kanë qenë mjaft të ulëta, afërsisht 92 milionë, sipas Buxhetit Final për 2018. PBA, 2018–2020, parashikon 86.6–90 milionë për vitin 2019–2021. PBA e fundit, 2019–2021, parashikon se ka një tavan vjetor maksimal indikativ prej 90 milionë eurosh⁹.

PBA, 2018–2020, reflekton disa elemente të reformës në sektorin e drejtësisë. Dispozitat buxhetore për ndikimin buxhetor të legjislacionit më të rëndësishëm të reformës janë hartuar tashmë, por janë bazuar te fondet shtesë të buxhetit rezervë. Efektet afatgjata të reformës në drejtësi, në aspekte të tjera, si për shembull, sistemin e pensioneve, nuk janë marrë parasysh dhe nuk është planifikuar asnjë masë për të ardhurat. Nga ana tjetër, kursime të mundshme të cilat mund të rezultojnë nga masat kundër korrupsionit dhe fitimet që rezultojnë nga automatizimi, duhet të merren parasysh në terma afatmesëm.

Koha dhe kostimi i Planit të Veprimit do të rishikohen mbi baza vjetore për ta përshtatur me progresin e zbatimit dhe për ta përditësuar sipas planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe anasjelltas.

Për sa i përket historikut, 7 pjesët kryesore të legjislacionit të cilat janë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të Strategjisë janë miratuar dhe raporti i parë monitorues tregon se reforma në drejtësi po avancohet. Në bazat e vlerësimit të kryer, Strategjia e Sektorit të Drejtësisë, 2017–2021, është konsideruar e rëndësishme dhe e besueshme, siç theksohet edhe në strategjinë e zhvillimit për Kontratën e Reformës Sektoriale.

MËSIMET E NXJERRA, LIDHJA ME ASISTENCAT FINANCIARE TË MËPARSHME OSE FINANCIME TË TJERA, SI DHE NDËRHYRJET NGA PARTNERËT E TJERË TË BASHKËPUNIMIT

BE-ja ka provuar se ka kryer mbështetje thelbësore për autoritetet shqiptare në fushat e reformës për drejtësi. Asistenca e mëparshme IPA është fokusuar në reformat institucionale më të rëndësishme dhe në forcimin e kapaciteteve të disa aktorëve të sistemit të drejtësisë, fillimisht përmes asistencës për modernizimin e sistemit të gjyqësorit. Gjithashtu, një numër projektesh në infrastrukturë kanë rritur në mënyrë të konsiderueshme kapacitetin e sistemit të gjyqësorit dhe të prokurorisë, me qëllim për t'u pajtuar me standardet ndërkombëtare.

BE-ja vlerësohet si donatori lider edhe për sa i përket promovimit të të drejtave njerëzore, si rezultat i disa projekteve të financuara nën instrumentin mbështetës për shoqërinë civile dhe në kuadrin e Instrumentit Evropian për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut. Asistenca e IPA I në sektor rezulton se është më shumë se 86.5 milionë. Shumë donatorë të tjerë të cilët kanë dhënë mbështetje në këtë fushë janë Suedia, Italia, Holanda, si dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

⁹ Tavani i shpenzimeve indikative, plani i buxhetit afatmesëm, 2019–2021, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Ndarja e drejtimeve të mbështetjeve nga donatorët në Shqipëri është një problem i veçantë¹⁰ dhe nevoja për në sistem të qëndrueshëm për koordinimin e donatorëve është shumë e madhe. Mekanizmi i koordinimit të donatorëve mund të luajë rol qendror në rritjen e pronësisë mbi procesin nga ana e përfituesve për procesin e anëtarësimit dhe, për rrjedhojë, edhe në orientimin gradual të ndërhyrjes së donatorëve. Duke qenë fusha të gjera dhe me shtrirje horizontale, reforma në drejtësi dhe lufta kundër korrupsionit kërkojnë një koordinim të përmirësuar midis donatorëve. Megjithatë, bashkëpunimi midis donatorëve nuk mund të zëvendësojë angazhimin politik, lidhshërinë, konsensusin midis qeverive, si një grup drejtues parësor në forcimin e pronësisë mbi reformën si e tillë.

Gjithashtu, është vlerësuar se ndërhyrjet e donatorëve nuk mund të zëvendësojnë për mungesë besueshmërie sistemet e brendshme në vend dhe përdorimin e pamjaftueshëm për dhënien dhe menaxhimin e asistencës¹¹. Forcimi i mekanizmit të koordinimit të donatorëve duhet të jetë në përputhje me angazhimet qeveritare, për të rritur përgjegjësitë dhe marrjen e pronësisë mbi proceset zbatuese të projekteve, si dhe në të njëjtën kohë të garantojë qëndrueshmërinë e tyre.

Një nga çështjet më të rëndësishme të asistencës në këtë fushë lidhet me pronësinë mbi procesin dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve. Duke marrë në konsideratë mungesën e herëpashershme të burimeve financiare, qëndrueshmëria vihet në dyshim. Pronësia për disa projekte individuale nga ana e përfituesve finalë është e rëndësishme në rastin e kontratave të punës dhe atyre të furnizimit, të cilat kërkojnë mirëmbajtje. Kjo është problematike më shumë në rastin e reformës në drejtësi, me në numër të madh institucionesh të reja që janë ngritur, të cilat kërkojnë mbështetje shtesë në rekrutimin e stafit dhe kostot e mirëmbajtjes për sistemet e reja TI. Me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëria, është e nevojshme që këto kosto të mbulohen që në fillim tërësisht nga buxhetit i shtetit, duke testuar kështu edhe pronësinë e plotë mbi procesin.

Për projektet e asistencës teknike, faktorët kyç të cilët prekin ndikimin dhe qëndrueshmërinë janë mungesa e përfshirjes politike dhe mungesa e burimeve financiare për të vijuar me zbatimin e masave të reformës pasi mbyllet një asistencë teknike. Problemi është se asistencë teknike mund të bëhet si zëvendësuese dhe vepron si mbështetëse për alokimet e burimeve kombëtare.

Raporti final i “Vlerësimit të sektorit të së drejtave të njeriut për programet IPA në Shqipëri” (prill 2016) është përmbyllur me shprehjen se ndikimi i mbështetjes së BE-së për përmirësimin e Shtetit të së Drejtës dhe standardet e zbatimit të ligjit janë ende të kufizuara nga dobësia e sistemit, por mund të ketë efekt domethënës menjëherë sapo reforma në drejtësi do të eliminojë vështirësitë ekzistuese strukturore. Raporti evidenton që projektet EURALIUS dhe PAMECA kanë historik të suksesshëm dhe arritje në sektorin e drejtësisë dhe të zbatimit të ligjit. Gjithsesi, qëndrueshmëria e tyre është e lidhur me progresin në reformat kushtetuese. Një koordinim më i mirë i rezultateve të ndërhyrjeve të mëparshme mund të kërkohej në lidhje me infrastrukturën teknike. Raporti shton se pas avancimit në reformën kushtetuese, kërkohej të hartohen projekte të ardhshme, me qëllim që të fokusohen në forcimin e procesit të reformës dhe efektivitetin e tij.

Gjithashtu, raporti rekomandon për EURALIUS-in dhe PAMECA-n e ardhshme të përqendrohen në mbështetjen në luftën kundër korrupsionit, në lidhje me parandalimin dhe sanksionet, të kombinuara me monitorimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Fusha të tjera të rëndësishme mund të jenë: i. forcim kapacitetesh për zbatimin e strategjisë së reformës në drejtësi, me qëllim planifikimin, monitorimin, hartimin e ligjeve dhe vlerësimet rregullatore/legjislative; ii. zhvillimi i sistemit të karrierës në gjyqësor; iii. përmirësimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore; iv. vlerësimi i cilësisë dhe rishikimi i kuadrit ligjor në disa fusha për të siguruar përputhshmërinë me *acquis* të BE-së dhe praktikën më të mira, si dhe v. forcimi i sistemit të statistikave për të dhënat e gjyqësorit.

Që kur zbatimi i ligjeve dhe politikave rezultojnë gjerësisht nga legjislatura e dobët dhe proceset politike, kujdes duhet t'i kushtohet zhvillimit të legjislacionit në përputhje me procedurat kombëtare, veçanërisht ato të lidhura me vlerësimet e ndikimit rregullator dhe fiskal, konsultimeve me publikun dhe koordinimi ndër-institucional, si dhe duhet të sigurohet linjëzimi me kuadrin e buxhetimit afatmesëm.

2. Logjika e ndërhyrjes

¹⁰ Ekonomia politike e donatorëve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi: Harta dhe potenciali për sinergji më të forta, Raporti final, gusht 2014, faqe 91.

¹¹ Ibid (po aty).

Logjika e ndërhyrjes në fjalë synon të përmbledhë ndërveprimet dhe efektet e kombinuara të kontratës për reformën sektoriale dhe të përmirësojë dialogun politik që po vijon në këtë fushë. Risqet gjatë zhvillimit të efektivitetit qeveritar trajtohen duke vendosur praktikën e mirëqeverisjes dhe krijojnë një bazë të qëndrueshme të sundimit të ligjit/shtetit ligjor, në veçanti duke përmirësuar transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e administratës publike shqiptare, uljen e rasteve të pandëshkuara, duke forcuar sistemet TI, të cilat përdoren nga institucionet publike, duke përmirësuar bashkëpunimin midis agjencive ligjzbatuese, hetimore, proaktive, si dhe duke rritur ndërgjegjësimin e publikut - duke i shërbyer uljes së risqeve që lidhen me korrupsionin në Shqipëri dhe duke përmirësuar besimin e publikut në sistemin gjyqësor.

Struktura monitoruese dhe koordinuese e Strategjisë Sektoriale të Drejtësisë do të monitorojë zbatimin e strategjisë dhe do të raportojë mbi baza vjetore, për monitorimin dhe performancën e treguesve të matshëm dhe synimeve.

PËRSHKRIMI I OBJEKTIVAVE, AKTIVITETET KRYESORE DHE REZULTATET E PRITSHME

Objekti i përgjithshëm është të kontribuojë në forcimin e shtetit të së drejtës, zbatimit të ligjit dhe reduktimin e korrupsionit në agjencitë qeveritare dhe ato gjyqësore.

Objektivat specifikë janë si më poshtë:

- të forcohet pavarësia, transparenca, eficienta, llogaridhënia dhe besimi i publikut ndaj sistemit gjyqësor shqiptar, në përputhje me standardet evropiane;
- të përmirësohet mbrojtja e të drejtave të njeriut në sistemin e burgjeve.

Rezultatet e pritshme të kësaj ndërhyrjeje janë si në vijim:

- institucionet e sistemit gjyqësor të pavarura, eficientë dhe llogaridhënës, dhe që do të sigurojnë përfaqësim të barabartë gjinor;
- transparenca dhe mundësitë e përfshirjes në sistemin gjyqësor, të përmirësuara;
- edukimi ligjor dhe trajnimet e konsoliduara;
- sistemi i drejtësisë penale, i përmirësuar dhe efektiv;
- menaxhimi i infrastrukturës së sistemit elektronik gjyqësor, i përmirësuar;
- funksionimi i Ministrisë së Drejtësisë, i përmirësuar;
- akses i rritur në sistemin gjyqësor, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve nga ana e profesioneve ligjore;
- masat për riintegrimin dhe rehabilitimin për të dënuarit, sipas standardeve evropiane.

Aktivitetet kryesore

Aktivitetet kryesore gjatë zbatimit të paketës së mbështetjes buxhetore janë dialogu politik, transferimi financiar, vlerësimi i performancës, raportimi dhe zhvillimi i kapaciteteve:

- angazhimi në dialog politik për kushtet dhe prioritetet e reformave qeveritare, verifikimin e kushteve, synimeve dhe pagesave të mbështetjes buxhetore;

- transferimi i 34 milionë EUR te vendi përfitues gjatë viteve fiskale 2019, 2020, 2021 dhe 2022, me disburimet e kështit fiks dhe variabël;

- mbështetje e vazhdueshme për forcimin e institucioneve qeveritare për të zbatuar reformat në sistemin gjyqësor, duke përfshirë institucionet e reja dhe mandatet që rezultojnë nga ndryshimet e kuadrit ligjor;

- përmirësimi i koordinimit të donatorëve përmes rritjes së kapaciteteve në sektorin e drejtësisë nëpërmjet asistencës teknike;

- krijimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimi, për të regjistruar zbatimin e Strategjisë për Reformën në Drejtësi nëpërmjet rritjes së kapaciteteve;

- monitorim i rregullt i kritereve të ligjshme të mbështetjes buxhetore.

Në nivelin e kontributeve/inputs, transferimi i fondeve të mbështetjes buxhetore do të mundësojë qeverinë të përmirësojë aftësitë financiare për të marrë përsipër objektivat dhe zbatimin e politikave në sektorin e drejtësisë. Gjithashtu, dialogu politik dhe fokusi në përmirësimin e koordinimit sektorial do të kontribuojnë, mes të tjerash, në ndjekjen e zbatimit të politikave dhe do të përmirësojnë monitorimin dhe vlerësimin e sektorit. Asistenca teknike do të mbështesë zbatimin e reformave, përmirësimin e një komunikimi dhe rritjen e ndërgjegjësisë, monitorimin e rregullt dhe shqyrtimin e pajtueshmërisë të progresit të reformës.

Në nivelin e rezultateve, asistenca do të kontribuojë në:

- **Institucione të pavarura, eficiente dhe llogaridhënese të sistemit gjyqësor, duke mundësuar përfaqësim të barabartë të femrave midis gjykatësve dhe prokurorëve** (si rezultat i zbatimit të objektivit nr. 1 të Strategjisë: Forcimi i pavarësisë, eficiencës, efektivitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit gjyqësor”) nëpërmjet zbatimit të ligjeve, 14 të reja ose të amenduara organike, të cilat duhet të çojnë në konsolidimin e misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të sektorit gjyqësor. Kjo duhet të rezultojë në një shkallë shqyrtimesh të çështjeve të përmirësuara; rritje të numrit të çështjeve të gjykuara në vit në gjykatat e shkallës së 2-të dhe të 3-të dhe ankesat e shqyrtuara. Një çështje është dhe përfaqësia e barabartë e femrave gjykatëse dhe prokurore, si drejtuese të gjykatave në rrethe dhe zyrat e prokurorisë.

- **Edukimi ligjor dhe trajnimi, të konsoliduara** (si rezultat i zbatimit të objektivit nr. 2 të Strategjisë: Konsolidimi i edukimit dhe trajnimit në fushën ligjore, si dhe specializimi i gjyqtarëve dhe i personelit të gjyqeve). Ngritja e kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës dhe zbatimi i ligjeve të reja ose të amenduara në institucionet qeverisëse të sistemit gjyqësor do të rezultojë në përmirësimin cilësor të trajnimit ligjor, në lidhje me kurrikula të reja për programin e trajnimit të vazhdueshëm, të identifikuar në analizën e nevojave për trajnime, gjithashtu, edhe në përmirësimin sasior, duke rritur numrin e studentëve që mund të akomodohen në Shkollën e Magjistraturës pas ndërtimit të ambienteve të reja.

- **Përmirësimi i transparencës dhe i pjesëmarrjes në sistemin gjyqësor** (si rezultat i objektivit nr. 3 të Strategjisë: Duke garantuar eficiencën, transparencën dhe përfshirjen në sistemin gjyqësor dhe të drejtën për të zhvilluar procese ligjore në përputhje me standardet evropiane) do të lejojë akses të përmirësuar të ndihmës ligjore për qytetarët. Çaktimi i gjyqtarëve për marrëdhëniet me mediet do të përmirësojë transparencën e sistemit gjyqësor.

- **Përmirësimi i efektivitetit të sistemit të gjykatës penale** (si rezultat i objektivit nr. 4 të Strategjisë: Rritje e eficiencës dhe masat kundër korrupsionit përmes konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të gjykatës penale) do të sigurohet nëpërmjet procedurave të vetingut për gjykatësit dhe prokurorët dhe duke rritur numrin e çështjeve të kapura korruptive nga Gjykata e Posaçme për Antikorrupsionin. Për sa i përket drejtësisë për të miturit, synohet të ulet numri i të miturve në qendrat e burgimit.

- **Përmirësimi i infrastrukturës dhe i funksionimit të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore** (si rezultat i zbatimit të objektivit 5 të Strategjisë: Përmirësimi i funksionimit të sistemit gjyqësor, duke mundësuar sisteme me procedura dhe mjete moderne elektronike, me qëllim zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar), do të arrihet përmes investimeve të orientuara drejt prezantimit të një sistemi TI për gjykatat dhe ngritjen e infrastrukturës së gjykatave, duke rezultuar në forcimin e kapaciteteve operacionale të gjykatave dhe menaxhimit të çështjeve.

- **Strukturë e re organizative në Ministrinë e Drejtësisë** (objektivi nr. 6 i Strategjisë: Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe i institucioneve në varësi, të atyre të reja ose atyre që ndryshojnë në thelb) do të rezultojë si strukturë e rregulluar e Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me ndryshimet që sjell reforma në sistemin gjyqësor (ndarja mes degëve të ekzekutivit dhe gjyqësorit). Ministria do të ruajë burimet nëpërmjet Drejtorisë së Inspektimit, i cili mund të përdoret për të forcuar dhe për të rritur kapacitetet për inspektimet e profesioneve të lira ligjore. Gjithashtu, ndryshimet e reja do të mundësojnë që Ministria e Drejtësisë të kryejë një analizë ligjore nëpërmjet Drejtorisë së Kodifikimit, përpara se të ndërmarrë ndonjë nismë ligjore ose politike.

- **Rritje e aksesit në sistemin gjyqësor përmes përmirësimit të shërbimeve të profesioneve ligjore dhe arbitrazhit** (si rezultat i objektivit nr. 8 të Strategjisë: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të profesioneve ligjore dhe vendosja e kuadrit ligjor për arbitrazhin) do të arrihet nëpërmjet amendimit të ligjit për noterët, ligjit për avokatët, legjislacionit që lidhet me sistemin e përmbartimit dhe legjislacionit të ri për raste e dënimeve alternative, pra rritjen dhe akses më i lehtë në sistemin gjyqësor dhe uljen e ngarkesës së çështjeve në gjykim nga gjykatat.

- Masat riintegruese dhe rehabilitimi i të dënuarve me burgim, sipas standardeve evropiane (si rezultat i zbatimit të objektivit nr. 6 të Strategjisë: Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e kryerjes së dënimit) do të mundësojë hartimin e politikave, me qëllim forcimin e dënimeve alternative. Fokus do të jepet në aktivitetet riintegruese.

- Në nivelin e produkteve (objektivat specifikë):

- “Përmirësimi i kuadrit institucional dhe operacional” do të rezultojë me uljen e kohës për

shqyrtimin e çështjeve dhe uljen e çështjeve të prapambetura, përmirësimin e aksesit në drejtësi dhe pavarësinë gjyqësore.

- “Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e burgjeve” do të reduktojë popullimin e burgjeve drejt objekteve të disponueshme. Në përgjithësi parashikohet ulje e numrit të të dënuarve përmes përdorimit të dënimeve alternative.

MBËSHTETJA PLOTËSUESE

Një asistencë plotësuese në formën e forcimit të kapaciteteve do të ketë si qëllim: i. forcimin e kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë, si koordinatorë dhe të institucioneve të tjera të sektorit të drejtësisë, për të monitoruar dhe për të raportuar zbatimin nëpërmjet strukturave monitoruese; ii. mbështetje për Ministrinë e Drejtësisë, për të përmirësuar kapacitetet e kodifikimit në hartimin e ligjeve, me qëllim zbatimin e Kodit të Procedurave Administrative; iii. të japë këshilla në hartimin e politikave dhe forcimin e kapaciteteve të sektorit gjyqësor, në veçanti në organet e ngritura së fundi; iv. forcimin e bashkëpunimit me grupet e tjera të interesit, si për shembull, organet e antikorrupsionit dhe agjencitë ligjzbatuese, si edhe të mbështesë konsultimin me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët për zhvillim këshillimor, me qëllim që të kontribuojnë në zbatimin e reformës.

Asistenca shtesë do të mbështesë veprimet e pavarura monitoruese për gjyqtarët dhe prokurorët e rivlerësuar dhe një tjetër do të monitorojë në mënyrë të pavarur dhe do të vlerësojë zbatimin e programit për reformën sektoriale.

Rezultatet e pritshme të asistencës teknike plotësuese janë:

- kapacitetet janë përmirësuar përmes trajnimit të stafit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera të sektorit të drejtësisë, për të koordinuar dhe për të zbatuar Strategjinë Sektoriale të Drejtësisë;
- dialogu politik për zbatimin e reformës së gjyqësorit i përmirësuar përmes kontributit nga vlerësimet e pavarura dhe përpunimi i të dhënave gjatë zbatimit;
- procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, me mbështetjen e monitorimit të pavarur, i përmirësuar;

Treguesit kyç të performancës që lidhen me asistencën plotësuese teknike do të përfshijnë:

- numri i ditëve të trajnimit për çdo person, të siguruara ose lehtësuara;
- numri i takimeve monitoruese të mundësuar;
- numri i aktiviteteve me fokus dialogun politik, me pjesëmarrjen e grupeve shtetërore të interesit, donatorëve, shoqërisë civile etj., janë mbështetur për t’u realizuar;
- numri i aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit dhe aktiviteteve komunikative si pjesë e planit të komunikimit për të përmirësuar ndërgjegjësimin e publikut në zbatimin e reformës së drejtësisë;
- numri i studimeve/i sondazheve të realizuara në nivelin e atyre që përdorin sistemin gjyqësor dhe numri i personave që janë të kënaqur ose kanë besim te personeli i gjyqësorit;¹²
- numri i vlerësimeve të pavarura në zbatimin e reformës në sistemin e gjyqësorit dhe përputhshmëria me kërkesat e përgjithshme dhe specifike të kontratës së reformës sektoriale, të plotësuar;
- numri i çështjeve për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të monitoruar.

Mbështetje domethënëse jepet aktualisht nëpërmjet ndërhyrjes afatgjatë të EURALIUS V¹³, “Mbështetje për konsolidimin e sistemit gjyqësor në Shqipëri”¹⁴. Qëllimi është të ofrojë mbështetje domethënëse për zbatimin e reformës në drejtësi dhe për institucionet e përfshira, duke forcuar pavarësinë, transparencën, llogaridhënien dhe besimin e publikut në sistemin shqiptar të drejtësisë, në përputhje me *acquis* të BE-së dhe praktikat më të mira.

KUADRI I MENAXHIMIT TË RISKUT

Risqet kryesore të lidhura me Reformën në Sistemin e Drejtësisë janë si në vijim:

Risku	Niveli	Masat rregullatore
Miratimi i vonuar i ligjeve të lidhura me paketën e reformës	I mesëm	Dialog i vazhdueshëm politik me të gjithë negociatorët, duke përfshirë partitë kryesore të opozitës, të cilët janë esenciale për

¹² Në përputhje me CEPEJ-në janë përshtatur raporti dhe sondazhi të shoqëruara me guidën e metodologjisë të përgatitur nga Jean-Paul Jean dhe Hélène Jorry.

¹³ <http://www.euralius.eu/index.php/en/>

¹⁴ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/ipa_2016-038717-4_consolidation_of_the_justice_system_in_albania.pdf

Risku	Niveli	Masat rregullatore
		të miratuar legjislationin kryesor
Vonesa në ngritjen e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, që lidhen me ndikimin e procesit të vetingut	I mesëm	Dialog i vazhdueshëm politik me të gjithë negociatorët e partive kryesore opozitare për identifikimin e zgjidhjeve për të përshpejtuar procesin
Mungesa e angazhimit, mbështetjes politike dhe pronësisë mbi procesin, për të forcuar vendimmarrjen dhe zbatimin e Planit të Veprimit	I mesëm	Dialog politik i vazhdueshëm në kontekstin e dialogut të nivelit të lartë dhe mbështetjen e BE-së për zbatimin e udhërrëfyesve, për sa u përket prioriteteve kyçe që i nevojiten hapjes së negociatave Udhëzues nga BE-ja përmes dialogut politik në punën midis palëve gjatë procesit të integritimit në BE. Mbështetja e BE-së për Parlamentin për të përmbushur rolin mbikëqyrës ndaj institucioneve të pavarura për të forcuar rolin e tyre monitorues Programi është projektuar në konsultim të ngushtë me një rreth të gjerë grupesh interesi për të identifikuar se cila mbështetje do të ishte më e përshtatshme për t'u "vënë në pronësi" dhe ka si fokus mbështetjen e funksioneve të institucioneve përkatëse
Mungesa e financimit për zbatimin e Planit të Veprimit (në veçanti, institucioneve të reja) dhe mungesa e perspektivës afatmesme mund të ndikojë negativisht te grupet e interesit dhe aftësia e tyre për të përmbushur mandatet e tyre dhe zbatimin e planit të veprimit	I lartë	Instrumentet e parashikuara (mbështetje buxhetore dhe mbështetje për prokurimet) do të kontribuojnë për të zvogëluar riskun e mosfinancimit. Duhet të sigurohet që do të ketë buxhet të mjaftueshëm dhe të trajtojnë qëllimet e caktuara. Kjo do të sigurohet me përcaktim të saktë dhe monitorim të treguesve të performancës për zbatimin e Planit të Veprimit Aftësitë për buxhetim afatmesëm të institucioneve të gjyqësorit duhet të forcohen.
Kapacitet i kufizuar, absorbimi dhe mungesa e burimeve njerëzore për të kryer proceset e reformës	I mesëm	Mbështetje nëpërmjet forcimit të kapaciteteve me asistencat aktuale dhe ato plotësuese, me qëllim lehtësimin e reformave, si projektet EURALIUS dhe PAMECA dhe projektet e planifikuara për të pasuar këto ndërhyrje
Koordinimi i kufizuar sektorial, progres i ngadaltë në ngritjen e kuadrit koordinues dhe monitorues	I lartë	Mbështetje për Ministrinë e Drejtësisë si institucion koordinator, për të organizuar seksione monitoruese gjatë zbatimit të Strategjisë, si asistencë plotësuese që shoqëron veprimtarinë e mbështetjes buxhetore. Mbështetje për takimet e strukturave koordinuese dhe Sekretariatit Teknik
Kompleksiteti i reformës nuk mund të menaxhohet në mënyrë efektive dhe eficiente nga institucioni lider, duke pasur parasysh nevojat për të ndarë pushtetin mes ekzekutivit dhe gjyqësorit		

Këto risqe do të monitorohen nëpërmjet dialogut politik, për prioritetet kyçe që lidhen me reformën në sektorin e drejtësisë.

3. ZBATIMI

3.1 ROLET, PËRGJEGJËSITË DHE DIALOGU POLITIK

Vendimi për ngritjen formale të strukturave koordinuese dhe monitoruese për zbatimin e Strategjisë së Drejtësisë është miratuar, prandaj përmbajtja e Grupit Ndërsektorial për reformën në fushën e drejtësisë është e përcaktuar si më poshtë: zëvendësministri i Drejtësisë dhe 1 përfaqësues nga institucionet e listuara

në vijim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave që mbulon çështjet e koordinimit të dokumenteve strategjike, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektorati i Lartë, Prokuroria e Përgjithshme, Inspektorati i Lartë, Shkolla e Magjistraturës, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësuesve.

Gjithashtu, përfaqësues të donatorëve dhe partnerëve për zhvillim që asistojnë institucionet e sistemit gjyqësor, si edhe përfaqësues të shoqërisë civile do të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e grupit të monitorimit, për t'u konsultuar. Raporti i parë monitorues për zbatimin e Strategjisë për vitin 2017 është publikuar tashmë.

Deri në ngritjen e institucioneve të reja, mekanizmi institucional është ngritur për të monitoruar zbatimin e Strategjisë dhe planin e saj të veprimit. Për të asistuar mekanizmin institucional, po vepron një Sekretariat Teknik pranë Ministrisë së Drejtësisë. Sekretariati Teknik mbledhet çdo muaj dhe koordinon punën me të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit. Ai përgatit një raport çdo 6 muaj mbi zbatimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit dhe nivelin e arritjes së treguesve, si edhe mbi problemet e identifikuara dhe buxhetin e alokuar dhe të shpenzuar. Raportet do të vlerësohen më tej dhe do të miratohen nga një mekanizëm monitorues institucional. Në fund të kohës së zbatimit të Strategjisë, Sekretariati Teknik do të hartojë një raport vlerësues për zbatimin e Strategjisë dhe arritjet e objektivave dhe vizionit të Strategjisë.

Dialogu politik në progres dhe monitorimi i performancës në trajtimin e risqeve do të drejtohet nga Grupi Ndërsektorial i Punës për reformën në drejtësi të paktën 2 herë në vit. Përveç kësaj, takime të veçanta të dialogut politik mund të organizohen në baza *ad hoc*, sipas nevojës.

Organizatat e Shoqërisë Civile që janë konsultuar gjatë përgatitjes së Strategjisë janë: Instituti i Studimeve Politike dhe Ligjore, Qendra për Nismat Ligjore Qytetare, Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut dhe Komiteti i Helsinkit në Shqipëri. Paraprakisht është përcaktuar se këto do të konsultohen edhe gjatë zbatimit të Strategjisë.

3.2 METODAT E ZBATIMIT DHE LLOJET E FINANCIMIT

Shuma e alokuar për komponentin e mbështetjes buxhetore është 34 milionë euro dhe 8 milionë euro për mbështetje plotësuese. Këto shuma janë bazuar në një kombinim të : a) kostoja e Strategjisë; b) hendeku financiar; c) niveli i vlerësuar i buxhetit të shtetit mjaftueshmërisht inkurajues për të kryer reformat. Kostoja e përgjithshme e vlerësuar për zbatimin e Planit të Veprimit, për vitet 2017–2021 është 98.4 milionë euro nga të cilat 58.5 milionë euro janë parashikuar për t'u mbuluar nga buxheti i shtetit, duke përfshirë përdorimin e fondeve rezervë që janë lënë mënjane për të mbështetur zbatimin e Strategjisë. Si rrjedhojë, hendeku financiar arrin 39.9 milionë euro për periudhën 2017–2021.

3.2.1 Disbursimet e mbështetjes buxhetore sektoriale

Kushtet e përgjithshme për disbursimin të transheve janë si më poshtë:

- progres i kënaqshëm në zbatimin e reformës në sektorin e drejtësisë dhe besueshmëri e vazhdueshme në të;
- zbatimi i një politike të besueshme makroekonomike të orientuar drejt stabilitetit;
- progres i kënaqshëm në zbatimin e Strategjisë mbi reformat në menaxhimin e financave publike;
- progres i kënaqshëm në diponueshmërinë e publikut dhe informimin në kohë për çështjet e buxhetit;

Kushtet specifike për disbursimin që mund të përdoret për këstet variabël fokusohen kryesisht në fushat që lidhen me forcimin e pavarësisë, eficiencës dhe llogaridhënies së institucioneve të drejtësisë dhe përmirësimin e funksionimit të gjyqësorit, në përputhje me:

Treguesit dhe synimet për këstin variabël janë përcaktuar në aneksin 2.

Synimet dhe treguesit e performancës që janë zgjedhur për disbursimin e fondeve, do të aplikohen gjatë gjithë kohës së zbatimit të programit. Gjithsesi, në situata të justifikuara, Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet Koordinatorit Kombëtar të Fondeve IPA, mund të dorëzojë kërkesa pranë Komisionit Evropian për ndryshimin e treguesve dhe synimeve. Ndryshimet e rena dakord për treguesit dhe synimet, mund të autorizohen nëpërmjet shkëmbimit të letrave midis dy palëve.

Në rast se shkelen vlerat themelore, disbursimet e mbështetjes buxhetore mund të pezullohen formalisht dhe përkohësisht, të zvogëlohen ose të digjen, sipas parashikimeve përkatëse të përcaktuara në Marrëveshjen e Financimit.

3.2.2 Detajet e mbështetjes buxhetore

Shuma e përgjithshme e mbështetjes buxhetore është e ndarë në katër kështe, i pari me një pjesë fikse dhe të tjerët me një pjesë fikse dhe variable. Kushtet specifike për disbursimin e secilit kësht janë specifikuar në shtojcë.

Mbështetja për buxhetin ofrohet si mbështetje e drejtpërdrejtë pa synim për buxhetin në Thesarin e Shtetit. Kreditimi i transfertave në euro të disbursuara në lekë shqiptarë do të kryhet sipas normave të përshtatshme të këmbimit, në përputhje me dispozitat përkatëse të Marrëveshjes së Financimit.

3.2.3 Mbështetja plotësuese

Zbatimi i asistencës plotësuese do të përfshijë tri ose më shumë kontrata shërbimi në menaxhim direkt të fondeve.

4. Monitorimi dhe vlerësimi

Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi i përditshëm teknik dhe financiar i zbatimit të këtij veprimi do të jetë një proces i vazhdueshëm dhe pjesë e përgjegjësisë të partnerëve të zbatimit. Për këtë qëllim, partneri zbatues do të krijojë një sistem të përhershëm të brendshëm teknik të monitorimit financiar të veprimit dhe për të nxjerrë raporte sistematike të progresit (jo më pak se vjetore) e raporte përfundimtare. Secili raport do të japë një pasqyrë të saktë të zbatimit të veprimit, vështirësive të hasura, ndryshimeve të bëra, si dhe shkallës së arritjes së rezultateve (produktet dhe rezultatet e drejtpërdrejta), të matura nëpërmjet treguesve korrespondues, duke përdorur listën e treguesve të rezultateve si referencë. Raporti do të hartohet në mënyrë të tillë që të mundësojë monitorimin e mjeteve të parashikuara dhe të zbatuara, si dhe të detajeve buxhetore për veprimin. Raporti përfundimtar, i cili do të jetë në formë narrative ose financiare, do të mbulojë të gjithë periudhën e zbatimit të veprimit.

Ministria e Drejtësisë ka rolin drejtues dhe duhet ta rikonfirmojë nëpërmjet një vendimi politikëbërës ose marrëveshjeje bashkëpunimi të nënshkruar nga të gjitha grupet e interesit të sistemit gjyqësor, sapo të gjitha institucionet e reja të jenë ngritur dhe bërë operacionale. Monitorimi përmes Grupit Ndërsektorial të Punës për Reformën në Drejtësi do të zhvillohet me koordinimin dhe rolin e sekretariatit të Ministrisë së Drejtësisë, bazuar në kontributet e Planit të Veprimit, si tregues të rezultateve.

Në nivel kombëtar, zbatimi i Strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale është i monitoruar përmes sistemit të vlerësimit të performancës mbi bazë rezultatesh, i cili bazohet në objektiva politikë dhe ata të programit, si pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar të Politikave (IPS), i cili koordinohet nga Kryeministria. IPS-ja është një listë parimesh operacionale që sigurojnë se planifikimi politik i qeverisë, buxheti dhe monitorimi, janë të lidhura dhe veprojnë në mënyrë eficiente. IPS është një sistem kyç për drejtimin strategjik dhe orientimin e drejtimin e alokimit të burimeve financiare. Ai orienton planifikimin afatmesëm buxhetor dhe procesin vjetor të buxhetimit, duke caktuar objektivat politikë, të cilët janë përfshirë në udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit nga të gjitha ministrinë dhe agjencitë.

Zbatimi i Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike, 2014–2020, është, gjithashtu, thelbësor për reformën në sistemin gjyqësor në lidhje me përmirësimin e procesit të hartimit të buxhetimit afatmesëm, pra planifikim të mirë, buxhetimin dhe monitorimin e Strategjisë së Sektorit të Drejtësisë, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (i cili në të ardhmen do të përfshijë dhe Zyrën e Administrimit dhe Buxhetimit të Gjyqësorit, në funksion të menaxhimit të financave publike). Zbatimi i Strategjisë së MFP-4së është i rëndësishëm për arritjen e kriterëve që lidhen me mbështetjen buxhetore sektoriale të sektorit të drejtësisë (Stabilitet Makroekonomik, menaxhim të financave publike dhe transparencë buxhetore). Raportet mbi Strategjinë e MFA prodhohen nga Komiteti Monitorues i Reformës për MFP dhe publikohen çdo vit në tremujorin e parë të vitit. Në të njëjtën kohë, zbatimi i Strategjisë për Sektorin e Drejtësisë do të kontribuojë në forcimin e shtetit të së drejtës, për shembull, në prokurimet publike.

Për komponentin e asistencës teknike, Komisioni mund të ndërmarrë vizita monitoruese shpesh, nëpërmjet stafit të tij dhe këshilluesve të pavarur të punësuar drejtpërdrejt nga Komisioni për rishikime të pavarura monitoruese (ose të punësuar nga agjenti përgjegjës i kontraktuar nga Komisioni për zbatimin e këtyre rishikimeve). Ushtrimet monitoruese do të zhvillohet sipas udhëzuesve të përshkruar nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerimin dhe Fqinjësinë, për të lidhur planifikimin/programimin, monitorimin dhe vlerësimin¹⁵.

¹⁵http://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/tenders/monitoring-and-evaluation_cs

Do të këtë rishikime vjetore të cilat do të vlerësojnë performancën kundrejt të gjitha kushteve, ku shkalla e përputhshmërisë do të cenoje raportin e pagesës së kështit të lëshuar për pagesën e komponentit variabël. Secili nga këto rishikime do të kontrollojë kriteret e ligshmërisë për MBS-në dhe do të vlerësojë progresin e kënaqshëm dhe relevancën e vazhdueshme dhe kredibilitetin e secilit kriter.

Përputhshmëria me të katër kushtet e përgjithshme do të synojë lëshimin e pagesës së kështit fiks, pasi të nënshkruhet Marrëveshja e Financimit.

Gjithashtu, DG NEAR mund të përdorë ROM (monitorimin e bazuar në rezultate) si pjesë e angazhimeve të vazhdueshme për të monitoruar shpenzimet e ndihmës, sipas Rregullores Financiare të BE-së.

VLERËSIMI DHE AUDITIMI

Vlerësimet e komponentit të mbështetjes buxhetore duhet të jenë në harmoni me praktika të ngjashme të ofruesve të tjerë të mbështetjes buxhetore, për qëllime të llogaridhënies dhe mësimit, në nivele të ndryshme (duke përfshirë rishikimin e politikave) dhe kryhen nëpërmjet konsulentëve të pavarur.

Për mbështetje plotësuese, Komisioni mund të kryejë edhe vlerësime të jashtme, si vijojnë:

- një mision vlerësimi të ndërmjetëm;
- një vlerësim përfundimtar, në fillim të fazës përmbyllëse;
- një vlerësim *ex-post*;

Komisioni njofton partnerin zbatues të paktën 2 muaj para datës së parashikuar për misionet e vlerësimit. Partneri zbatues bashkëpunon në mënyrë efikase dhe me efektivitet me ekspertët vlerësues dhe ndër të tjera, u ofron atyre të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, si dhe akses në ambientet e aktivitetet.

Raportet e vlerësimit ndahen me vendin partner dhe palët e tjera kyçe. Partneri zbatues dhe Komisioni analizojnë konkluzionet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, kur është e përshtatshme, në marrëveshje me vendin partner, bien dakord bashkërisht për ndërmarrjen e veprimeve të ndjekjes së procesit dhe ndryshimeve, nëse është e nevojshme, duke përfshirë, nëse përcaktohet, edhe riorientimin e projektit. Financimi i veprimeve të vlerësimit do të mbulohet nga një tjetër masë.

5. Çështjet e tërthorta

MUNDËSITË E BARABARTA DHE INTEGRIMI GJINOR

Gratë, në veçanti ato vulnerabël, përballen me shumë sfida në aksesin në drejtësi: në Shqipëri, pabarazitë vijojnë të ekzistojnë në përballjen midis burrave dhe grave, ekuilibrit gjinor dhe stereotipat rezultojnë në aksesin e pabarabartë të grave dhe burrave në sektorin e drejtësisë. Gratë përballen me barriera domethënëse në aksesin ndaj drejtësisë në fushat që vijojnë: të drejtat ndaj pronësisë, regjistrimi i pronave/i legalizimeve, trashëgimitë, ndarja e pronave gjatë divorcit dhe mbajtja, dhe pagesat ushqimore. Ka mungesa të theksuara të aksesit në gjykata dhe mjeteve financiare, mungesë njohurie dhe perceptim të shoqërisë shqiptare për pozicionin e gruas në familje, të cilat ndikojnë në aksesin e grave. Vihet re një numër në ngritje i ankesave të grave si viktimat të dhunës në familje. Shpeshherë gratë nuk kanë të drejta pronësie, legjislacioni mbi pronat favorizon burrat (pas komunizmit: shpërndarja e pronave është bërë kryesisht të meshkujt). Statistikat tregojnë se shumica e atyre që përfitonin nga ndihma ligjore ishin gra. Shumë OSHC, në veçanti Qendra për Nismat Ligjore Civile, rrjeti AWEN për SHC-të lokale, Koalicioni Drejtësi për të Gjithë, janë aktivë në fushat që lidhen me aksesin në drejtësi, çështjet gjinore dhe mbrojtjen e grave dhe grupeve vulnerabël.

Gjithashtu, gratë synojnë të ndikohen në mënyrë jo të barabartë nga korrupsioni. Gratë synojnë të shpenzojnë më shumë kohë në punë të papaguara, si, për shembull, kujdesi ndaj personave të sëmurë në familje, si rrjedhojë e ndiejnë ndikimin e korrupsionit në dhënien e kufizuar të shërbimeve më shumë se burrat (UNIFEM 2008: *Chêne, Clench* dhe Fagan 2010). Ato, gjithashtu, kanë më shumë probabilitet të rrezikohen nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe prostitucioni¹⁶. Zbatimi i reformës do të marrë parasysh aspekte të tilla të barazisë gjinore.

Çështjet e minoriteteve dhe grupeve vulnerabël nuk janë reflektuar ende në Planin e Veprimit. Ato duhet të detajohen më shumë gjatë rishikimit të Planit të Veprimit. Çështjet kyçe të cilat kërkojnë mbështetje do të trajtohen me IPA-në, si në mënyrë të integruar edhe nëpërmjet synimeve të caktuara,

¹⁶ Kostot e korrupsionit dhe strategjitë e zgjidhjes së problemeve (FMN, maj 2016)
<https://www.imf.org/external/pubs/ft/sdn/2016/sdn1605.pdf>

përfshijnë si vijon:

- kryerja e analizave për çështjet gjinore në sektorin e drejtësisë, si pjesë integrale e reformës;
- ngritja e një mekanizmi të fuqishëm institucional në sistemin e drejtësisë dhe të gjyqësorit për të monitoruar dhe për të drejtuar procesin për një barazi më të madhe për çështjet gjinore;
- mbështetje për përcaktimin e treguesve gjinorë që do të lejojnë monitorimin e ndikimi gjinor në reformën e drejtësisë mbi gratë dhe burrat e, veçanërisht, në grupet e marginalizuara, vulnerabël dhe të diskriminuara, në përputhje me masat e BE-së për barazi gjinore dhe fuqizimin e grave përmes marrëdhënieve me jashtë të BE-së, 2016–2020. Mbështetje do të jepet për të rritur kapacitetet dhe aftësitë e stafeve ligjore, gjykatësve, personelit të gjykatave, specialistëve të jashtëm mbështetës së gjykatave, përmbauesve, avokatëve, për çështjet gjinore, përmes: i. rishikimit të kurrikulave përkatëse për çdo profesion të institucioneve teknike dhe akademike; ii. integrimi i trajnimeve të detyrueshme për barazinë gjinore, të drejtat e grave, ndikimi gjinor mbi sistemin ligjor dhe gjyqësor dhe çështja e dhunës me bazë gjinore në procesin e edukimit dhe të kualifikimit të gjyqtarëve, juristëve, prokurorëve, personelit të gjyqësorit, specialistëve mbështetës të jashtëm të gjyqësorit etj.; iii. trajnime për barazinë gjinore si pjesë integrale në edukimin ligjor të vazhdueshëm për të gjithë profesionistët e gjyqësorit;
- duke siguruar akses për ndihmë juridike falas, duke përmirësuar sistemin e shërbimeve të lira ligjore, veçanërisht, aksesin për avokatinë falas për gratë që u përkasin pakicave etnike dhe gjuhësore, gratë në zonat rurale, të mbijetuarat nga dhuna dhe gratë që u përkasin grupeve të dizavantazuara;
- rregullore e shërbimit të zyrës së përmbaimit, duke synuar trajtimin e çështjeve të të varfërve dhe të grupeve të marginalizuara, veçanërisht, për gratë dhe ndërmjet tyre;
- mes popullsisë të përgjithshme dhe mes grave dhe grupeve të marginalizuara në veçanti, familjarizimi me termin e “së drejtës”, edukimi ligjor, njohuria për ligje specifike, p.sh., në mbrojtjen kundër diskriminimit dhe në mekanizmin e ankimeve, vlen për të dëshiruar. Parimet kyçe të shtetit të së drejtës dhe zero tolerancë për korrupsionin mësohen në hapat e parë të edukimit në moshë të re, duke filluar nga edukimi parashkollor. Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Arsimit do të mbështeten për të kryer fushata midis moshave dhe grupeve të synuara, për të promovuar kulturën e shtetit të së drejtës dhe rritjen e ndërgjegjësimit, duke përfshirë vajzat dhe djemtë, jo vetëm për të drejtat e tyre por edhe për detyrimet e tyre si qytetarë.

Në përputhje me legjislacionin kombëtar, standardeve të Eurostatit dhe treguesve të harmonizuar shtetërorë (HGI), do të mbështetet miratimi/zhvillimi dhe mbledhja e statistikave për ndarjen gjinore dhe të dhënave gjinore në sektorin e drejtësisë.

Do të ketë mbështetje të vazhdueshme për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë ndërkombëtar dhe transpozimin e ligjeve kombëtare dhe akteve nënligjore, të cilat kanë ndikim, kryesisht te gratë (shihni, p.sh., direktivën e rishikimit, Paketën e Analizës Legjislative të PNUD 2013; Konventa e Stambollit; Konkluzionet e Vëzhgimeve të UN CEDAW – raporti i katërt periodik).

Në përputhje me politikat e diversitetit në BE, masa vepruese afirmative do të realizohen nëpërmjet mundësive të barabarta në jetën profesionale të grave; pjesëmarrje të barabartë të grave dhe përfaqësim në nivelet vendim marrëse. Për sa u përket grave në profesionet e gjyqësorit, situata është e balancuar. Rreth 50% e gjykatësve janë femra, por ka një nivel të ulët të përfaqësisë në organizmat qeveritarë vendimmarrës (për shembull, në Këshillin e Lartë të Drejtësisë janë vetëm 15 anëtare femra).

Disa nga aktivitetet e ndërhyrjes do të rrisin kapacitetet për integrim gjinor për të siguruar cilësinë si BE dhe veçanërisht në funksion të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 465 (2012) që integrimi gjinor të përfshihet në programin e buxhetit afatmesëm. Kujdes i veçantë do t'i jepet lidhjes midis politikave gjinore kombëtare, prioritetëve gjinore sektoriale dhe buxhetimit afatmesëm. Kjo do të kontribuojë në analizimin se sa do të përfitojnë gratë dhe burrat dhe do të identifikojë potencialet për rritjen e efektivitetit të shpenzimeve në sektorin e drejtësisë.

MJEDISI DHE NDRYSHIMET KLIMATERIKE

Mjedisi dhe ndryshimet klimaterike

Mungesa e shtetit të së drejtës dhe niveli i lartë i korrupsionit në sistemin gjyqësor dhe në administratën publike janë duke ndikuar negativisht në mjedis dhe përpjekjet për të kufizuar ndryshimet klimaterike, veçanërisht për rastet e pambështetura të përdorimit të burimeve natyrore dhe rritjen e ndotjes (në ajër, mbetje të ngurta etj.). Ka pasur një numër jashtëzakonisht të vogël të çështjeve mjedisore në gjykatë.

Objekti kryesor i reformës në drejtësi është të forcojë shtetin e së drejtës, zbatimin e ligjit dhe uljen e nivelit të korrupsionit në agjencitë qeveritare dhe gjyqësor. Kjo do të lejojë zbatimin e duhur të legjislationit dhe realizimin e seancave gjyqësore të çështjeve që cenojnë dhe dëmtojnë mjedisin, pra ato që kanë ndikim direkt në mjedis ose ndryshimet klimaterike.

Gjithashtu, këto ndërhyrje do të kenë si synim forcimin e kapaciteteve të zinxhirit të gjyqësorit për të përpunuar çështjet mjedisore, do të mbështesë parimet e ndryshimeve klimaterike në nivelet e politikëbërjes dhe të administratës publike.

ANGAZHIMI ME SHOQËRINË CIVILE (DHE GRUPEVE TË TJERA TË INTERESIT JOSHTETËRORE)

Organizatave e shoqërisë civile po luajnë rol të rëndësishëm në zbatimin e reformës në sektorin e drejtësisë nëpërmjet aktiviteteve të tyre, si, për shembull, ndihmë gjyqësore falas (shihni seksionin 1).

Për sa i përket rritjes së ndërgjegjësimit dhe të monitorimit, shoqëria civile pozicionohet në aktivitetet e mëposhtme:

- rritje e ndërgjegjësimit për qytetarët në organizimin e ri të sistemit të drejtësisë dhe se si mund të ankohen për të drejtat e tyre;
- edukim ligjor për qytetarët në reformën e drejtësisë;
- akses të qytetarëve në institucionet e reja të themeluara në kuadër të reformës;
- monitorimi i çështjeve gjyqësore, i korrupsionit dhe të drejtat përkatëse njerëzore në sistemin e burgjeve;
- dhënie e imputit/kontributit për medien investigative për rastet e abuzimeve.

Nën instrumentin e mbështetjes për shoqërinë civile, 2014–2015, janë mbështetur këto aktivitete. BE-ja ka dhënë 3.4 milionë euro për Shqipërinë, në 4 lote në sektorin e shtetit të së drejtës, specifikuara: 1. Promovimi i mirëqeverisjes dhe lufta kundër korrupsionit; 2. Monitorimi i sistemit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi; 3. Monitorimi i kushteve të jetesës në strukturat e burgjeve; 4. Ripërdorimi i aseteve të konfiskuara organizatave kriminale.

OSHC-ja duhet të forcojë aftësitë e tyre për të monitoruar shërbimet e instrumenteve dhe ato kontrolluese, si një mënyrë për të rritur llogaridhënien e aktorëve publikë për zbatimin e programeve të propozuara dhe politikave. Asistenca plotësuese do të ndihmojë forcimin e kapaciteteve monitoruese të SHC-së.

Është e ditur tashmë se përfaqësues të shoqërisë civile do të caktohen si një nga njëmbëdhjetë anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me të drejta të plota si të gjithë anëtarët e tjerë. Për më tepër, në respektim të ligjit kombëtar për të drejtën e konsultimit, SHC-ja do të asociohen gjatë hartimit të çdo ligji ose akti ligjor, i cili do të zhvillohet gjatë reformës në sektorin e drejtësisë.

Ndërhyrja synon të sigurojë bashkëpunim të ngushtë të aktiviteteve të partnerëve për zhvillim, të cilët janë aleatë të pjesëmarrjes aktive të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit, qeverisjes lokale. OSHC-ja, fondacionet dhe institucionet filantropike janë duke u kthyer në partnerë të qeverisë në kontributin e tyre për zbatimin e reformave, veçanërisht, për shërbimet cilësore ndaj publikut.

MINORITETET DHE GRUPET VULNERABËL

Kujdes i veçantë do t'i kushtohet mbrojtjes së të drejtave njeriut, duke mundësuar akses në drejtësi të grupeve të veçanta, duke përfshirë LGBTI-në, persona me aftësi të kufizuara, të varfër, fshatarë, të moshuar, komunitetet rome dhe egjiptiane, veçanërisht gratë, si dhe të stigmatizuarit e shoqërisë, si p.sh., përdoruesit e drogës, mbartësit e SIDA-s, punonjësit e seksit. Komuniteti LGBTI përballet me diskriminim gjatë procesit të edukimit dhe punësimit të tyre.

Minoritetet dhe grupet vulnerabël nuk janë specifikuara në Planin e Veprimit. Ato duhet të detajohen më tej gjatë rishikimit të Planit të Veprimit.

Qartësimi i procedurave ligjore dhe rritja e fondeve në dispozicion për funksionimin e duhur të shërbimeve ligjore do të zhvillojë aftësimin e tyre që të ushtrojnë të drejtat e garantuara nga Kushtetuta dhe të njohura nga ligji.

Miratimi i ligjit për ndihmën gjyqësore¹⁷ dhe ngritja e Komisionit Shtetëror për Ndihmën Ligjore që synon të përmirësojë aksesin në sistemin gjyqësor të grupeve vulnerabël. Kjo masë ka pasur efekte të kufizuara, për sa kohë që numri i qytetarëve që kanë përfituar nga ndihma ligjore ka mbetur shumë i

¹⁷Ligji nr. 10039, i datës 22 dhjetor 2008 L.

ulët¹⁸. Mbështetje do të jepet nga shumë organizata të shoqërisë civile për të kaluar lidhjet e shkurtra në zbatimin e legjislacionit për ndihmën ligjore, i cili do të pengojë aksesin efektiv në sistemin gjyqësor, veçanërisht të grupeve vulnerabel dhe grave në vende të ndryshme dhe me karakteristika social- ekonomike të ndryshme.

Kujdes i veçantë do t'i kushtohet përshtatjes efektive të direktivave të BE-së, për sa u përket të drejtave procedurale të viktimave dhe të të miturve, si dhe nevojave lidhur me çështjet gjinore. "Paketa e të drejtave procedurale" synon të forcojë të drejtat procedurale të të gjithë të dyshuarve ose të akuzuarve që nuk janë të aftë të kuptojnë dhe të marrin pjesë efektivisht në procedimet penale për shkak të moshës, kushteve mendore dhe fizike, aftësisë së kufizuar, gjinisë ose për shkak të vulnerabilitetit.

Për sa i përket drejtësisë për të miturit, mbështetur nga një projekt i kohëve të fundit nga BE-ja, jep zgjidhje për njësimin e kuadrit ligjor dhe institucional që i përkasin drejtësisë për të miturit me normat dhe standardet ndërkombëtare. Një kuptueshmëri e thellë për të drejtat e të miturve, aplikimi i duhur dhe aftësia për të komunikuar me të rinj femra dhe meshkuj, identifikon nevojën për të zhvilluar më shumë këto aftësi me profesionistë. Nevojat e vajzave dhe të djemve në kontakt me ligjin, veçanërisht, viktimat ose dëshmitarët në krim, nuk janë trajtuar mjaftueshëm në ligj. Grupet kryesore të interesit në drejtësinë ndaj të miturve, si p.sh., Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, sistemi gjyqësor dhe i prokurorisë do të mbështeten në koordinimin midis tyre dhe menaxhimin e të dhënave, që do të lejojë identifikimin dhe regjistrimin në kohë të rasteve të shkeljeve të ligjit nga të miturit, përmes rrugëtimit të tyre në procesin gjyqësor dhe zhvillimit të politikave të përcaktuara për ta.

Kujdes i veçantë do t'u kushtohet ndryshimeve të kërkuara në kulturën institucionale nga ndëshkuese në një sistem gjyqësor të favorshëm për fëmijët, duke u fokusuar në parandalimin dhe duke përfshirë rehabilitimin dhe riintegrimin e shkelësve të ligjit, me qëllim parandalimin ose ripërsëritjen e rasteve të shkeljes së ligjit. Kujdes i veçantë duhet t'u kushtohet jetimëve të dalë nga institucionet shtetërore rezidenciale.

6. QËNDRUESHMËRIA

Qëndrueshmëria politike

Qëndrueshmëria e ndërhyrjes së pari varet nga qëndrueshmëria politike, financiare dhe faktorët strukturorë. Reforma në drejtësi, e miratuar me amendimin e Kushtetutës, është rezultat i negociatave dhe i marrëveshjeve ndërmjet partive të së majtës dhe të së djathtës. E njëjta marrëveshje nuk u arrit për miratimin e shtatë ligjeve, pjesë e paketës së parë. Mungesa e arritjes së marrëveshjes nga partitë politike për miratimin e ligjeve kyçe në reformën e drejtësisë, tregon mungesën e mbështetjes së plotë politike për zbatimin e saj. Kjo ka pasur ndikim në ngadalësimin e hapave të reformës në sistemin e drejtësisë (siç ka ndodhur me rastin kur Gjykata Kushtetuese ka pezulluar në nëntor 2016 zbatimin e ligjit të vetingut dhe procesin e vetingut nga Partia Demokratike në opozitë. Kjo e ka penguar zbatimin e aktiviteteve të tjera në reformën e drejtësisë, ndërkohë që pritej opinioni i Komisionit të Venecias për ligjin e miratuar më 10 dhjetor. Pezullimi u hoq më 22 dhjetor, pasi Gjykata Kushtetuese ktheu mbrapsht apelin nga Partia Demokratike). Komuniteti ndërkombëtar ka luajtur rol të rëndësishëm në arritjen e marrëveshjeve për miratimin e amendimeve Kushtetuese. Ai duhet të vijojë të kryejë të njëjtin rol, mundësisht gjatë të gjithë fazës së zbatimit të reformës në drejtësi.

Qëndrueshmëria e burimeve njerëzore

Qëndrueshmëria e reformave varet edhe nga ekzistenca e burimeve të kualifikuara njerëzore. Kjo kërkon punësimin e stafit të ri të kualifikuar dhe trajnimin e stafit ekzistues në risitë e reformës së drejtësisë. Procesi i vetingut, i cili po jep rezultatet e para, pritet të kontribuojë në pastrimin e sektorit të drejtësisë nga elementet e korruptuara. Legjislacioni i ri ka prodhuar procedura të reja për rekrutimin e stafit për institucionet e ngritura rishtazi, i cili në letër garanton proces të lirë, transparent, bazuar në merita dhe të pavarur e të pandikuar nga politika.

Për sa i përket trajnimit të stafit ekzistues, reforma në sektorin e drejtësisë parashikon një rritje të aktiviteteve trajnuese, kryesisht të organizuara në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës. Gjithashtu, trajnimi i stafit të Ministrisë së Drejtësisë dhe organizmave të tjerë administrativë do të organizohet në koordinim me Shkollën shqiptare të Administratës Publike.

¹⁸ Rishikimi Universal i Periudhës për Shqipërinë, parashtrimi nga ekipi i vendeve të Kombeve të Bashkuara, shtator 2013.

Mbështetja teknike dhe financiare nga ekspertiza ndërkombëtare është e një rëndësie të veçantë për përgatitjen e suksesshme të aktorëve të sistemit të drejtësisë. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet, për të siguruar pronësinë mbi procesin nga ana e grupeve të interesit, në rastet kur zhvillimi i legjislacionit dhe procedurat e tij mbështeten nga asistencë teknike. Kjo do të arrihet nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve.

STABILITETI FINANCIAR

Strategjia Sektoriale e Drejtësisë është e lidhur me një Plan Veprimi të detajuar, i cili është i kostuar dhe pjesërisht i buxhetuar.

Kostoja e përgjithshme për zbatimin e Planit të Veprimit, për vitet 2017–2021, për reformën në sektorin e drejtësisë është vlerësuar të kushtojë 98.4 milionë euro. Sipas Planit të Veprimit, 58.5 milionë euro duhet të mbulohen nga buxheti i shtetit (5.5 milionë euro të buxhetuara, 41 milionë euro nga fondi rezervë dhe 12 milionë euro për investime kapitale në infrastrukturë për godinat e gjykatave dhe zyrat e prokurorisë). Siç është kërkuar nga Këshilli i Ministrave, financimi i Planit të Veprimit është objekt i dialogut të vazhdueshëm politik për të lehtësuar rishikimin e këtyre kostove, për të racionalizuar, prioritetizuar dhe në kohë të arsyeshme kostoja dhe buxheti duhet të ngushtojnë hendekun financiar, si dhe për të identifikuar burimet e mundshme alternative.

Ekzistojnë një sërë problematikash financiare që rezultojnë nga ndryshimet në legjislacion, sikurse edhe nga strukturat institucionale, të cilat do të çojnë në krijimin e institucioneve të reja dhe riorganizimin e të tjerave. Si pasojë e ngritjes së institucioneve të reja të drejtësisë, reforma në këtë fushë fokusohet, gjithashtu, në përmirësimin e statusit të aktorëve të sistemit të drejtësisë, kryesisht gjykatësve, prokurorëve, duke ngritur rrogat e tyre dhe përfitimet ose garancitë e tyre. Punësimet e reja rrisin rrogat aktuale dhe kostot e mirëmbajtjes për sistemet e reja të TI-së dhe krijojnë nevojë për financime nga buxheti i shtetit.

Gjithashtu, investimet në zyrat/godinat e gjykatave dhe të prokurorisë kanë nevojë të konsiderueshme për planifikim dhe prokurim. E njëjta situatë është edhe për sistemet komplekse të TI-së.

Mbështetja buxhetore që kontribuon në zbatimin e Planit të Veprimit, 2017–2021, mund të jetë e përshtatshme për të mbyllur hendekun buxhetor e të sigurojë fleksibilitet financiar për të zbatuar objektivat e Strategjisë. Duhet pasur parasysh:

- vlerësimi i ndikimit financiar të kursimeve të mundshme që rezultojnë nga reforma; kursime të mundshme mund të rezultojnë nga lufta kundër korrupsionit dhe fitimet eficiente që rezultojnë nga automatizimi. Këto kursime do të jenë efektive, gjithsesi, vetëm pasi të kryhen investimet.

- të planifikohen masa konkrete nga të ardhurat dhe vlerësimin e ndikimit financiar: masat kryesore të të ardhurave mund të konsistojnë në rregullimin e taksave të gjyqësorit – dhe kjo është e përcaktuar në Planin e Veprimit – por ende nuk janë zhvilluar skema konkrete, në përputhje me nivelin e taksave në rajon dhe të kualifikimit për konsensus politik.

7. KOMUNIKIMI DHE VIZIBILITETI

Procesi i reformës në drejtësi ka pasur kujdesin dhe vëmendjen më të madhe që mund të ketë pasur ndonjë proces tjetër në Shqipëri. Kjo vjen si pasojë e angazhimit të madh të partive politike në proces, e kombinuar me përfshirjen e thellë të ekspertizave më të mira ligjore lokale, shoqërisë civile, akademikëve dhe pranisë së ndërkombëtarëve të drejtuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë. I gjithë procesi është mbuluar nga media, e cila ka luajtur rol thelbësor në ndërgjegjësimin e qytetarëve për reformën në drejtësi. Parlamenti ka organizuar disa tryeza konsultimesh me pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile, ekspertëve dhe akademikëve.

Për shkak të rëndësisë politike të sistemit të drejtësisë, si prioritet kyç në hapjen e negociatave, një vizibilitet intensiv për dialogun politik në këtë çështje ka zënë vend të rëndësishëm në kuadrin e Prioritetit kyç dhe të dialogut të nivelit të lartë, i cili, gjithashtu, do të vijojë t'i kushtojë vizibilitet të lartë programit.

Komunikimi i nivelit të lartë dhe vizibiliteti do të ruhen gjatë hartimit dhe zbatimit të programit. Zbatimi i aktiviteteve komunikative për strategjinë e reformës në drejtësi do të jetë përgjegjësi e përfituesit, i cili do të hartojë dhe do të zbatojë një plan komunikimi, gjatë zbatimit të reformës. Përfituesi duhet të publikojë faktin që veprimet kanë marrë mbështetje nga BE-ja.

Veprimet e vizibilitetit dhe të komunikimit do të tregojnë se si ndërhyrja kontribuon në një program të dakordësuar dhe objektivat e tij, si dhe në procesin e anëtarësimit. Veprimet do të synojnë të forcojnë ndërgjegjësimin e publikut të gjerë dhe mbështetjen e ndërhyrjeve dhe objektivat e arritur.

Veprimi do të synojë të evidentojë për audiencën përkatëse, vlerat e shtuara dhe ndikimin e ndërhyrjeve të BE-së, si dhe të promovojë transparencën dhe llogaridhënien në përdorimin e fondeve.

Gjithashtu, delegacioni i BE-së do të parashikojë disa aktivitete komunikative gjatë zbatimit të veprimit. Fushata ndërgjegjësimi të financuara nga BE-ja janë një platformë e përshtatshme për të evidentuar vizibilitetin e BE-së. Këto aktivitete do të ndahen në sekuenca në mënyrë që të maksimizojnë lidhjen midis zbatimit të programit, disbursimit të transheve, zbatimit të politikave dhe të dialogut politik me autoritetet.

Për zbatimin e asistencës plotësuese zbatohen kërkesat e vizibilitetit dhe të komunikimit për aktivitetet jashtë BE-së. Guida vizibiliteti shtesë, të hartuara nga Komisioni do të aplikohen më tej.

Përfituesit do të raportojnë mbi veprimtarinë që lidhet me vizibilitetin dhe me komunikimin gjatë raportimit në Komitetin Monitorues IPA dhe komitetet sektoriale të monitorimit.

8. PARAKUSHTET

Supozimet

Supozohet se autoritetet shqiptare (qeveria shqiptare dhe institucionet e gjyqësorit) do të sigurojnë angazhimin e plotë të tyre për të punuar drejt arritjes së objektivave të programit, si dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e tyre. Ministria e Drejtësisë, si institucioni lider për koordinimin e grupeve të interesit, gjatë zbatimit të Strategjisë, do të ngrejë dhe do të vendosë në funksionim një strukturë për monitorim të rregullt të zbatimit të Strategjisë, si edhe për çdo përditësim të mundshëm.

Supozohet, gjithashtu, se alokimi i fondeve të përshtatshme do të sigurohet në buxhetin vjetor dhe programin afatmesëm buxhetor për zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë dhe, në veçanti, në funksion të funksionimit të institucioneve të reja ligjore, si dhe për Shkollën e Magjistraturës.

LISTA E SHTOJCAVE

1. Përzgjedhja indikative për treguesit e rezultateve (për mbështetjen buxhetore);
2. Treguesit e performancës të përdorur për disbursimet;
3. Marrëveshjet e disbursimeve dhe kalendari i punës.

SHTOJCË 1
PËRZGJEDHJA INDIKATIVE E TREGUESVE TË REZULTATEVE (PËR MBËSHTETJEN BUXHETORE)¹⁹

Kontributet, rezultatet e drejtpërdrejta dhe ato jo të drejtpërdrejta, si dhe të gjithë treguesit, synimet dhe vlerat bazë, që janë përfshirë në listën e treguesve të rezultateve, janë indikativë dhe mund të përditësohen gjatë zbatimit të veprimit, pa bërë ndryshime në vendimin për Marrëveshjen e Financimit. Tabela me listën indikative të treguesve të rezultateve do të shtellohet gjatë kohëzgjatjes së veprimit: do të shtohen kolona të reja për synimet e ndërmjetme, kur të jetë e përshtatshme dhe, për qëllime raportimi të arritjes së rezultateve, sipas matjeve përmes treguesve.

	Ndërhyrja logjike	Treguesit	Baza fillestare	Synimi më 2020-ën	Synimi final 2021 (fundi i Strategjisë)	Burimet, mjetet e verifikimit
Objektivi i përgjithshëm/ndikimi	Të kontribuojë në forcimin e shtetit të së drejtës, zbatimin e ligjit dhe uljen e nivelit të korrupsionit në agjencitë qeveritare dhe gjyqësor	Niveli i progresit i vlerësuar nga KE-ja për kapitullin 23 (Sistemi gjyqësor dhe të drejtat themelore)	Negociatat për kapitullin 23 (Sistemi gjyqësor dhe të drejtat themelore) nuk janë hapur	Negociatat për kapitullin 23 (Sistemi gjyqësor dhe të drejtat themelore) janë hapur dhe kanë progres	Negociatat për kapitullin 23 (Sistemi gjyqësor dhe të drejtat themelore) janë hapur dhe kanë progres	Raporti vjetor i KE-së
		Treguesi i përbërë për reformën në gjyqësor	39.94 në 2013	55.71	55.71	Banka Botërore
		Treguesi për qeverisjen i Bankës Botërore – shteti i së drejtës	42 (2015)	60	60	Treguesit qeveritarë të Bankës Botërore http://info.worldbank.org/governance/wgi/index.aspx#home
		Besimi i publikut në gjyqësor	21% (2017)	50%	50%	Sondazhi i PNUD-it dhe i Bankës Botërore
Objektivat specifike	Të forcohet pavarësia, transparenca, efienca, llogaridhënia dhe besimi i publikut ndaj sistemit gjyqësor shqiptar, në përputhje me standardet evropiane.	Indeksi i performancës juridike	37.9% (2015)	0-25%	0-25%	Raporti i CEPEJ-së
		Treguesi i përbërë (mesatarja e aksesit në sistemin gjyqësor dhe pavarësia e gjyqësorit)	0.5 (2016)	0.6	0.6	Projekti botëror i Drejtësisë, Forumi Ekonomik Botëror
		Numri i çështjeve të mbetura pezull në Gjykatën e Lartë	30000 (në fund të vitit 2018)	Jo më shumë se 29800	Jo më shumë se 29300	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
	Të përmirësohet mbrojtja e të drejtave të njeriut në sistemin e burgjeve	Numri i burgjeve të mbipopulluara në raport me godinat ekzistuese (SKZHI)	24% (2014)	0%	0%	Ministria e Drejtësisë SKZHI
		% e personave që janë gjykuar me gjykime alternative, duke i krahasuar me totalin e gjykimeve (pa dallim	37% (2015)	50%	50%	Ministria e Drejtësisë

¹⁹ Indikatorët në përputhje me dokumentet përkatëse të programit shënohen me “*”.

	Ndërhyrja logjike	Treguesit	Baza fillestare	Synimi më 2020-ën	Synimi final 2021 (fundi i Strategjisë)	Burimet, mjetet e verifikimit
		gjinie dhe moshe)				
Rezultatet e pritshme	Institucionet e sistemit të drejtësisë të jenë të pavarura, eficiente dhe llogaridhënëse (objektivi 1)	Numri i institucioneve të reja, të ngritura në funksion të reformës në drejtësi, janë operacionale	3 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Komisioni i Pavarur i Kualifikimeve dhe Dhoma e Apelit	4 (Inspektorati i Lartë i Drejtësisë)	4	(si për treguesin nr. 1)
		Shkalla e ankesave kundër gjykatësve dhe prokurorëve të përpunuara kundrejt ankesave të regjistruara brenda afatit të përcaktuar me ligj (të ndahen sipas gjinisë)	25% (2015–2016)	80%	80%	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (si për treguesin nr. 2)
		% e procedurave disiplinore të iniciuara kundër gjyqtarëve ose prokurorëve që rezultojnë në sanksione (duke përfshirë marrëveshjet e fajësisë) si pasaportë e treguesve të Strategjisë	23% për gjykatësit ²⁰ / nuk ka bazë fillestare krahasuese për prokurorët ²¹	50%/50%	50%/50%	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
		Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura në performancën vjetore të gjykatësve, si në pasaportën e treguesve të Strategjisë	5 vite çështje të mbetura pezull	2.5 vjet çështje të mbetura pezull	2.5 vite çështje të mbetura pezull	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
	Edukimi për çështjet ligjore dhe trajnimet e konsoliduara (objektivi 2)	Numri i kurrikulave të zbatuara nga Shkolla e Magjistraturës, siç identifikohet nga Vlerësimi mbi Nevojat për Trajnime	24 kurrikula (2015/16)	27 kurrikula	30 kurrikula	Raportet VJETORE të Shkollës së Magjistraturës (si për treguesin nr. 3)
		Numri i kurseve <i>online</i> nga Shkolla e Magjistraturës	0	1	1	Raportet Vjetore të Shkollës së Magjistraturës (si për treguesin nr. 3)
	Transparenca dhe aksesueshmëria në sistemin e drejtësisë e përmirësuar (objektivi nr. 3)	Shkalla e njerëzve që plotësojnë kushtet për të përfutur ndihmë parësore/dytësore ligjore, siç përcaktohet në ligjin e aksesit për ndihmën ligjore (ligji 111/2017 për	93% (2017) ²²	95% për parësoret 75% për dytësoret	95% për parësoret 95% për dytësoret	Raportet e Ministrisë së Drejtësisë me inputet e ardhura nga gjykatat (si për treguesin nr. 7)

²⁰ Kjo bazë fillestare u referohet të dhënave të 2016-ës. Të dhënat e 2017-ës janë statistikisht atipike, për shkak të ndryshimeve domethënëse ligjore dhe tranzicionit institucional.

²¹ Fuqia disiplinore mbi prokurorët do të kalojë nga Zyra e Prokurorit të Këshilli i Lartë i Prokurorisë; më 2017-ën sistemi disiplinor për prokurorët nuk ishte funksional, për shkak të ndryshimeve ligjore, të cilat mund të vijnë edhe më 2018-ën. Për këtë arsye nuk është parashikuar ndonjë synim për prokurorët për vitin 2018.

²² Kjo është bazuar në shërbimet parësore falas për 2017, 828 aplikantë të ligjshëm nga të cilët 771 kanë marrë ndihmë ligjore parësore falas.

	Ndërhyrja logjike	Treguesit	Baza fillestare	Synimi më 2020-ën	Synimi final 2021 (fondi i Strategjisë)	Burimet, mjetet e verifikimit
		garancinë shtetërore për ndihmën ligjore falas, si në pasaportën e treguesve të Strategjisë				
		% e çështjeve për të cilat informacioni bazë gjendet <i>online</i> dhe i përditësuar si në pasaportën e treguesve të Strategjisë ²³	5% (TBC)	50 %	60 %	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
	Efektiviteti i sistemit të drejtësisë penale i përmirësuar (objektivi 4)	% e përdorimit të dënimeve kundrejt atyre jo me dënim, në rastin e vendimeve me dënim	70 (2017)	+ 8 për qind pikë më e lartë krahasuar me të dhënat e 2017-ës	+ 13 për qind pikë më e lartë krahasuar me të dhënat e vitit 2017	<i>Si për treguesin nr. 6</i>
		% e vendimeve penale për shkeljet e dënueshme deri në 5 vjet, të cilat përfshijnë sanksionet alternative ²⁴ , si për pasaportën e Treguesve të Strategjisë	49% ²⁵	70%	70%	Ministria e Drejtësisë/ Zyra e Shërbimit të Provës
	Sistemi elektronik i sistemit të drejtësisë i përmirësuar dhe funksional (objektivi 3)	- Plani afatmesëm për infrastrukturën e gjykatave i përmirësuar, duke përfshirë sigurinë në gjyqe, kostimin dhe buxhetimin, funksional	jo	Po	- Po	- Raporti vjetor nga Ministria e Drejtësisë
		- Lidhja automatike e rasteve përmes funksionimit të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve (çështjeve)	jo	Po	- Po	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
	Funksionimi i Ministrisë së Drejtësisë, i përmirësuar (objektivi 7)	Numri i studimeve, analizave, statistikave që kryhen në fushën e gjyqësorit nga Departamenti i Analizës së Legjislacionit	1	5	5	Ministria e Drejtësisë
	Aksesi në drejtësi i rritur përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të profesionistëve ligjorë dhe	Numri i rasteve të zgjidhura përmes dënimeve alternative	1,200	2,500	2,500	Ministria e Drejtësisë

²³ Kjo përfshin: identifikimin e rasteve (duke përfshirë emrat e partive në shumicën e rasteve), kohën dhe vendin ku do të kryhet seanca, emrin e gjykatësit dhe statusin i procedimeve.

²⁴ Sipas neni 59 të Kodit Penal (Pezullimi i dënimit me burgim dhe zëvendësimi me shërbim prove), neni 59/a CC (qëndrimi në shtëpi) dhe neni 63 CC (Shërbimi për publikun).

²⁵ Të dhënat e vitit 2016 janë më të hershmet në këtë kohë; të dhënat e 2017-ës do të jenë të aksesueshme shumë shpejt.

	Ndërhyrja logjike	Treguesit	Baza fillestare	Synimi më 2020-ën	Synimi final 2021 (fondi i Strategjisë)	Burimet, mjetet e verifikimit
	arbitrazhit (objektivi 8)					
	Masat për riintegrimin dhe rehabilitimin e të burgosurve sipas standardeve evropiane (objektivi 6)	Numri i personave me liri të kufizuar, të përfshirë në aktivitete riintegruese, sipas gjinisë dhe moshës (lista e gjatë e SKZHI-së)	2,600 (2014)	3,250	3,250	Ministria e Drejtësisë
Rezultatet e menjëhershme	Hapësira financiare për të zbatuar objektivat e Strategjisë Sektoriale, të përmirësuar	% e kësteve të disbursuara në kohë dhe në përputhje me shumën e rënë dakord në Kontratën e Reformës Sektoriale (KRS)	0	Të paktën 70% e disbursimeve të KRS janë kompletuar sikurse planifikuar	100 % e disbursimeve të KRS janë përfunduar sipas planit	Raportet e disbursimit të KRS
		Shuma e hendekut financiar	53 milionë EURO	80 % e hendekut financiar është mbyllur	100 % e hendekut financiar është mbyllur	Raportet e zbatimit të Strategjisë së Drejtësisë në buxhetin vjetor
Rezultatet e menjëhershme të KRS-së dhe asistencë plotësuese	Dialog i vazhdueshëm politik me qeverinë e Shqipërisë dhe institucionet e drejtësisë në zbatimin e Strategjisë për reformën në drejtësi	- Numri i dialogëve të lartë politikë dhe tekniko/strategjike në diskutimin dhe rishikimin e zbatimit të strategjisë, duke u fokusuar në këstet e ndryshueshme, faktorët dhe relevancën, besueshmërinë dhe progresin e kënaqshëm në zbatimin e strategjisë	- Takimet vjetore të Nënkomitetit për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë (1) - Takimi i Grupit të Punës së Strategjisë së Drejtësisë me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë - Takime <i>ad hoc</i> (4) (programimi dhe monitorimi)	- 1 - 4 takime vjetore për të konfirmuar progresin thelbësor në prioritetet kyçe për hapjen e negociatave - Takime vjetore (programim dhe monitorim)	- 1 - 4 takime vjetore për të konfirmuar progresin thelbësor në prioritetet kyçe për hapjen e negociatave - 10–20 takime <i>ad hoc</i> vjetore (programim dhe monitorim)	- Raporti vjetor për Shqipërinë - Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit - Raportet e disbursimit të KRS-së
	Përpjekje të vazhdueshme për të forcuar kapacitetet qeverisëse për të zbatuar Strategjinë për reformën e drejtësisë	- Shtirja në të cilën Grupi Ndërinstitucional i Punës për fushën e drejtësisë, i aftë për të zbatuar, për të monitoruar dhe për të raportuar për Strategjinë dhe planin e veprimit	- Struktura e Grupit të Punës për sektorin e drejtësisë është e përcaktuar në Strategjinë e drejtësisë	- 2-3 takime vjetore të Grupit Ndërinstitucional të Punës të koordinuara dhe të organizuara nga Ministria e Drejtësisë - Publikimi i raportit vjetor në zbatimin e Strategjisë - Plani i Veprimit 2017–2020	- 2–3 takime vjetore të Grupit Ndërinstitucional të Punës të koordinuara dhe të organizuara nga Ministria e Drejtësisë - Publikimi i raportit vjetor në zbatimin e Strategjisë	- Raporte monitoruese, dokumente strategjike dhe plane veprimi

	Ndërhyrja logjike	Treguesit	Baza fillestare	Synimi më 2020-ën	Synimi final 2021 (fundi i Strategjisë)	Burimet, mjetet e verifikimit
					- Plani i Veprimit 2017–2020	
	Koordinimi i donatorëve i përmirësuar	- Numri i takimeve që janë koordinuar	- Koordinimi i donatorëve në baza <i>ad hoc</i> dhe në kuadër të koordinimit sektorial	- Takime të rregullta të donatorëve (2–4 çdo vit)	- Takime të rregullta të donatorëve (2–4 çdo vit)	- Matrica e raporteve të koordinimit të donatorëve
	Sistemi i monitorimit dhe i vlerësimit për zbatimin e Strategjisë për reformën në drejtësi, i përmirësuar	- Shkalla në të cilën është përcaktuar një rishikim vjetor - Shkalla në të cilën rekomandimet e sistemit të monitorimit përfshihen gjatë procesit të vendimmarrjes	- Raporti i monitorimit në zbatimin e planit të veprimit, të fokusuar në aktivitetet	- Monitorimi vjetor është realizuar në bazë të vlerësimit të performancës, duke përfshirë progresin për çdo tregues, analizat dhe rekomandimet	- Monitorimi vjetor është realizuar mbi bazat e vlerësimit të performancës, duke përfshirë progresin për çdo tregues, analizat dhe rekomandimet	- Raportet monitoruese
	Kapacitetet për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë për reformën në Drejtësi janë përmirësuar	- Numri i takimeve koordinuese dhe organizimi në mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë janë mundësuar - Numri i stafit teknik të trajnuar në Sekretariatit Teknik të Ministrisë së Drejtësisë (të ndarë sipas gjinisë)	- 0 - 0	- 4 në vit - 5	- 4 në vit 5	Raporti i projektit të Asistencës Teknike
	Monitorim i suksesshëm i zbatimit të mbështetjes buxhetore	- Numri i misionëve të pavarura monitoruese - Numri i raporteve monitoruese të përgatitura - Kërkesat për pagesat cilësore dhe në kohë	- 0 - 0 - N/A	- 2 për vit - vjetore - Kërkesat e pagesave janë përfunduar dhe dorëzuar në përputhje me skedulin indikativ të pagesave	- 2 për vit - 2-vjetore Kërkesat e pagesave janë përfunduar dhe dorëzuar në përputhje me skedulin indikativ të pagesave	Monitorim i pavarur Raportet e misionëve monitoruese Dosja e DBE-së, e cila verifikon kushtet dhe progresin e pagesave
	Vëzhgimi i procesit për rivlerësimin e gjykatësve dhe prokurorëve	- Numri i çështjeve të monitoruara/të vëzhguara	- TBC	- TBC	TBC	Raportet monitoruese
	Perceptimi i qytetarëve dhe ndërgjegjësimi për reformën në drejtësi dhe zbatimin e rritur të Strategjisë (fushata të veçanta në baza moshe dhe grupeve të synuara)	- Niveli i perceptimit dhe ndërgjegjësimin (masat sensitive në bazë të moshës, gjinisë, minoriteteve) - Numri i veprimeve komunikuese vjetore (në bazë gjinie, moshe, minoriteti)	- Nuk ka një Strategji Komunikimi funksionale për Strategjinë	- I përmirësuar - 10 - 10	- I përmirësuar - 10 - 10	Raporti i projektit

	Ndërhyrja logjike	Treguesit	Baza fillestare	Synimi më 2020-ën	Synimi final 2021 (fondi i Strategjisë)	Burimet, mjetet e verifikimit
		– Numri i fushatave ndërgjegjësuese (masat sensitive në bazë moshe, gjinie dhe minoriteti)				
	Niveli i përfshirjes dhe pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve joshitetërorë në planifikimin dhe zbatimin e reformës në drejtësi	– Konsultime të rregullta me shoqërinë civile në zbatimin e reformës	– OSHC-të janë konsultuar gjatë hartimit të Strategjisë – OSHC-të janë të përfshira kryesisht në shpërndarjen e informacionit për negociatat e anëtarësimit	– 2–4 takime konsultative të organizuara me OSHC-në/aktorët joshitetërorë, si, p.sh., përfaqësues të komunitetit të biznesit	– 2–4 takime konsultative të organizuara me OSHC-në/aktorët joshitetërorë, si, p.sh., përfaqësues të komunitetit të biznesit	Regjistrime të takimeve
	Niveli i ndërgjegjësimit për çështjet gjinore dhe ato të grupeve vulnerabël	– Konsultime të rregullta për çështjet gjinore dhe mbrojtja e grupeve vulnerabël gjatë zbatimit të reformës në drejtësi	– Numri i kufizuar i OSHC-ve të konsultuara gjatë hartimit të Strategjisë	– 2 herë konsultime për çështjet gjinore dhe mbrojtjen e grupeve vulnerabël	– 2 herë konsultime për çështjet gjinore dhe mbrojtjen e grupeve vulnerabël	Regjistrimet e takimeve

SHTOJCË 2 TREGUESIT E PERFORMANCËS TË PËRDORUR PËR DISBURSIMET

Treguesi nr. 1: Institucionet e reja të drejtësisë janë ngritur dhe janë funksionale

Programi: Strategjia Ndërsëktoriale e Drejtësisë dhe Plani i saj i Veprimit, 2017–2020

Objekti: Objekti nr. 1: Forcimi i pavarësisë, eficiencës dhe i llogaridhënies së institucioneve të sistemit gjyqësor

Rezultatet e pritshme: Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë janë funksionalë (sipas amendimeve të ligjit nr. 76/2016, të 22 korrikut 2016)

Veprimi: Ngritja formale dhe funksionimi i institucioneve

Departamenti përgjegjës: Ministria e Drejtësisë (MD) është përgjegjëse për fillimin e zbatimit të dispozitave ligjore të KLGJ-së dhe KLP-së, si dhe koordinimin dhe mbledhjen e të dhënave

Përshkrimi i treguesit

Lloji i treguesit: Sasior (rezultati)

Periodiciteti i matjes: Vjetore

Rezultati i fundit i njohur (baza fillestare): 3 (institucionet e ngritura sipas ligjit 76/2016, të 22 korrikut 2016: Komisioni i Pavarur i Kualifikimeve, Dhoma e Apelit, Këshilli i takimeve), 3 nga 19 gjykatësit të emëruar në Gjykatën e Lartë (2018)

Zhvillimi dhe cilësia e treguesit

Metodologjia e mbledhjes së të dhënave: Mbledhje e të dhënave administrative nga secili institucion të dorëzuara në Ministrinë e Drejtësisë për përpilim.

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave: Ministria e Drejtësisë

Metoda e llogaritjes: 2019: Aktet nënligjore dhe rregullat e procedurës të miratuara dhe Manuali i vlerësimit të Gjykatësve/të Prokurorëve është miratuar nga KLGJ-ja dhe KLP-ja. KLGJ-ja e KLP-ja do të japin organigramat, informacionin mbi numrin e stafit të rekrutuar, si edhe informacion për buxhetin përkatës në buxhetin e shtetit

2020: gjykatësit e gjykatës së lartë të caktuar nga KLD-ja nëpërmjet vendimeve të rregullta të Këshillit

2021: Për KLD-në, numri i gjykatësve të vlerësuar nga KLD-ja deri në fund të vitit 2020, pjesëtuar me numrin i gjykatësve që do të vlerësohen nga KLD-ja më 2020-ën, shumëzuar me 100.

Për KLP-në numri i prokurorëve të vlerësuar nga KLP-ja deri në fund të vitit 2020, pjesëtuar me numrin e gjykatësve që do të vlerësohen nga KLP-ja në vitin 2020, shumëzuar me 100.

Mënyrat e interpretimit

Kufizime dhe anshmëri të njohura

Ministria e Drejtësisë do të koordinojë mbledhjen e të dhënave, informacionin dhe raportet përkatëse (por jo të vlerësojë të dhënat dhe informacionin e dhënë), të cilat do të jepen nga institucionet e pavarura. Procesi i vetingut që po vijon mund të ndikojë kohën për ngritjen e institucioneve të reja. Ngritja e institucioneve të reja varet pjesërisht nga procesi i vetingut. Pas përfundimit të vetingut të anëtarëve të këtyre institucioneve, ata duhet të jenë të aftë të prodhojnë rezultatet e para, gjithashtu duke mundur që Këshilli të plotësojë boshllëqet në institucionet kyç të gjyqësorit, si dhe të kenë kapacitet që të përmbushin funksionet e tyre kyçe, më specifikisht vlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët duhet të bëhen në bazë të manualit të ri të miratuar pas ngritjes së Këshillit.

Mënyrat e interpretimit: Institucionet e gjyqësorit janë ngritur dhe funksionojnë, sipas dispozitave të ligjit nr. 76/2016 dhe ligjit nr. 115/2016 për organizimin e qeverisjes së gjyqësorit.

Programi i dokumentacionit:

Data e dorëzimit (synimet): Të dhënat për vitin 2019 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2020): KLD-ja dhe KLP-ja janë ngritur (sipas llogaritjes)

Të dhënat për vitin 2020 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2021): të paktën 16 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë nga 19 në total, janë emëruar nga KLD-ja.

Të dhënat për vitin 2021 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2022): KLD-ja dhe KLP-ja kanë vlerësuar të paktën 90% (75% për pagesat e pjesshme) të numrit të gjykatësve dhe prokurorëve të parashikuar për t'u vlerësuar për Planin e tyre të Vlerësimit. 19 gjykatësit e Gjykatës së Lartë janë caktuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.²⁶

²⁶ Numri i Gjykatësve të Gjykatës së Lartë mund të rritet duke u varur nga finalizimi i hartës së gjyqësorit. Page | 39

Komentet: Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të dorëzojnë Planin e tyre të Vlerësimit për vitin 2020, jo më vonë se data 1 shkurt 2020, përgatitur në pajtim me nenet 71 dhe 81 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Emërimet e numrit maksimal të gjykatësve nga KLD-ja mund të varen nga procesi i vettingut që vijon dhe finalizimi i hartës së gjyqësorit.

Treguesi nr. 2: Përpunimi i ankimeve kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve brenda dispozitave ligjore në fuqi, të përmirësuara.

Programi: Strategjia ndërsektoriale e Drejtësisë dhe Plani i saj i Veprimit, 2017–2020

Objekti: Objekti nr. 1, forcimi i pavarësisë, eficiencës dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit gjyqësor

Rezultatet e pritshme: Inspektorati i Lartë i Drejtësisë është funksional

Veprimi: Ngritja formale dhe funksionimi i institucioneve

Departamenti përgjegjës: Inspektorati i Lartë i Drejtësisë

Përshkrimi i treguesit

Lloji i treguesit: Sasior (rezultat)

Shpeshësia e matjes: Përqindje

Periodiciteti i matjes: Vjetore

Rezultati i fundit i njohur: 23% (2017–2018). 23 hetime disiplinore në total kanë filluar nga KLD-ja në vitin 2018.²⁷

Zhvillimi dhe cilësia e treguesit:

Metodologjia e mbledhjes së të dhënave: Mbledhje e të dhënave administrative (Raporti vjetor i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë)

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave: Inspektorati i Lartë i Drejtësisë

Metoda e llogaritjes: aktet nënligjore në 2019, manualët e inspektimeve, rregullat procedurale, për mekanizmin e ankimeve dhe kutinë postare dhe postën elektronike funksionale, rregullat për mbrojtjen e të dhënave të hartuara në funksion të transparencës dhe aksesit të publikut, linja buxhetore për ILD-në e hartuar, të paktën 10 inspektorë të emëruar, zyrat në dispozicion. Kalendari për inspektimet gjatë 2020-ës i miratuar.

Raporti për 2020/2021 është llogaritur si numri i ankimeve të ardhura dhe përpunuara brenda afateve të përcaktuara me ligj (neni X i ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve) më 2020-ën/më 2021-shin i pjesëtuar me numrin e ankesave të ardhura gjatë 2020-ës deri më 31 nëntor 2010/më 2021-shin deri më 31 nëntor 2021 (raporti vjetor për veprimet e ILD për 2020 përfshin numrin e ankimeve, tipologjinë e tyre pjesëtuar me kategorinë dhe shkallën e dosjeve të përpunuara. Përpunimi i dosjeve përfshin vendimet e arsyetuara të ILD-së për hapjen e rastit hetimor dhe statusin e tij aktual, për të mbyllur çështjen pas verifikimit të parë, ose mbylljen e çështjes.

Mënyrat e interpretimit

Kufizime dhe anshmëri të njohura

Një metodë inspektimi ekziston, pasi Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë kanë kryer inspektime si pjesë e aktiviteteve të tyre kryesore. ILD-ja do të finalizojë metodologjinë dhe do ta zbatojë atë.

Mënyrat e interpretimit: Këto matin funksionimin dhe eficiencën operationale të inspektimeve të ndara nga vlerësimi i cili do të kryhet nga KLD-ja dhe KLP-ja

Programi i dokumentacionit

Data e dorëzimit (synimet): Të dhënat për vitin 2019 (vlerësimi në tremujorin e dytë të vitit 2020): Ngritja e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë

Të dhënat për vitin 2020 (vlerësimi në tremujorin e dytë të vitit 2021): 75% e ankesave të përpunuara

Të dhënat për vitin 2021 (vlerësimi në tremujorin e dytë të vitit 2022): 95% (85% për pagesat e pjesshme) të ankesave të përpunuara

legjislacioni lejon një numër prej 19 vetash i cili është minimumi dhe ka rezultuar i nevojshëm për funksionimin e Gjykatës së Lartë.

²⁷ Duhet të merret parasysh se këto të dhëna përfshijnë informacionin e ardhur nga tri institucione: Ministria e Drejtësisë, KLD-ja dhe Prokurori i Përgjithshëm. Sistemi gjyqësor është në tranzicion që më 2017-ën dhe gjatë kësaj periudhe këto institucione kanë mungesa të burimeve njerëzore të përshtatshme për të arritur afatet përfundimtare, si dhe për të nxjerrë të dhënat për bazën fillestare

Komente: Inspektorati i Lartë i Drejtësisë funksionon në mënyrë të pavarur nga KLD-ja dhe KLP-ja dhe ndan procesin e inspektimeve. ILD-ja kërkon, gjithashtu, më shumë kapacitete dhe buxhet për të ngritur një sistem inspektimi të përmirësuar dhe eficient. Si rezultat llogaridhënia është domethënëse por edhe vendimet janë më transparente ndaj publikut. Gjithashtu, këto matje sigurojnë që sistemi është funksional dhe prodhon rezultatet përtej ngritjes dhe funksionimit të institucioneve.

Treguesi nr. 3: Performanca e Shkollës së Magjistraturës e përmirësuar

Programi: Strategjia ndërsektoriale e Drejtësisë dhe Plani i saj i Veprimet, 2017–2020

Objekti: Objekti nr. 2: Konsolidimi i edukimit ligjor dhe trajnimit ligjor, si dhe specializimi i personelit të magjistraturës dhe gjykatave

Rezultatet e pritshme: Standardet e edukimit për Shkollën e Magjistraturës janë përmirësuar

Veprimi: Zhvillimi i kurrikulës dhe i platformës së trajnimit;

Departamenti përgjegjës: Shkolla e Magjistraturës

Përshkrimi i treguesit:

Lloji i treguesit: Cilësor dhe sasior

Masa e matjes: Vjetore

Periodiciteti i matjes: Vjetore

Rezultati i fundit i njohur (baza fillestare): Numri i kurrikulave në zbatim 24 (2015/2016) Numri i kurseve të platformës *online* në zbatim: 0

Zhvillimi i treguesit:

Metodologjia e mbledhjes së të dhënave: Mbledhje e të dhënave administrative nga Shkolla e Magjistraturës për metodologjinë e miratuar dhe të finalizuar, periudhën e raportimit lidhur me zbatimin e të dhënave statistikore, mbi: numrin e kurrikulës së re, numrin e stafit të ri të rekrutuar; modeli dhe rezultatet e sondazheve; vlerësimi mbi nevojat për kurrikula të reja.

Departamenti përgjegjës për mbledhjen: Shkolla e Magjistraturës

Metoda e llogaritjes për 2019: Metodologjia e përshtatur do të përfshijë mekanizmin e matjes për të siguruar standardin për kurrikulat, staf cilësor dhe standard për punësimin, si dhe cilësinë e trajnimit të vazhdueshëm. Duhet të përfshijë mekanizmin dhe metodologjinë e raportimit, si dhe kriteret për rekrutimin e stafit të ri, duke përfshirë publikimin e vendeve të mbetura bosh, kriteret, kryerjen e një ekzaminimi për rekrutimin bazuar në profilin përkatës, standardet e trajtimit të ankimeve dhe apelin për rekrutimet.

Metodologjia do të përfshijë përgatitjen e sondazhit të përmbushjes së nivelit të kërkesave, për të vijuar me trajnimet për secilin pjesëmarrës, kriteret për trajnerët dhe rekrutimin e tyre si dhe përgatitjen e materialeve *online*. Së fundmi metodologjia duhet të përfshijë vlerësimin e nevojave për kurrikulat e reja, modelet për programet e mësimore dhe do të prezantohen ekstraktet e kurrikulave të reja. 2020: Kurrikula do të hartohet në bazat e vlerësimeve për nevojat që do të drejtohen nga shkolla.

Mënyrat e interpretimit

Kufizime dhe anshmëri të njohura:

Shkolla e Magjistraturës ka mungesa të burimeve njerëzore, si dhe mbështetje të mirëorganizuar nga donatorë, me qëllim që të hartohet një mekanizëm cilësor për vlerësimin e nevojave, i cili do të bëjë të mundur sistematizimin e nevojave për trajnime, një zhvillim të rregullt të kurrikulave (në baza *ad hoc*) dhe do të mundësojë rekrutime të drejta dhe konkurruese për stafin e mësuesisë.

Mënyrat e interpretimit: Shkolla e Magjistraturës duhet të tregojë progres në lidhje me kurrikulën, cilësinë e stafit dhe kapacitetin për të dhënë trajnime të mira. Për më tepër, Shkolla duhet fillimisht të tregojë kapacitetin e saj për të planifikuar, për të koordinuar dhe të zhvillojë në mënyrë strategjike performancën e saj.

Programi i dokumentacionit

Data e dorëzimit (synimet): Të dhënat për vitin 2019 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2020): Metodologjia e përshtatur nga Shkolla e Magjistraturës duke përfshirë të tre komponentët e cilësisë (cilësia e kurrikulës, cilësia e stafit dhe cilësia e trajnimit të vazhdueshëm)

Të dhënat për vitin 2020 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2021): tri kurrikula të reja të miratuara dhe të paktën një platformë kurs *online* për trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Të dhënat për vitin 2021 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2022): të paktën një platformë kurs *online* shtesë është funksionale për trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe shkolla ka realizuar dhe publikuar rezultatet e një sondazhi për trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe

prokurorëve.

Komente: Strategjia për Zhvillim e Shkollës së Magjistraturës duhet të përditësohet dhe kërkohen burime njerëzore të përshtatshme

Treguesi nr. 4: Kapacitetet për edukimin ligjor nga Shkolla e Magjistraturës, të përmirësuara

Programi: Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë dhe Plani i saj i Veprimit, 2017–2020

Objektivi: Objektivi nr. 2: Konsolidimi i edukimit ligjor dhe trajnimit ligjor, si dhe specializimi i personelit të magjistraturës dhe gjykatave.

Rezultatet e pritshme: Standardet e edukimit për Shkollën e Magjistraturës janë përmirësuar

Veprimi: Ngritja e objekteve të përshtatshme për Shkollën e Magjistraturës bazuar në ligjin 115/2016 për organizimin e qeverisë

Departamenti përgjegjës: Shkolla e Magjistraturës

Përshkrimi i treguesit:

Lloji i treguesit: Rezultat

Masa e matjes: Numër

Periodiciteti i matjes: Vjetore

Rezultati i fundit i njohur (baza fillestare): (2018) Numri i klasave: 2; libraria/ambient klasash: 1; zyra e stafit: 3. Kushte të varfra dhe kapacitet të limituara për ambientet e edukimit ligjor në Shkollën e Magjistraturës, VKM nr. 744/5.11.2014, “Mbi alokimin e fondeve dhe miratimin e planit të ndërtimit është në fuqi”. Bazuar në ligjin nr. 115/2016, për organizimin e qeverisë së gjyqësorit, godina për Shkollën e Magjistraturës kërkon të paktën 10 klasa, në bibliotekë, sallë trajnimi/konferencash, zyra për stafin.

Zhvillimi i treguesit:

Metodologjia e mbledhjes së të dhënave: Mbledhje e të dhënave administrative nga Shkolla e Magjistraturës

Departamenti përgjegjës për mbledhjen: Shkolla e Magjistraturës

Metoda e llogaritjes: Për 2019–ën; dokumentet e tenderit janë dorëzuar, zyra të përkohshme për Shkollën e Magjistraturës janë alokuar.

Bazuar në ligjin 115/2016, për organizimin e qeverisë së gjyqësorit, godina për Shkollën e Magjistraturës kërkon të paktën 10 klasa, një librari, dhomë trajnimi/konferencash, zyra për stafin. 2021: Godina është kompletuar me të paktën 10 klasa, një librari, sallë trajnimi/konferencash, zyra për stafin, funksionale dhe e furnizuar me pajisje nga Shkolla e Magjistraturës.

Mënyrat e interpretimit

Kufizime dhe anshmëri të njohura: Këshilli i Ministrave ka miratuar planin parësor për godinat, por që nuk është zbatuar ende, për shkak të mungesës së fondeve. Ndërkohë, projektimi aktual mund të ripërdoret, projekti dhe nevojat e tenderit duhet të shikohen sërish dhe lançimi i tenderit kërkon fonde për t’u alokuar.

Programi i dokumentacionit:

Data e dorëzimit (synimet):

Të dhënat për vitin 2019 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2020): Zgjidhja e përkohshme ose finale për godinat e Shkollës së Magjistraturës me 10 klasa të reja. Në rast se kryhen më shpejt (përkohësisht) do të publikohen tenderi (konstruksioni, rekonstruksioni, blerjet e të tjera) për godinën e Shkollës së Magjistraturës,

Të dhënat për vitin 2020 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2021): raporti vjetor për progresin e konstruksionit, rikonstruksionit, blerjeve ose hapësirave të reja që janë dorëzuar.

Të dhënat për vitin 2021 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2022): Shkolla e Magjistraturës ka marrë në dorëzim zyrat e reja.

Komentet:

Çdo vit synimet janë vlerësuar, po asnjë pagesë nuk do të kryhet deri sa Shkolla e Magjistraturës të marri në dorëzim punimet dhe ambientet e reja.

Shkolla është institucioni kyç për gjykatësit dhe prokurorët e rinj pas procesit të vetingut. Kapacitetet e saj funksionale janë esenciale për të qenë e aftë të ofrojë klasa për mësim. Pas reformës në drejtësi, të paktën 200 veta, staf i gjykatave, duhet të trajnohen nga Shkolla, duke përfshirë avokatët e shtetit.

Një plan fillestar Konstruksioni është miratuar nga Këshilli i Ministrave. Bazuar në planin e

prokurimeve procesi është finalizuar, duke përfshirë studimet e nevojshme dhe vlerësimin e riskut. Pavarësisht kësaj, falë mungesës së fondeve, plani ka mbetur pezull për zbatim. Qeveria ka treguar dëshirë të mirë për të finalizuar procesin. Risku duhet të zgjidhet nga Ministria e Drejtësisë. Gjithashtu, plani fillestar siç u hartua fillimisht, përfshin edhe ndërtimin e Gjykatës së Lartë. Me qëllim prioritizimit të Shkollës së Magjistraturës, ndërtimi i godinës duhet të fillojë me Shkollën në radhë të parë.

Treguesi nr. 5: Eficiencia e veprimtarisë së Gjykatës së Lartë e përmirësuar

Programi: Strategjia ndërsektorale e Drejtësisë dhe Plani i saj i Veprimit, 2017–2020

Objekti: Objekti nr. 3: Përmirësimi i sistemit operacional të gjyqësorit, duke përmirësuar eficiencën, transparencën dhe qasjen me standardet e BE-së

Rezultatet e pritshme: Eficiencia dhe performanca e gjyqeve, e rritur

Veprimi: Raportimi statistikor i përmirësuar dhe performancë e rritur për gjykimet

Departamenti përgjegjës: Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Përshkrimi i treguesve

Lloji i treguesit: Sasior (rezultati)

Njësia matëse: Numër

Periodiciteti i matjes: Vjetore

Rezultati i fundit i njohur (baza fillestare): 30000 raste janë regjistruar si të prapambetura në Gjykatën e Lartë deri në fund të 2018, 3 nga 19 gjyqtarë janë caktuar në Gjykatën e Lartë (2018)

Zhvillimi dhe cilësia e treguesit:

Metoda e mbledhjes së të dhënave: Të dhënat vjetore të raportuara nga Gjykata e Lartë për në KLD.

KLD-ja harton raportin përfundimtar të çështjeve të prapambetura, duke përfshirë një vlerësim të veçantë të çështjeve të Gjykatës së Lartë.

Departamenti përgjegjës për mbledhjen - KLD

Metoda e llogaritjes: Llogaritja e çështjeve të zgjidhura nga drejtësia përkon me numrin e çështjeve të mbetura pezull të grumbulluara dhe që janë në listë për gjykim. Prapambetjet përfshijnë të gjitha çështjet e mbetura pezull, pavarësisht nga koha se kur këto raste janë regjistruar. Për gjykatën e lartë, rastet e prapambetura janë akumuluar që nga viti 2014.

Programi i dokumentacionit

Data e dorëzimit (synimet): Të dhënat për vitin 2019 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2020): Të paktën 6 nga 19 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë janë emëruar nga KLD-ja;

Të dhënat për vitin 2020 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2021): Të paktën 200 çështje më pak – 150 në rastin e pagesës së pjesshme - krahasuar me vitin 2019

Të dhënat për vitin 2021 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2022): të paktën 500 çështje më pak – 300 për rastin e pagesës së pjesshme – krahasuar me vitin 2020

Komente: Rastet e prapambetura për Gjykatën e Lartë do të varen nga emërimet e reja në gjykatë nga KLD. Aktualisht janë emëruar 3 gjykatës, nga 19 në total.

Numri i gjykatësve në gjyqe do të influencojë direkt uljen e rasteve të prapambetura. Pra, treguesi 5 dhe treguesi 1 janë të ndërlidhur.

Të dhënat për numrin e çështjeve të prapambetura në fund të vitit 2019 do të dërgohen në DBE brenda muajit mars 2020.

Treguesi nr. 6: Përdorimi i dënimeve alternative i përmirësuar

Programi: Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë dhe Plani i saj i Veprimit, 2017–2020

Objekti: Objekti nr. 6 i Strategjisë: përmirësimi i sistemit të dënimit dhe përmirësimi i të drejtave të njeriut në sistemin e gjyqësorit

Rezultatet e pritshme: Rritja e numrit të personave që procedohen me dënime alternative.

Veprimi: Rritja e ndërgjegjësimit, trajnimet për rregullat e procedurës në procedurat e dënimeve për të përmirësuar aplikimin e dënimeve alternative.

Departamenti përgjegjës: KLD dhe KLP

Përshkrimi i treguesit:

Lloji i treguesit: Sasior (rezultat)

Masa e matjes: Vjetore

Periodiciteti i matjes: Vjetore

Rezultati i fundit i njohur (baza fillestare): 70% për vitin 2017 në bazat e të dhënave të mëposhtme: 6046 për të cilat janë dhënë dënime alternative, jo me burg, pjesëtuar me 8630 raste dënimi për më pak

se pesë vjet burgim, përmes së cilës mund të aplikohen dënime alternative.

Zhvillimi i treguesit:

Metodologjia e mbledhjes së të dhënave: Të dhënat vjetore të nxjerra nga institucionet e burgjeve të dërguara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës

Departamenti përgjegjës për mbledhjen: KLD-ja dhe KLP-ja

Metoda e llogaritjes: Ministria e Drejtësisë, në bazat e informacioneve të ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës do të sigurojë numrin total të dënimeve të shërbimeve të provës ose dënimeve alternative në baza vjetore.

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës prodhon raportin e statistikave përfundimtare për vitet 2019, 2020, 2021, duke llogaritur mesataren e shkallës bazuar në të dhënat e dërguara nga çdo zyrë e Drejtorisë së Shërbimit të Provës dhe e krahason me të dhënat e viteve të mëparshme. Veprat penale mund të dallohen dhe ndahen midis akteve kriminale dhe atyre të shkeljeve administrative (2 ose më pak se dy vjet burgim)

Mënyrat e interpretimit

Kufizime dhe anshmëri të njohura: N/A

Mënyrat e interpretimit:

Programi i dokumentacionit:

Data e dorëzimit (synimet): Të dhënat për vitin 2019 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2020): tre për qind rritje për vitin 2019, në krahasim me të dhënat e vitit 2017;

Të dhënat për vitin 2020 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2021): pesë për qind rritje për vitin 2020, në krahasim me të dhënat e vitit 2019;

Të dhënat për vitin 2021 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2020): pesë për qind rritje për vitin 2021, në krahasim me të dhënat e vitit 2020;

Komente: Sistemi i drejtësisë kriminale në Shqipëri është trashëgimi e sistemit komunist, ku burgimi dhe ndëshkimi luante rol të rëndësishëm në ndëshkimin e veprave penale. Modelet e aplikuara dhe të bazuara në standardet e BE-së synojnë rehabilitimi kundrejt dënimit. Shërbimi i provës konsiderohet ende i ri për Shqipërinë, megjithëse ligji i fundit është miratuar në vitin 2012.

Sistemi ende nuk është aplikuar tërësisht dhe në mënyrë që të marrim efektet e sistemit të burgjeve por në të njëjtën kohë të sigurojmë se sistemi i dënimeve ndjek parimet më të avancuara, masat e funksionimit të shërbimeve të provës janë ato më të përshtatshme dhe më eficiente. Nga ana tjetër, përdorimi i dënimeve alternative aplikohet, gjithashtu, shumë rrallë. Si pasojë, burgjet janë të mbipopulluara. Në vend që të synohen masat për popullimin e burgjeve, ky tregues synon përmirësimin e sistemit si i tillë dhe funksionimin e tij kundrejt statistikave të popullimit të cilat mund të ulen artificialisht falë ngritjes së godinave të reja të burgjeve.

Treguesi nr. 7: Ndihma ligjore është pa pagesë dhe funksionale

Programi: Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë dhe Plani i saj i Veprimit, 2017–2020

Objekti: Objekti 7: Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve që lidhen me të

Rezultatet e pritshme: Akses në drejtësi i përmirësuar

Veprimi: Zbatimi i shërbimeve pa pagesë dhe të decentralizuara të ndihmës ligjore

Departamenti përgjegjës: Ministria e Drejtësisë

Përshkrimi i treguesit:

Lloji i treguesit: Sasior (rezultat)

Masa e matjes: Përqindje

Periodiciteti i matjes: Vjetore

Rezultati i fundit i njohur (baza fillestare): 93 % mbi bazat e vitit 2017 për shërbimin ligjor falas. Nga 828 aplikime të ligjshme (që përmbushin kriteret), 771 kanë marrë ndihmë ligjore fillestare falas. Ndihma dytësore nuk është përfshirë në 2017.²⁸

Zhvillimi dhe cilësia e treguesit

Metodologjia e mbledhjes së të dhënave:

²⁸ Sipas të dhënave të dhëna nga Komisioneri Shtetëror për Ndihmën Ligjore Falas, nga 828 kërkesat për ndihmë ligjore janë miratuar 771 gjatë viti 2017. Të dhënat për 2018 do të dërgohen pranë DBE-së brenda 15 prillit të vitit 2019.

Ministria e Drejtësisë raporton në baza vjetore mbi përdorimin e ndihmës parësore dhe dytësore, të dhënat mbi ndihmën ligjore parësore mbledhet në nivel ministrie, ndërsa të dhënat e dytësore duhet të jepen nga çdo gjykatë dhe mbledhen e jepen nga Ministria e Drejtësisë.

Departamenti përgjegjës për mbledhjen: Ministria e Drejtësisë

Metoda e llogaritjes: Për secilin vit do të aplikohen llogaritjet e mëposhtme:

Raporti vjetor i ndihmës ligjore parësore: numri i personave që kanë plotësuar kriteret dhe kanë marrë ndihmë ligjore parësore (këshilla ligjore) gjatë një viti të caktuar, pjesëtuar me numrin e personave që plotësojnë kriteret për ndihmë ligjore parësore falas (këshilla ligjore), shumëzuar me 100.

Raporti vjetor i ndihmës ligjore dytësore: numri i personave që kanë plotësuar kriteret dhe kanë marrë ndihmë ligjore dytësore (paraqitja në gjyqe) gjatë një viti të caktuar, pjesëtuar me numrin e personave që plotësojnë kriteret për ndihmë ligjore dytësore (kërkesat e pranuar nga gjykata) shumëzuar me 100.

Mënyrat e interpretimit

Kufizime dhe anshmëri të njohura:

Skema e re për ndihmën ligjore falas hyri në fuqi më 1 qershor 2018. Kompetencat e dhënies së ndihmës janë të ndara ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë në nivel qendror dhe të gjykatës në nivel rrethi. Ndihma parësore ligjore përfshin këshilla ligjore, të dhëna nga Ministria e Drejtësisë ndërkohë që përfaqësimi ligjor konsiderohet si ndihmë dytësore nga ana e nivelit gjyqësor. Secila Gjykatë është përgjegjëse për ndërgjegjësim dhe mbështetje. Megjithatë, që kur për gjykatat ky fakt është konsideruar si proces i ri, trajnimi dhe mbështetja e vazhdueshme do të jetë domosdoshmëri në fazën e parë. Ministria e Drejtësisë duhet të jetë në një pozicion më të favorshëm për të mbledhur të dhënat, me kusht që zyra e tyre e statistikave të përgatisin një metodologji eficiente për të marrë këto të dhëna nga gjykatat e secilit rreth.

Mënyrat e interpretimit

Programi i dokumentacionit

Data e dorëzimit (synimet): Të dhënat për vitin 2019 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2020): 95% për parësorin dhe 40% për dytësorin

Të dhënat për vitin 2020 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2021): 95% për parësorin dhe 75% për dytësorin

Të dhënat për vitin 2021 (vlerësimi në tremujorin e dytë të 2022): 95% për parësorin dhe 95% për dytësorin

Komente: Ministrisë së Drejtësisë i kërkohet të japë një metodë llogaritëse për të dhënat parësore dhe dytësore. Baza fillestare llogaritet në bazën e ligjit të vjetër, duke marrë në konsideratë vetëm shërbimet e ndihmës ligjore parësore.

SHTOJCË 3 MARRËVESHJET DHE AFATET PËR DISBURSIMET

Kjo shtojcë mbulon katër fushat kryesore si më poshtë, në përputhje me kontekstin e vendit/ sektorit të ndërhyrjes: 1. përgjegjësitë; 2. afatet indikative për disbursimet; 3. kushtet e përgjithshme për disbursimin e çdo kësti; 4. kushtet e veçanta për disbursimin e çdo kësti.

1. Përgjegjësitë

Bazuar në kushtet e disbursimit të përcaktuara në këtë Marrëveshje Financimi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do t'i dërgojë Komisionit Evropian një kërkesë zyrtare për disbursimin e çdo kësti, në përputhje me afatet e specifikuar në tabelën A, si më poshtë. Kërkesa duhet të përfshijë: i) një analizë dhe arsyetim të plotë për pagesën e fondeve me dokumentet e kërkuara mbështetëse bashkëlidhur; ii) një formular informacioni financiar, të nënshkruar sipas rregullave, për të lehtësuar pagesën përkatëse.

2. Afatet indikative të disbursimit

Tabela A: Afatet indikative të disbursimit

Viti fiskal i vendit	Viti 1				Viti 2				Viti 3				Viti 4				Totali
	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	
Këst fiks		7				2				2				2			13
Këst i ndryshueshëm						6*				6*				9*			21
Totali		7				8				8				11			34

* Për treguesin 4 çdo vit është i vlerësuar, por asnjë pagesë nuk do të kryhet derisa të arrihet dhe të konfirmohet synimi i fundit.

Kushtet e përgjithshme për disbursimin e secilit këst

[Kushtet e përgjithshme të renditura më poshtë për disbursimin e secilit këst/ transh zbatohen për disbursimin e të gjitha kësteve dhe të gjitha kërkesat për pagesë kësti duhet të shoqërohen me informacionin dhe dokumentet e përshtatshme.]

Tabela B: Kushte të përgjithshme për livrimin e kësteve

Fusha	Kushtet	Burimi i verifikimit
Politika publike	Progres i kënaqshëm në zbatimin e Strategjisë për Drejtësinë dhe vijimësia e besueshmërisë dhe relevancës së saj apo ndonjë strategjie pasuese	Raportet për progresin e Strategjisë për Drejtësinë dhe për zbatimin e Planit të Veprimit (çdo vit, çdo muaj prill) Raporti për mbështetjen plotësuese nën këtë masë (çdo vit, T2 N+1)
Stabiliteti makroekonomik	Zbatimi i një politike makroekonomike të besueshme dhe të orientuar drejt stabilitetit	Raportet vjetore të qeverisë së Shqipërisë (çdo prill, N+1) raportet nga FMN-ja, Banka Botërore, BE-ja (vjetore ose të posaçme) Vlerësimi nga DG ECFIN i Programit të Reformave Ekonomike (PRE) (vjetor) Përfundimet e Nënkomitetit të MSA-së për Ekonominë dhe Çështjet Financiare (vjetore)

Menaxhimi financiar publik	Progres i kënaqshëm në zbatimin e programit për të përmirësuar menaxhimin e financave publike	Raportet e progresit për zbatimin e Strategjisë për të përmirësuar MFP-në (raportet vjetore të zbatimit të Strategjisë MFP që i paraqiten Komitetit Drejtues MFP) Raportet përkatëse nga FMN-ja, Banka Botërore, BE-ja (vjetore ose të posaçme) Vlerësime nga DG NEAR me kontributet nga drejtoritë e tjera (DG BUDGET, DG MARKT, DG TAXUD) (vjetore dhe të posaçme)
Transparenca e buxhetit	Progresi i kënaqshëm në lidhje me disponibilitetin për publikun të informacionit të qëndrueshëm buxhetor që është i aksesueshëm, tërësor dhe jepet në kohë	Botimet dhe faqet zyrtare përkatëse të qeverisë (proces i vazhdueshëm) Raporti vjetor i MFE-së për progresin e zbatimit të programit të transparencës Vlerësime nga palë të treta, p.sh., Indeksi i Buxhetit të Hapur (vjetore).

4. Kushtet specifike për disbursimin e kësteve

[Kushtet specifike për disbursimin të renditura në tabelën C dhe D zbatohen për disbursimin e kësteve specifike të parashikuara në shtojcën 2. Kërkesat për aktivizimin e kësteve duhet të shoqërohen me informacionin dhe dokumentacionin e përshtatshëm për kushtet specifike.]

Tabela C: Kushtet specifike për aktivizimin e kësteve

Kësti	Shuma	Data indikative e kërkesës për disbursim (muaji/viti)	Data indikative e disbursimit (muaji/viti)	Kushtet/kriteret/aktivitetet për disbursim	Burimi i verifikimit, përfshirë kohën dhe praninë e të dhënave (sipas rastit)
Kësti i parë fiks	7 milionë €	T2 2019	T3 2019	Progresi i Strategjisë për Drejtësinë dhe i zbatimit të Planit të veprimit (çdo vit, çdo prill); Plani i veprimit i përditësuar për periudhën në vijim, duke përfshirë informacion në lidhje me buxhetin kombëtar vjetor dhe afatmesëm dedikuar zbatimit të Strategjisë	Raportet për progresin e Strategjisë në Drejtësi dhe për zbatimin e planit të veprimit (çdo vit, çdo prill).
Kësti i dytë fiks	2 milionë €	T2 2020	T3 2020	Disbursimi mbi bazën e kriterëve të përgjithshme. Përmeshja e parakushteve të përgjithshme të pranueshmërisë para pagesës	Raportet për progresin e Strategjisë në Drejtësi dhe për zbatimin e planit të veprimit (çdo vit, çdo prill).
Kësti i parë i	6 milionë €	T2 2020	T3 2020	Këstet e ndryshueshme, siç përcaktohen	Kushtet e hollësishme për kështun e

ndryshueshëm				në shtojcën 2, mbi modalitetet e disbursimit dhe afatin për treguesit 1, 2, 3, 5, 6, 7 Për treguesin 4, objektivat vlerësohen, por nuk bëhet asnjë pagesë derisa të arrihet objektivi i 2021	ndryshueshëm jepen në shtojcën 2 dhe tabelën D.
Kësti i tretë i ndryshueshëm	2 milionë €	T2 2021	T3 2021	Disbursimi mbi bazën e kritereve të përgjithshme Përbushja e parakushteve të përgjithshme të pranueshmërisë para pagesës	Raportet për progresin e Strategjisë në Drejtësi dhe për zbatimin e Planit të Veprimit (çdo vit, çdo muaj prill). Raporti nga mbështetja plotësuese nën këtë masë (vjetor, T2 N+1)
Kësti i dytë i ndryshueshëm	6 milionë €	T2 2021	T3 2021	Këstet e ndryshueshme, siç përcaktohen në shtojcën 2, mbi modalitetet e disbursimit dhe afatin për treguesit 1, 2, 3, 5, 6, 7 Për treguesin 4, objektivat vlerësohen, por nuk bëhet asnjë pagesë derisa të arrihet objektivi i 2021	Burimet e verifikimit për kushtet specifike (nëse ka)
Kësti i katërt i ndryshueshëm	2 milionë €	T2 2022	T3 2022	Disbursimi mbi bazën e kritereve të përgjithshme Përbushja e parakushteve të përgjithshme të pranueshmërisë para pagesës	Raportet për progresin e Strategjisë në Drejtësi dhe për zbatimin e planit të veprimit (çdo vit, çdo muaj prill)
Kësti i tretë i ndryshueshëm	9 milionë €	T2 2022	T3 2022	Kushtet specifike për disbursimin që mund të përdoren për këstet e ndryshueshme, siç përcaktohen në shtojcën 2, mbi modalitetet e disbursimit dhe afatin për treguesit 1, 2, 3, 5, 6, 7 Për treguesin 4, pagesa e të tri kësteve (2019, 2020, 2021) bëhet nëse përbushet objektivi përfundimtar	Kushtet e hollësishme për këstin e ndryshueshëm jepen në shtojcën 2 dhe tabelën D.

Kushtet e disbursimit për këstet e ndryshueshme janë përcaktuar për vitin e parë dhe mund të ndryshohen.

5. Llogaritja e kësteve të ndryshueshme

- Specifikimi i metodës që ndiqet për vlerësimin e secilit tregues

Një mundësi është vlerësimi i secilit tregues me 0, 0.5 ose 1, në varësi të faktit, nëse: i. nuk është përmbushur (0); ii. synimi i pjesshëm është përmbushur (0.5); ose iii. synimi është përmbushur (1). Disbursimi për arritjen e secilit tregues të caktuar në shtojcën 2 llogaritet me shumën 1 milion euro, është vlerësuar se është arritur dhe 0.5 në rast se është i arritur pjesërisht, aty ku është e zbatueshme. Në rastet kur ekzistojnë dyshime thelbësore për cilësinë e të dhënave, një ushtrim verifikues duhet të kryhet me qëllim marrjen e vendimit për pagesat. Në këto raste, mund të rekrutohet një ekspert i jashtëm për të verifikuar të dhënat bazuar në një model, duke verifikuar të dhënat drejtpërsëdrejti kur është e mundur ose përmes krahasimit të të dhënave me aktorë të tjerë zakonisht joqeveritarë.

- Specifikimi i natyrës së bazës fillestare

Në shumicën e rasteve, baza fillestare duhet të shtrihet me të dhënat e çdo viti pasardhës. Kjo nënkupton se rezultatet e arritura me efektivitet në vitin e parë për programin merren si baza fillestare mbi të cilat vlerësohet performanca e vitit të dytë.

- Specifikimi i metodës për vlerësimet, me qëllim përcaktimin e disbursimit të kësteve të ndryshueshme

Në raste të jashtëzakonshme, kur ngjarje të jashtëzakonshme ose rrethana ndryshuese kanë penguar arritjen e synimeve të rena dakord, mund të jetë e mundur të anashkalohet ose zerohet një kusht i treguesve. Në këtë rast, vlera përkatëse ose mund të transferohet në këstin tjetër ose mund të rishpërndahet në treguesit e tjerë të të njëjtit këst. Në këto raste duhet të kërkohet nga Ministria e Drejtësisë përmes KKIPA-së drejt drejtorit gjeografik të DG NEAR të Komisionit Evropian dhe mund të autorizohet nga ky i fundit nëpërmjet shkëmbimit të letrave ndërmjet drejtorit të DG NEAR të Komisioni Evropian dhe KKIPA-së.

Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara shterueshëm, Marrëveshjet e Financimit mund të lejojnë një rivlerësim të disa synimeve të paarritura gjatë vitit në vijim kundrejt synimit fillestar, nëse vërehet një prirje pozitive dhe nëse qeveria nuk e ka arritur synimin, si rrjedhojë e rasteve të shokut të jashtëm. Këto raste duhet të specifikohen në dokumentacionin e treguesit.

Tabela D: Këstet e ndryshueshme – Informacion i hollësishëm në shtojcën 2

Kontrate e reformës sektoriale për mbështetjen e reformës në drejtësi			
Kësti i parë i ndryshueshëm Arritja: nga fundi i vitit 2019 Vlerësimi: në T2 2020	Kësti i dytë i ndryshueshëm Arritja: nga fundi i vitit 2020 Vlerësimi: në T2 2020	Kësti i tretë i ndryshueshëm Arritja: nga fundi i vitit 2021 Vlerësimi: në T2 2020	Pesha
1. Treguesi: Institucionet e reja gjyqësore janë ngritur dhe funksionojnë			
Synimi: Krijohen Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë	Synimi: Të paktën katër gjyqtarë të Gjykatës së Lartë emërohen prej Këshillit të Lartë Gjyqësor	Synimi: Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë kanë vlerësuar bashkë të paktën 90% të numrit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve përkatësisht të parashikuar që të vlerësohen sipas Planit të Vlerësimit për vitin 2020. KLGJ-ja dhe KLP-ja dorëzojnë Planin e Vlerësimit për 2020-ën deri më 1 shkurt 2020, përgatitur në përputhje me nenet 71–81, të ligjit 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”	1/7 (1 m euro) E pjesshme 1/14 (0.5 m euro)
Baza fillestare 3 (institucionet e ngritura sipas ligjit 76/2016, datë 22.7.2016: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Apelit, si dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi)			
Burimi i verifikimit: Shtojcë 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursimet			
Realizim i pjesshëm (nëse ka)	Realizim i pjesshëm (nëse ka)	Realizim i pjesshëm: KLGJ dhe KLP kanë vlerësuar bashkë të paktën 75% të numrit të gjyqtarëve dhe të	

Kontrate e reformës sektoriale për mbështetjen e reformës në drejtësi

Kësti i parë i ndryshueshëm Arritja: nga fundi i vitit 2019 Vlerësimi: në T2 2020	Kësti i dytë i ndryshueshëm Arritja: nga fundi i vitit 2020 Vlerësimi: në T2 2020	Kësti i tretë i ndryshueshëm Arritja: nga fundi i vitit 2021 Vlerësimi: në T2 2020	Pesha
		prokurorëve, përkatësisht të parashikuar që të vlerësohen sipas planit të vlerësimit për 2020`-ën. KLGJ-ja dhe KLP-ja dorëzojnë planin e vlerësimit për 2020-ën deri më 1 shkurt 2020, përgatitur në përputhje me nenet 71–81, të ligjit 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”	
2. Treguesi: Shqyrtimi i ankesave ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve brenda dispozitave ligjore të miratuara është forcuar			
Synimi: Krijimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	Synimi: 75% e ankesave të shqyrtuara	Synimi: 95% e ankesave të shqyrtuara	1/7 (1 m euro)
Baza fillestare: 25% (2015–2016)			
Burimi i verifikimit: Shtojcë 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursimet			
Realizim i pjesshëm: E pazbatueshme	Realizim i pjesshëm: E pazbatueshme	Realizim i pjesshëm: 85% e ankesave të shqyrtuara	
3. Treguesi: Përmirësim cilësor i performancës së Shkollës të Magjistraturës			
Synimi: Metodologjia e miratuar nga Shkolla e Magjistraturës, duke përfshirë të tre komponentët cilësorë (cilësia e kurrikulave, cilësia e personelit dhe cilësia e trajnimit të vazhdueshëm)	Synimi: Tri kurrikula të reja miratohen dhe të paktën një platformë kursi <i>online</i> është funksionale për trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve	Synimi: Të paktën një platformë kursesh <i>online</i> shtesë për trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe shkolla ka realizuar dhe ka publikuar rezultatet e një ankete për nivelin e përmbushjes së kërkesave për trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve	1/7
Baza fillestare: Numri i kurrikulave të miratuara 24 (2015/2016); Numri i platformave të kurseve <i>online</i> të miratuara: 0			
Burimi i verifikimit: Shtojcë 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursimet			
Realizim i pjesshëm: E pazbatueshme	Realizim i pjesshëm: E pazbatueshme	Realizim i pjesshëm: E pazbatueshme	
4. Treguesi: Kapacitete të përmirësuara për edukimin ligjor nga Shkolla e Magjistraturës			
Synimi: Gjendet zgjidhje e përhershme ose e përkohshme për ambiente për Shkollën e Magjistraturës, me 10 klasa. Në rastin e së parës (të përkohshme), shpallet tenderi (ndërtimi, rindërtimi, blerjet, blerjet etj.) për mjediset e Shkollës së Magjistraturës	Synimi: Dorëzohet raport vjetor i progresit për ndërtimin, rindërtimin, blerjet apo të tjera	Synimi: Shkolla e Magjistraturës i merr në dorëzim ambientet e veta	1/7
Baza fillestare: (2017) Numri i klasave: 2; bibliotekë/klasë: 1; zyra personeli: 3. Kushte të këqija dhe kapacitete të kufizuara për ofrimin e edukimit ligjor nga Shkolla e Magjistraturës; vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 744, datë 5.11.2014, për alokimin e fondeve dhe miratimin e planit të ndërtimit zbatohet. Bazuar në ligjin 115/2016, për organizimin e organeve qeverisëse të gjyqësorit, godina e Shkollës së Magjistraturës kërkon që të paktën 10 klasa, një bibliotekë, një sallë konferencash/ trajnimesh, zyra për personelin të bëhen funksionale dhe të përdoren nga Shkolla e Magjistraturës			
Çdo vit synimet vlerësohen, por nuk bëhet asnjë pagesë derisa Shkolla e Magjistraturës të marrë në dorëzim mjediset përfundimisht			
Burimi i verifikimit: Shtojcë 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursimet			

Kontrate e reformës sektoriale për mbështetjen e reformës në drejtësi			
Kësti i parë i ndryshueshëm Arritja: nga fundi i vitit 2019 Vlerësimi: në T2 2020	Kësti i dytë i ndryshueshëm Arritja: nga fundi i vitit 2020 Vlerësimi: në T2 2020	Kësti i tretë i ndryshueshëm Arritja: nga fundi i vitit 2021 Vlerësimi: në T2 2020	Pesha
<u>Realizim i pjesshëm</u> : NA	<u>Realizim i pjesshëm</u> : NA	<u>Realizim i pjesshëm</u> : NA	
5 – Treguesi 5: Gjykata e Lartë funksionon më me efikasitet			
Synimi: Të paktën 6 nga 19 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor	Synimi: Të paktën 200 çështje më pak, krahasuar me numrin e çështjeve më 31 dhjetor 2019	Synimi: Të paktën 500 çështje më pak, krahasuar me numrin e çështjeve më 31 dhjetor 2020	1/7 (1 m euro)
<u>Baza fillestare</u> : Çështjet e mbetura pezull (të pazgjidhura) në Gjykatën e Lartë janë 30 000 (fundi i vitit 2018)			E pjesshme 1/14 (0.5 m euro)
<u>Burimi i verifikimit</u> : Shtojcë 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursimet			
<u>Realizim i pjesshëm</u> : E pazbatueshme	<u>Realizim i pjesshëm</u> : Të paktën 150 çështje më pak, krahasuar me numrin e çështjeve më 31 dhjetor 2019	<u>Realizim i pjesshëm</u> : Të paktën 300 çështje më pak, krahasuar me numrin e çështjeve më 31 dhjetor 2020	
6 – Treguesi: Rritje e përdorimit të dënimeve alternative ndaj burgosjes			
Synimi: 3% rritje për vitin 2019 krahasuar me të dhënat për vitin 2017	Synimi: 5% rritje për vitin 2020 krahasuar me të dhënat për vitin 2019	Synimi: 5% rritje për vitin 2019 krahasuar me të dhënat për vitin 2020	1/7 (1 m euro)
<u>Baza fillestare</u> : 70% për vitin 2017 mbi bazën e këtyre të dhënave: 6 046 raste ku mund të jepen dënime alternative ndaj burgosjes pjesëtuar me 8 630 dënime me më pak se 5 vjet burg			
<u>Burimi i verifikimit</u> : Shtojcë 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursimet			
<u>Realizim i pjesshëm</u> : NA	<u>Realizim i pjesshëm</u> : NA	<u>Realizim i pjesshëm</u> : NA	
7 – Treguesi: Shërbimet e ndihmës ligjore falas janë funksionale			
Synimi: 95% për shkallën e parë dhe 40% për të dytën	Synimi: 95% për shkallën e parë dhe 75% për të dytën	Synimi: 95% për shkallën e parë dhe 90% për të dytën	1/7 (1 m euro)
<u>Baza fillestare</u> : 93% për 2017; nga 828 kërkesa të administruara, 771 morën ndihmë juridike falas			
<u>Burimi i verifikimit</u> : Shtojcë 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursimet			
<u>Realizim i pjesshëm</u> : E pazbatueshme	<u>Realizim i pjesshëm</u> : E pazbatueshme	<u>Realizim i pjesshëm</u> : E pazbatueshme	

SHTOJCË 3
AKTIVITETET PLOTËSUESE: NDARJA DHE PLANIFIKIMI INDIKATIV BUXHETOR PËR PROCEDURAT E KONTRAKTIMIT

MËNYRA E ZBATIMIT	BUXHETI (€)		KALENDARI ²⁹	
	Totali	Kontributi i BE-së	Shpallja e procedurave	Nënshkrimi i kontratës ³⁰
PROKURIMI				
Tri ose më shumë kontrata shërbimesh, indikative	8,000,000	8,000,000	T1 2019	T3 2019
TOTALI	8,000,000	8,000,000		

²⁹ Afati kohor: Tremujor (T1, T2, T3, T4), vjetor.

³⁰ Data e nënshkrimit të kontratës: nëse është e zbatueshme, d.m.th, kryesisht për grantet direkte.

SHTOJCË II
KUSHTET E PËRGJITHSHME

PËRMBAJTJA

SHTOJCË II
KUSHTET E PËRGJITHSHME

Pjesa e parë: Dispozitat e zbatueshme të aktiviteteve për të cilat përfituesi IPA II është Autoriteti kontraktues

Neni 1 – Parime të përgjithshme

Neni 1a – Detyrimi për të informuar, sanksionet administrative dhe mosveprimi

Neni 2 – Vizibiliteti dhe komunikimi

Neni 3 – Kontrollat *ex-ante* për procedurat e granteve dhe prokurimit dhe kontrollat *ex-post* për kontratat dhe grantet që do të kryhen nga Komisioni

Neni 4 – Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe shpenzimet e pranuar

Neni 5 – Dispozitat mbi pagesat e kryera nga Komisioni për përfituesin IPA II

Neni 6 – Ndërprerja e pagesave

Neni 7 – Rikuperimi i fondeve

Pjesa e dytë. Dispozitat e zbatueshme për mbështetjen buxhetore

Neni 8 – Dialogu mbi politikat

Neni 9 – Verifikimi i kushteve dhe disbursimit

Neni 10 – Transparenca e mbështetjes buxhetore

Neni 11 – Rikuperimi i mbështetjes buxhetore

Pjesa e tretë. Dispozitat e zbatueshme për marrëveshjen përkatëse të financimit, pavarësisht nga metoda e menaxhimit

Neni 12 – Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues

Neni 13 – Lejet dhe autorizimi

Neni 14 – Kërkesat e raportimit

Neni 15 – Të drejtat e pronësisë intelektuale

Neni 16 – Konsultimi ndërmjet përfituesit IPA II dhe Komisionit

Neni 17 – Ndryshimi i marrëveshjes përkatëse të financimit

Neni 18 – Pezullimi i marrëveshjes përkatëse të financimit

Neni 19 – Lidhja e marrëveshjes përkatëse të financimit

Neni 20 – Masat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

PJESA E PARË
DISPOZITAT E ZBATUESHME TË AKTIVITETEVE PËR TË CILAT PËRFITUESI IPA II
ËSHTË AUTORITETI KONTRAKTUES

Neni 1

Parime të përgjithshme

1. Qëllimi i pjesës së parë është përcaktimi i rregullave për zbatimin e detyrave të besuara për zbatimin e buxhetit të parashikuara në shtojcën I dhe përcaktimi i të drejtave dhe i detyrimeve përkatësisht të përfituesit IPA II dhe Komisionit në kryerjen e këtyre detyrave.

Pjesa e parë do të zbatohet për detyrat e zbatimit të buxhetit që i besohen përfituesit IPA II vetëm në lidhje me kontributet e Bashkimit ose të kombinuara me fondet e përfituesit IPA II, apo të një pale të tretë, në rast se fonde të tilla zbatohen në një bashkëfinancim, d.m.th., aty ku janë të bashkuara.

2. Përfituesi IPA II mbetet përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje Financimi dhe në Marrëveshjen Kuadër edhe nëse i nëndelegon subjekteve të tjera të

përcaktuara në shtojcën I kryerjen e disa detyrave të besuara për zbatimin e buxhetit. Komisioni, në veçanti, rezervon të drejtën të pezullojë pagesat dhe të pezullojë/ose të anulojë këtë Marrëveshje Financimi mbi bazën e akteve, mosveprimeve dhe/ose situatave të ndonjë subjekti të përcaktuar.

3. Detyrat e referuara në paragrafin 1 të këtij neni kryhen nga përfituesi IPA II, në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe publikuara nga Komisioni për dhënien e prokurimit dhe kontratat e grantit në veprimet e jashtme, të cilat ishin në fuqi në kohën e fillimit të procedurës në fjalë (PRAG), si dhe në përputhje me standardet e kërkuara për vizibilitetin dhe komunikimin të përmendura në nenin 2(2).

4. Përfituesi IPA II kryen procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve, lidh kontratat që rezultojnë dhe siguron që të gjitha dokumentet përkatëse për gjurmën e auditit të jenë në gjuhën e Marrëveshjes së Financimit në fjalë.

Përfituesi IPA II duhet të respektojë normën minimale të kontributeve të tij të përcaktuara në shtojcën I. Në rastin kur kontributet jepen si nga përfituesi IPA II dhe nga Bashkimi Evropian, kontributi i përfituesit IPA II do të vihet në dispozicion në të njëjtën kohë si kontributi përkatës nga unioni.

5. Përfituesi IPA II duhet të ruajë të gjitha dokumentet mbështetëse përkatëse financiare dhe kontraktuese nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi ose nga data më e hershme në rast se procedurat e prokurimit, thirrjet për propozime apo procedura e drejtpërdrejtë e dhënies së granteve, në mënyrë të drejtpërdrejtë ka filluar përpara hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Financimit:

a) Për procedurat e prokurimit në veçanti:

- a) njoftimin e parashikimit me dëshminë e publikimit të njoftimit të prokurimit dhe çdo ndreqje të gabimeve;
- b) caktimi i panelit të listës përfundimtare;
- c) raporti i listës përfundimtare (duke përfshirë anekset) dhe i aplikimeve;
- d) dëshmi e publikimit të njoftimit të listës përfundimtare;
- e) letrat për kandidatët që nuk bëjnë pjesë në listën përfundimtare;
- f) ftesa për tender ose ekuivalente;
- g) dosja e tenderit, duke përfshirë anekset, sqarimet, procesverbalet e mbledhjeve, dëshminë e publikimit;
- h) caktimi i komisionit të vlerësimit;
- i) raporti për hapjen e tenderit, duke përfshirë anekset;
- j) raporti i vlerësimit/negocimit, duke përfshirë anekset dhe ofertat e pranuar³¹;
- k) letërnjoftimi;
- l) shkresë përcjellëse për dorëzimin e kontratës;
- m) letrat për kandidatët e pasuksesshëm;
- n) njoftimi për dhënie/anulim, duke përfshirë dëshminë e publikimit;
- o) kontratat e nënshkruara, amendamentet, klauzolat shtesë, raportet e zbatimit dhe korrespondenca përkatëse.

b) Për thirrjet për propozime dhe procedurat e drejtpërdrejta për dhënien e granteve në veçanti:

- a) caktimi i komisionit të vlerësimit;
- b) hapja dhe raporti administrativ, duke përfshirë anekset dhe aplikimet e pranuar³²;
- c) letër për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm pas vlerësimit të prospektit;
- d) raporti i vlerësimit të prospektit;
- e) raport vlerësimi i aplikimit të plotë ose raport negociimi me anekset përkatëse;
- f) kontrolli i përshtatshmërisë dhe dokumentet mbështetëse;
- g) letra për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm, së bashku me listën e miratuar rezervë pas vlerësimit të aplikimit të plotë;
- h) shkresë përcjellëse për dorëzimin e kontratës së grantit;
- i) njoftimi i dhënies/i anulimit me dëshminë e publikimit;
- j) kontratat e nënshkruara, amendamentet, klauzolat shtesë, raportet e zbatimit dhe korrespondenca

³¹Eliminimi i ofertave të pasuksesshme pesë vjet pas përfundimit të procedurës së prokurimit.

³²Eliminimi i aplikimeve të pasuksesshme tre vjet pas përfundimit të procedurës së grantit.

përkatëse.

Gjithashtu, dokumentet financiare dhe kontraktuale të përmendura në paragrafën 5(a) dhe (b) të këtij neni do të plotësohen me të gjitha dokumentet mbështetëse përkatëse, siç kërkohej nga procedurat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni, si dhe të gjithë dokumentacionin përkatës në lidhje me pagesat, rikuperimet dhe shpenzimet operative, për shembull, projekti dhe raportet e kontrolleve në terren, pranimi i furnizimeve dhe i punimeve, garancitë, raportet e inxhinierëve të mbikëqyrjes.

Të gjitha dokumentet financiare dhe kontraktuale përkatëse do të ruhen për të njëjtën kohëzgjatje, në përputhje me nenin 49 të Marrëveshjes Kuadër.

6. Me qëllim zbatimin e nenit 25 të Marrëveshjes Kuadër, mbi mbrojtjen e të dhënave, të dhënat personale duhet:

- të përpunohen sipas ligjit, me drejtësi dhe në mënyrë transparente, në lidhje me të dhënat e subjektit;
- të mbliidhen për qëllime specifike, të qarta dhe legjitime dhe jo të përpunohen në mënyrë që të jenë të mospërputhshme me këto qëllime;
- të përshtatshme, të rëndësishme dhe të kufizuara të çfarë është e nevojshme lidhur me qëllimet për të cilat po përpunohen;
- të sakta dhe aty ku është e nevojshme, të përditësuara;
- të përpunuara, në mënyrë që të sigurojë garancinë e përshtatshme të të dhënave personale;
- të mbahen në një mënyrë që të lejojnë identifikimin e të dhënave të subjektit për jo më shumë se sa nevojitet, për qëllimin për të cilin po përpunohen këto të dhëna personale;
- të dhënat personale të përfshira në dokumentet që do të mbahen nga përfituesi IPA II, në përputhje me nenin 1.5 duhen të fshihen sapo afati final i përcaktuar në nenin 1.5 të përfundojë.

Neni 1a

Detyrimi për të informuar, sanksionet administrative dhe mosveprimi

1. Kur aplikohet për procedurat dhe dokumentet standarde, të cilat prezantohen dhe publikohen nga Komisioni për dhënien e prokurimit dhe kontratat grant, përfituesi IPA II do të garantojë që, sipas rregullave, asnjë prokurim i financuar nga BE-ja ose kontrata grant nuk do t'i jepet një operatori ekonomik ose aplikanti granti, i cili, nëse operatori ekonomik që ose personalisht ose nëpërmjet një tjetri që e përfaqëson, vendos për të ose e kontrollon, ndodhet në një nga situatat përjashtuese të përcaktuara në procedurat dhe dokumentet standarde të Komisionit.

2. Përfituesi IPA II duhet të informojë Komisionin menjëherë, kur një kandidat, tenderues apo aplikant është në situatë përjashtimi nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit, kur ka parregullsi apo mashtrim ose, kur ka shkelje të rëndë të detyrimeve kontraktuale.

3. Përfituesi IPA II merr përgjegjësinë mbi informacionin e përmbajtur në "Sistemin e identifikimit dhe përjashtimit të hershëm"(EDES) të Komisionit, kur jepen kontratat e prokurimeve dhe të granteve. Qasja në informacion mund të ofrohet nëpërmjet pikës/ave ndërlidhëse ose nëpërmjet konsultimit me rrugë të ndryshme (Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Buxhetin, Zyrtarin Kontabilist të Komisionit, BRE 2-13/505, B-1049 Bruksel, Belgjikë dhe nëpërmjet *email*-it drejtuar Komisionit: BUDG-C01-EXCL-DB@ec.europa.eu, të përcaktuar në nenin 3 të kushtet e veçanta).

4. Kur përfituesi IPA II vihet në dijeni për situatën e përjashtimit në zbatimin e detyrave të përshkruara në shtojcën I, përfituesi vendos përjashtimin e operatorit ekonomik apo aplikantit për grant nga procedura në vazhdim e prokurimit ose dhënies së grantit. Përfituesi IPA II mund të vendosë penalitete financiare në raport me vlerën e kontratës në fjalë. Përjashtimet dhe/ose gjambat financiare vendosen pas procedurës së kundërshtimit që garanton të drejtën e mbrojtjes së personit në fjalë. Përfituesi IPA II njofton Komisionin sipas paragrafit 1 të këtij neni.

5. Lidhur me paragrafin 3 të këtij neni, përfituesi IPA II konsiderohet në kushtet e mosveprimit, nëse nuk vendos përjashtimin apo/dhe penalitet financiar mbi operatorin ekonomik apo aplikantin e grantit.

6. Në rast të pamundësisë për të vepruar, përfituesi IPA II njofton Komisionin, duke shpjeguar arsyet e pamundësisë për të vepruar. Komisioni rezervon të drejtën e përjashtimit të operatorit ekonomik ose aplikantit për grant nga procedurat në vazhdim të BE-së të dhënies së financimit dhe/ose të vendosë penalitet financiar mbi një operator ekonomik apo aplikant për grant ndërmjet

2–10% të vlerës totale të kontratës në fjalë.

Neni 2

Vizibiliteti dhe komunikimi

1. Në përputhje me nenin 24(3) të Marrëveshjes Kuadër, përfituesi IPA II merr masa për të siguruar vizibilitetin e financimit të BE-së për aktivitetet që i janë besuar dhe për të përgatitur një plan koherent aktivitetesh vizibiliteti dhe komunikimi, i cili duhet t'i paraqitet Komisionit për marrëveshje brenda 2 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Financimit.

2. Këto aktivitete komunikimi dhe vizibiliteti duhet të jenë në përputhje me Manualin e Vizibilitetit dhe të Komunikimit për Veprimet e Jashtme të BE-së 1% të përcaktuara dhe publikuara nga Komisioni në fuqi në kohën e aktiviteteve.

Neni 3

Kontrollet *ex-ante* për procedurat e granteve dhe të prokurimit dhe kontrollet *ex-post* për kontratat dhe grantet që do të kryhen nga Komisioni

1. Komisioni mund të ushtrojë kontrolle *ex-ante* mbi tenderimin e kontratave, lançimin e thirrjeve për propozime dhe dhënien e kontratave dhe granteve për fazat vijuese të dhënies së prokurimit apo grantit:

a) miratimi i njoftimeve të kontratës për prokurim, programet e punës për thirrjet për propozime dhe çdo korrigjim të tyre;

b) miratimi i dosjeve të tenderit dhe udhëzimeve për aplikantët për grantet;

c) miratimi i përbërjes së komiteteve të vlerësimit;

d) miratimi i raporteve të vlerësimit dhe të marrjes së vendimeve³³;

e) miratimi i dosjeve të kontratave dhe i shtesave të kontratave.

2. Lidhur me kontrollet *ex-ante*, Komisioni vendos:

a) të kryejë kontrolle *ex-ante* në të gjitha fushat; ose

b) të kryejë kontrolle *ex-ante* në një nga këto fusha; ose

c) të heqë dorë plotësisht nga kontrollet *ex-ante*.

3. Nëse Komisioni vendos të kryejë kontrolle *ex-ante* në përputhje me paragrafin 2(a) ose (b) të këtij neni, ai nuk do të informojë përfituesin IPA II mbi dosjet e përzgjedhura për kontrolle *ex-ante*. Përfituesi IPA II duhet t'i paraqesë Komisionit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm, menjëherë pasi informohet mbi përzgjedhjen e një dosje për kontroll *ex-ante*, më së fundi në kohën e dorëzimit të njoftimit të kontratës apo programit të punës për publikim.

4. Komisioni mund të vendosë të kryejë kontrolle *ex-post*, duke përfshirë auditimet dhe kontrollet në terren, në çdo moment për çdo kontratë dhe grant të dhënë nga përfituesi IPA II që rrjedh nga kjo Marrëveshje Financimi. Përfituesi IPA II duhet t'i paraqesë Komisionit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm, menjëherë pasi informohet mbi përzgjedhjen e një dosjeje për kontroll *ex-post*. Komisioni mund të autorizojë një person ose subjekt që të kryejë kontrolle *ex-post* në emër të tij.

Neni 4

Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe shpenzimet e pranuar

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi, Fondi Kombëtar dhe struktura operuese e përfituesit IPA II që është Autoriteti Kontraktues për Programin, do të hapë të paktën një llogari bankare të shprehur në euro. Bilanci i përgjithshëm bankar për Programin do të jetë shuma e bilanceve për të gjitha llogaritë bankare të Programit të mbajtura nga Fondi Kombëtar dhe të gjitha strukturat operuese pjesëmarrëse në përfituesin IPA II.

2. Përfituesi IPA II duhet të përgatisë dhe t'i paraqesë Komisionit planet e parashikimit të disbusimit për kohëzgjatjen e periudhës së zbatimit të Programit. Këto parashikime duhet të përditësohen për raportin vjetor financiar të përmendur në nenin 14(2) dhe për çdo kërkesë për fonde.

³³ Për kontratat e shërbimit ky hap përfshin kontrolle *ex-ante* në lidhje me miratimin e listës përfundimtare.

Parashikimet duhet të bazohen në një analizë të hollësishme të dokumentuar (duke përfshirë programin e planifikuar të kontraktimit dhe pagesave për katërmbëdhjetë muajt në vijim), e cila do të vihet në dispozicion të Komisionit, nëse kërkohet.

3. Plani fillestar për parashikimin e disbursimit duhet të përmbajë një përmbledhje të parashikimeve vjetore të disbursimit për të gjithë periudhën e zbatimit dhe parashikimet mujore të disbursimit për katërmbëdhjetë muajt e Programit. Planet e mëvonshme do të përmbajnë përmbledhje të parashikimeve vjetore të disbursimit për bilancin e periudhës së zbatimit të Programit dhe parashikimet mujore të disbursimit për katërmbëdhjetë muajt e ardhshëm të Programit.

4. Përfituesi IPA II kërkohet që të krijojë dhe të ruajë një sistem kontabiliteti, në përputhje me klauzolën 2(3)(b), të shtojcës A, të Marrëveshjes Kuadër, e cila do të përmbajë të paktën të dhëna për kontratat e menaxhuara në kuadrin e programit të parashikuar në shtojcën V.

5. Shpenzimet e pranuar në sistemin e kontabilitetit parashikuar në pjesën 4 të këtij neni duhet të jenë bërë, paguar dhe pranuar dhe të korrespondojnë me shpenzimet reale të provuara me dokumente mbështetëse dhe duhet të përdoren, kur është e nevojshme për të likuiduar paraфинancimin e paguar nga përfituesi IPA II, sipas kontratave lokale.

6. Përfituesi IPA II duhet t'i sigurojë Komisionit raportet në vijim:

- a) raporti i ndërprerjes siç përcaktohet në nenin 14(4);
- b) raportet vjetore siç përcaktohet në paragrafët 2 deri 4, të nenit 14;
- c) kërkesën për raportet e fondeve të referuara në nenin 5.

Neni 5

Dispozitat mbi pagesat e kryera nga Komisioni për përfituesin IPA II

1. Përfituesi IPA II duhet të paraqesë parashikimet e tij fillestare të disbursimit, të përgatitura sipas nenit 4(2), së bashku me kërkesën e pagesës së parë të paraфинancimit. Pagesa e parë e paraфинancimit duhet të jetë për 100% të disbursimeve të parashikuara për vitin e parë të planit të parashikimit për disbursimet.

2. Përfituesi IPA II duhet të paraqesë kërkesat e pagesave vijuese të paraфинancimit, kur bilanci i përgjithshëm bankar për programin bie nën nivelin e parashikimeve të disbursimit për pesë muajt e ardhshëm të programit.

3. çdo kërkesë për paraфинancim shtesë duhet të mbështetet nga dokumentet e mëposhtme:

- a) një pasqyrë përmbledhëse e të gjitha disbursimeve të bëra për programin;
- b) bilancet bankare për programin në datën e ndërprerjes së kërkesës;
- c) Një plan parashikimi të disbursimeve për programin për katërmbëdhjetë muajt e ardhshëm që nga dita e ndërprerjes së kërkesës në përputhje me pikën (d), të shtojcës IV.

4. Përfituesi IPA II mund të kërkojë për çdo financim të mëvonshëm shumën e disbursimeve totale të parashikuara për katërmbëdhjetë muajt, që nga data e ndërprerjes së kërkesës, pa bilancet e përmendura në pjesën 3(b) të këtij neni në datën e ndërprerjes së kërkesës për fonde të rritura me ndonjë shumë të financuar nga përfituesi IPA II, sipas paragrafit 5 të këtij neni dhe që nuk është rimbursuar ende.

Komisioni rezervon të drejtën për të reduktuar çdo pagesë të mëvonshme paraфинancimi, nëse bilancet e përgjithshme bankare të kryera nga përfituesi IPA II, në kuadrin e këtij programi dhe të gjitha programet e tjera IPA I ose IPA II të menaxhuara nga përfituesi IPA II, tejkalojnë parashikimin e disbursimit për katërmbëdhjetë muajt e ardhshëm.

5. Kur pagesa reduktohet sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfituesi IPA II duhet të financojë programin nga burimet e veta deri në shumën e reduktimit. Përfituesi IPA II mund të kërkojë më pas rimbursimin e financimit si pjesë e kërkesës së ardhshme për fonde të parashikuara në paragrafin 4 të këtij neni.

6. Komisioni ka të drejtë të rikuperojë bilancet e tepërta bankare që kanë mbetur pa u përdorur për më shumë se dymbëdhjetë muajt. Para ushtrimit të kësaj të drejte, Komisioni fton përfituesin IPA II të japë arsyet e vonës në disbursimin e fondeve dhe të provojë nevojën e vazhdueshme për ta, gjatë dy muajve të ardhshëm.

7. Interesat e gjeneruar nga paraфинancimi i bilanceve bankare të programit nuk do të paguhen.

8. Sipas nenit 33(4) të Marrëveshjes Kuadër, nëse ndërprerja e afatit kohor për kërkesën e pagesës tejkalon dy muaj, përfituesi IPA II mund të kërkojë një vendim nga Komisioni, lidhur me faktin nëse do të vazhdojë ndërprerja e afatit kohor.

9. Pasqyra financiare përfundimtare e përmendur në nenin 37(2) të Marrëveshjes Kuadër i paraqitet ZKA-së, jo më vonë se 16 muaj pas përfundimit të periudhës së zbatimit operacional.

Neni 6

Ndërprerja e pagesave

1. Pa cenuar pezullimin ose përfundimin e Marrëveshjes së Financimit, në përputhje, përkatësisht me nenet 18 dhe 19, si dhe pa cenuar nenin 39 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të ndërpresë pagesat pjesërisht ose plotësisht, nëse:

a) Komisioni ka vendosur ose ka shqetësime serioze se përfituesi IPA II ka kryer gabime të konsiderueshme, parregullsi apo mashtrime që vënë në dyshim ligjshmërinë ose rregullsinë e transaksioneve të veçanta themelore në zbatimin e programit ose nuk ka përmbushur detyrimet e tij në kuadrin e Marrëveshjes së Financimit, duke përfshirë detyrimet në lidhje me zbatimin e planit të vizibilitetit dhe të komunikimit;

b) Komisioni ka vendosur ose ka shqetësime serioze, në lidhje me faktin nëse përfituesi IPA II ka kryer gabime sistematike ose të përsëritura, parregullsi, mashtrime ose shkelje të detyrimeve në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi apo të tjera të ngjashme, me kusht që këto gabime, parregullsi, mashtrime ose shkelje e detyrimeve, të kenë ndikim material në zbatimin e Marrëveshjes së Financimit apo të vënë në dyshim besueshmërinë e sistemit të brendshëm të kontrollit të përfituesit IPA II ose ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve kryesore.

Neni 7

Rikuperimi i fondeve

1. Përveç rasteve të përmendura në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të rikuperojë fondet nga përfituesi IPA II, siç parashikohet në Rregulloren e Financimit, veçanërisht në rastet e mëposhtme:

a) Komisioni ka vendosur se nuk janë përmbushur objektivat e Programit të përcaktuar në shtojcën I;

b) shpenzime të papranueshme;

c) mosrespektimi i normës së kontributit, siç parashikohet në shtojcën I;

d) shpenzime të krijuara si rezultat i gabimeve, parregullsive, mashtrimeve ose shkeljes së detyrimeve në zbatimin e programit, veçanërisht në procedurën e prokurimit dhe dhënies së granteve.

2. Në përputhje me të drejtën kombëtare, përfituesi IPA II rikuperon kontributin e Bashkimit që i paguhet përfituesit IPA II nga marrësit të cilët ishin në ndonjë nga situatat e përcaktuara në paragrafin 1, pikat (b) ose (d) të këtij neni ose përmendur në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër. Fakti që përfituesi IPA II nuk arrin të rikuperojë një pjesë apo të gjitha fondet, nuk pengon Komisionin të rikuperojë fondet nga përfituesi IPA II.

3. Shumat e paguara në mënyrë të parregullt ose të rikuperuara nga përfituesi IPA II, shumat nga garancitë financiare, të performancës dhe parafinancimit të paraqitura mbi bazën e procedurave të prokurimit dhe dhënies së granteve, shumat nga penalitetet financiare të vendosura nga përfituesi IPA II për kandidatët, ofertuesit, aplikantët, kontraktuesit ose përfituesit e granteve për përfituesin IPA II do të përdoren sërish për programin ose do t'i rikthehen Komisionit.

PJESA E DYTË

DISPOZITAT E ZBATUESHME PËR MBËSHTETJEN BUXHETORE

Neni 8

Dialogu mbi politikat

Përfituesi IPA II dhe Komisioni marrin përsipër se do të angazhohen në një dialog të rregullt konstruktiv në nivelin e duhur për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 9

Verifikimi i kushteve dhe disbursimit

1. Komisioni verifikon kushtet për pagesën e kësteve të komponentit të mbështetjes buxhetore, siç përcaktohet në shtojcën I dhe shtojcën IA.

2. Në rastin kur Komisioni nxjerr përfundimin se nuk janë përmbushur kushte për pagesat, ai informon pa asnjë vonesë përfituesin IPA II.

3. Kërkesat e disbursimit të paraqitura nga përfituesi IPA II janë të pranueshme për financimin e BE-së me kusht që ato të jenë në përputhje me dispozitat e përcaktuara në shtojcën I dhe shtojcën IA dhe të jenë paraqitur gjatë fazës së zbatimit operacional.

4. Përfituesi IPA II do të zbatojë rregullat e tij kombëtare në kursin e këmbimit të monedhave të huaja në mënyrë jodiskriminuese për të gjitha disbursimet e komponentit të mbështetjes buxhetore.

Neni 10

Transparenca e mbështetjes buxhetore

Përfituesi IPA II, me këtë rast, bie dakord për publikimin nga Komisioni të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe çdo ndryshimi të saj, përfshirë me mjete elektronike, si dhe të informacionit bazë për mbështetjen buxhetore që Komisioni e çmon të nevojshme. Përmbajtja e publikimit do të jetë në përputhje me ligjet e BE-së të zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 11

Rikuperimi i mbështetjes buxhetore

Të gjitha disbursimet e mbështetjes buxhetore apo pjesë të tij mund të rikuperohen nga Komisioni, me respektimin e duhur të parimit të proporcionalitetit, nëse Komisioni vendos se pagesa ka qenë e pavlefshme, për shkak të një parregullsie serioze që i atribuohet përfituesit IPA II, veçanërisht nëse përfituesi IPA II ka dhënë informacione jo të besueshme ose të pasakta apo nëse ka vend për korrupsion apo mashtrim.

PJESA E TRETË

DISPOZITAT E ZBATUESHME PËR MARRËVESHJEN PËRKATËSE TË FINANCIMIT, PAVARËSISHT NGA MËNYRA E MENAXHIMIT

Neni 12

Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues

1. Periudha e ekzekutimit është periudha gjatë së cilës zbatohet Marrëveshja e Financimit dhe përfshin periudhën e zbatimit operacional, si dhe fazën e mbylljes. Kohëzgjatja e periudhës së ekzekutimit përcaktohet në nenin 2(2) të kushteve të veçanta dhe fillon me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Periudha e zbatimit operacional është periudha gjatë së cilës kryhen të gjitha aktivitetet operationale të mbuluara me prokurim, kontratat e granteve dhe marrëveshjet e delegimit. Kohëzgjatja e kësaj periudhe përcaktohet në nenin 2(2) të kushteve të veçanta dhe fillon me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

3. Periudhat e ekzekutimit dhe zbatimit operacional respektohen nga autoriteti kontraktues, kur lidh dhe zbaton prokurimet, kontratat e granteve dhe marrëveshjet e delegimit në këtë Marrëveshje Financimi.

4. Shpenzimet e lidhura me aktivitetet janë të pranueshme për financimin e BE-së, vetëm nëse janë shkaktuar gjatë periudhës së zbatimit operacional; shpenzimet e kryera nga përfituesi IPA II, para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Financimit, nuk janë të pranueshme për financimin e BE-së.

5. Kontratat e prokurimeve dhe të granteve do të përfundojnë, maksimumi brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Financimit, përveç:

- a) ndryshimeve të kontratave që janë lidhur;
- b) kontratave individuale të prokurimit që do të lidhen pas ndërprerjes së parakohshme të kontratës ekzistuese të prokurimit;
- c) kontratave në lidhje me auditimin dhe vlerësimin, të cilat mund të nënshkruhen pas zbatimit operacional;
- d) ndryshimit të subjektit të ngarkuar me detyrat e besuara.

6. Një kontratë prokurimi ose granti e cila nuk ka mundur ndonjë pagesë brenda dy vjetëve të nënshkrimit të saj, do të ndërpritet automatikisht dhe financimi i saj do të tërhiqet.

Neni 13

Lejet dhe autorizimi

Çdo lloj leje dhe/ose autorizimi i kërkuar për zbatimin e programit duhet të sigurohen në kohën e duhur nga autoritetet kompetente të përfituesit IPA II, në përputhje me të drejtën kombëtare.

Neni 14

Kërkesat e raportimit

1. Për qëllimet e kërkesave të përgjithshme të raportimit në Komision, të përcaktuara në nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër dhe kërkesat specifike të raportimit, sipas menaxhimit indirekt të përcaktuar në nenin 59(1) të Marrëveshjes Kuadër, për raportin vjetor mbi zbatimin e , IPA II, KKIPA duhet të përdorë modelin e parashikuar në shtojcën III të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Për qëllimet e kërkesave specifike të raportimit sipas menaxhimit indirekt të përcaktuar në pikën (a), të nenit 59(2) të Marrëveshjes Kuadër, për pasqyrat ose raportin financiar vjetor, për përfituesin IPA II, ZKA duhet të përdorë modelin e parashikuar në pikat (a) dhe (b), të shtojcës IV të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

3. Për qëllimet e nenit 59(4) të Marrëveshjes Kuadër, KKIPA-ja duhet të paraqesë një raport përfundimtar mbi zbatimin e asistencës IPA II të këtij programi në Komision jo më vonë se katër muaj pas disbursimit të fundit për kontraktuesit e vet ose përfituesit e granteve.

4. Për qëllimet e nenit 59(6) të Marrëveshjes Kuadër, ZKA-ja duhet të sigurojë në format elektronik deri më 15 janar të vitit financiar vijues një kopje të të dhënave të mbajtura në sistemin e kontabilitetit të përcaktuar në nenin 4(4). Kjo kopje duhet të shoqërohet me një përmbledhje të audituar dhe të nënshkruar të raportit financiar në përputhje me pikën (c) të shtojcës IV.

Neni 15

Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Kontratat e financuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi duhet të sigurojnë që përfituesi IPA II fiton të gjitha të drejtat e nevojshme të pronësisë intelektuale, në lidhje me teknologjinë e informacionit, studimet, skicat, planet, publicitetin dhe çdo material tjetër të përgatitur për qëllime planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi.

2. Përfituesi IPA II duhet të garantojë që Komisioni ose kushdo apo person tjetër i autorizuar nga Komisioni, do të ketë qasje dhe të drejtën që të përdorë një material të tillë. Vetëm Komisioni do të përdorë një material të tillë për qëllimet e veta.

Neni 16

Konsultimi ndërmjet përfituesit IPA II dhe Komisionit

1. Përfituesi IPA II dhe Komisioni konsultohen me njëri-tjetrin para hartimit të ndonjë mosmarrëveshjeje, në lidhje me zbatimin ose interpretimin e mëtejshëm të kësaj Marrëveshjeje Financimi në zbatim të nenit 20.

2. Në rastet kur Komisioni vihet në dijeni për problemet në kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, ai vendos të gjitha kontaktet e nevojshme me përfituesin IPA II për të rregulluar dhe për të marrë çdo hap të nevojshëm.

3. Konsultimi mund të çojë në një ndryshim, pezullim ose përfundimin të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

4. Komisioni vë në dijeni rregullisht përfituesin IPA II mbi zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në shtojcën I, të cilat nuk janë në pjesën e parë të kushteve të përgjithshme.

Neni 17

Ndryshimi i marrëveshjes përkatëse të financimit

1. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje Financimi bëhet me shkrim, duke përfshirë një shkëmbim letrash.

2. Nëse përfituesi i IPA II kërkon një ndryshim, kërkesa duhet t'i paraqitet Komisionit të paktën gjashtë muaj para se ky ndryshim është planifikuar të hyjë në fuqi.

3. Komisioni mund të ndryshojë dokumentet model në shtojcën III, IV dhe V pa bërë të nevojshme ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi. Përfituesit IPA II informohen me shkrim për çdo ndryshim të tillë dhe hyrjen e tij në fuqi.

Neni 18

Pezullimi i marrëveshjes përkatëse të financimit

1. Marrëveshja e financimit mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse përfituesi IPA II shkel një detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje Financimi;

b) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje financimi, nëse përfituesi IPA II shkel ndonjë detyrim të përcaktuar, sipas procedurave dhe dokumenteve standarde të përmendura në nenin 18(2) të Marrëveshjes Kuadër;

c) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse përfituesi IPA II nuk përmbush kërkesat për t'i besuar detyrat e zbatimit të buxhetit;

d) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse përfituesi IPA II vendos të pezullojë ose të pushojë procesin e aderimit të anëtarësimit në BE;

e) Komisioni mund të pezullojë këtë Marrëveshje Financimi, nëse përfituesi IPA II shkel një detyrim në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet demokratike dhe shtetit ligjor, si dhe në rastet e rënda të korrupsionit;

f) Marrëveshja e Financimit mund të pezullohet në rastet e forcës madhore, siç përcaktohet më poshtë. "Forcë madhore" nënkupton çdo situatë ose ngjarje të paparashikueshme dhe të jashtëzakonshme përtej kontrollit të palëve që pengon secilën prej tyre në përmbushjen e detyrimeve të tyre, që nuk i atribuohet një gabimi apo pakujdesie nga ana e tyre (ose nga ana e kontraktuesve, agjentëve apo të punësuarve të tyre) dhe që rezulton e pakapërcyeshme me gjithë kujdesin e duhur. Defektet në pajisje ose në materiale apo vonesat në vënien e tyre në dispozicion, mosmarrëveshjet në punë, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të përdoren si forcë madhore. Një palë nuk mund të shpallet në shkelje të detyrimeve të saj nëse pengohet t'i përmbushë ato nga një rast i forcës madhore për të cilin pala tjetër është informuar në mënyrën e duhur. Një palë që përballlet me forcë madhore duhet të informojë palën tjetër pa vonesë, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit, dhe ndonjë masë për minimizimin e dëmit të mundshëm. Nëse forca madhore ndikon vetëm në një pjesë të programit, pezullimi i Marrëveshjes së Financimit mund të jetë i pjesshëm;

g) Asnjë nga palët nuk mund të shpallet përgjegjëse për shkelje të detyrimeve të saj, sipas Marrëveshjeje Financimi, nëse pengohet në përmbushjen e tyre për shkak të një force madhore, me kusht që të marrë masat për të minimizuar çdo dëm të mundshëm.

2. Komisioni mund të pezullojë këtë Marrëveshje Financimi pa njoftim paraprak.

3. Komisioni mund të marrë të gjitha masat e nevojshme paraprake para se të ndodhë pezullimi.

4. Në rastin kur njoftohet pezullimi, duhet të tregohen pasojat për prokurimin në vijim apo që do të nënshkruhet dhe kontratat e granteve, si dhe Marrëveshjet e delegimit.

5. Pezullimi i Marrëveshjes së Financimit bëhet pa cenuar ndërprerjen e pagesave dhe përfundimin e Marrëveshjeje Financimi nga Komisioni në përputhje me nenin 6 dhe nenin 19.

6. Palët e përfshira rifillojnë zbatimin e Marrëveshjes së Financimit, menjëherë pasi këtë e lejojnë kushtet me miratimin paraprak me shkrim të Komisionit. Kjo realizohet pa cenuar ndonjë ndryshim të Marrëveshjeje Financimi që mund të jetë i nevojshëm për të përshtatur programin me kushtet e reja të zbatimit, duke përfshirë, nëse është e mundur, zgjatjen e zbatimit operacional dhe periudhat e ekzekutimit ose lidhjen e një Marrëveshjeje Financimi, në përputhje me nenin 19.

Neni 19

Përfundimi i marrëveshjes përkatëse të financimit

1. Nëse çështjet që çuan në pezullimin e Marrëveshjeje Financimi nuk janë zgjidhur brenda një periudhe maksimale prej 180 ditësh, secila palë mund ta përfundojë Marrëveshjen e Financimit pas një njoftimi brenda 30 ditëve.

2. Në rastin kur përfundimi njoftohet, duhet të tregohen pasojat për prokurimin në vijim dhe kontratat e granteve, si dhe marrëveshjet e delegimit që do të nënshkruhen.

3. Përfundimi i marrëveshjes përkatëse të financimit nuk përjashton mundësinë që Komisioni të bëjë korrigjime financiare, në përputhje me nenet 36–44 të marrëveshjes kuadër.

Neni 20

Masat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje, në lidhje me Marrëveshjen e Financimit, që nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nëpërmjet konsultimeve ndërmjet palëve të parashikuara në nenin 16, mund të zgjidhet nëpërmjet arbitrazhit me kërkesën e një prej palëve.

2. Secila palë cakton një arbitër brenda 30 ditëve të kërkesës për arbitrazh. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (Hagë) të caktojë një arbitër të dytë. Dy arbitrat, nga ana e vet, caktojnë një arbitër të tretë brenda 30 ditëve. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit të caktojë arbitrin e tretë.

3. Nëse arbitrat nuk vendosin ndryshe, zbatohet procedura e përcaktuar në Gjykatën e Përhershme të Rregullave Opsionale të Arbitrazhit për Arbitrazhin që përfshin Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare. Vendimet e arbitrave merren me shumicë brenda një periudhe tremujore.

4. Secila palë është e detyruar të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimit të arbitrave.

SHTOJCË III

MODEL I RAPORTIT VJETOR

Periudha e mbuluar nga raporti:

1.1.20XX–31.12.20XX

Raporti i publikuar më XX.XX.20XX

Raport vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II nën menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga [vendi] të paraqitur nga koordinatori kombëtar IPA

I. Përmbledhje ekzekutive

1. Referenca për objektivat e dokumenteve strategjike të vendit dhe një pasqyrë e përmbledhur e sfidave në sektorë;

2. Përfshirja në programim;

3. Marrëdhëniet me Komisionin Evropian;

4. Problemet e hasura në përmbushjen e kushteve të kërkuara për zbatim dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë, masat e ngjashme të marra/të planifikuara, rekomandimet për veprime të mëtejshme;

5. Çështjet përkatëse që rrjedhin nga pjesëmarrja e përfituesit nga IPA II në komitetin monitorues të IPA dhe në komitetet monitoruese sektoriale (duke përfshirë Komitetin e Përbashkët Monitorues për CBC/BNK (bashkëpunimi ndërkufitar)), nëse ka;

6. Përfshirja në aksionet shumëvendëshe dhe çështjet që lidhen me to;

7. Aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit, mësimet e nxjerra dhe ndjekja e rekomandimeve;

8. Aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit;

9. Koordinimi i donatorëve;

Në rastin e menaxhimit të tërthortë, përmbledhja ekzekutive duhet të mbulojë, gjithashtu:

10. Zbatimin e përgjithshëm të asistencës IPA nën menaxhimin e tërthortë (maks. një faqe).

11. Problemet kryesore horizontale të ndeshura gjatë zbatimit të asistencës IPA dhe masat vijuese të marra/të planifikuara (maks. gjysmë faqe).

12. Rekomandimet për veprime të mëtejshme (maks. gjysmë faqe).

13. Auditimet - konstatimet kryesore dhe rekomandimet, si dhe masat korrigjuese të marra.

II. Të dhënat për sektor

Titulli i sektorit³⁴: [Transporti]

Pjesa narrative/treguese: përmbledhja për sektor, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:

1. Përfshirja në programim;

2. Përmbledhje e rezultateve në zhvendosjen drejt një qasjeje të përsosur sektoriale (d.m.th., objektivat e arritur, sipas udhëzuesit të sektorit në dokumentin e planifikimit të sektorit);

3. Koordinimi me instrumente të tjera dhe/ose donatorë/IFN në sektor;

4. Ndikimi i veprimeve të IPA II brenda sektorit për zhvillimin e kapaciteteve përkatëse kombëtare administrative në sektor, planifikim strategjik dhe buxhetim.

Në menaxhimin e tërthortë duhet të përfshihet gjithashtu informacioni i mëposhtëm:

5. Struktura/t operuese në funksion dhe ndryshimet që lidhen me to, nëse është e rëndësishme: [Ministria e Transportit];

6. Të dhëna mbi zbatimin e programeve në sektor;

7. Arritjet kryesore në sektor;

8. Çdo problem i rëndësishëm që haset në zbatimin e detyrave të besuara, p.sh., vonesat në kontraktim, dhe masat vijuese të marra/planifikuara;

9. Rekomandime për masat e mëtejshme;

10. Aktivitetet e zbatuara për monitorimin dhe vlerësimin, auditimet – konstatimet kryesore dhe mësimet e nxjerra, rekomandimet, ndjekja dhe masat korrigjuese të marra.

Titulli i sektorit: Bashkëpunimi ndërkufitar³⁵

1. Përfshirja në programim sipas rastit;

2. Progresi i bërë në zbatimin e programit të CBC/BNK dhe, veçanërisht, në arritjen e objektivave specifike për prioritetet tematike (duke përfshirë elementet cilësore dhe sasiore që tregojnë progresin në lidhje me objektivat);

3. Një përmbledhje e problemeve të hasura në zbatimin e programit të BNK-së dhe të gjitha masat korrigjuese të marra, si dhe rekomandimet për masa të mëtejshme korrigjuese;

4. Monitorimi, duke përfshirë marrëveshjet për mbledhjen e të dhënave, kur është e zbatueshme, aktivitetet e vlerësimit;

5. Aktivitetet e komunikimit dhe të vizibilitetit;

6. Koordinimi me vendin partner;

Në menaxhimin e tërthortë duhet të përfshihet edhe informacioni i mëposhtëm:

1. Strukturat operuese në funksionim dhe ndryshimet që lidhen me to, nëse është e rëndësishme;

2. Çdo problem i rëndësishëm i hasur në zbatimin e detyrave të besuara, p.sh., vonesat në kontraktim dhe masat vijuese të marra/të planifikuara.

3. Rekomandimet për veprime të mëtejshme;

4. Auditimet e zbatuara – konstatimet kryesore dhe rekomandime dhe masat korrigjuese të marra.

II a. Treguesit e performancës në [p.sh., transport] sektorin që mbulon menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë:

³⁴ Sipas sektorëve në dokumentet strategjike indikative.

³⁵ Për bashkëpunimin ndërkufitar kërkohet raportim specifik.

Treguesit³⁶ për program

Marrëveshja e Financimit/referenca ³⁷ e programit	Treguesi për sektor [transport]	Burimi	Pikënisja	Arritjet e rëndësishme (2017)	Objektivi (2020)	Vlera (2014 ³⁸)
Programi i vendit 2014	<i>Shkurtimi i kohës mesatare të udhëtimit të pasagjerëve ndërmjet qendrave të mëdha urbane me anë të mjetit të transportit</i>					
Programi shumëvjeçar 2014–20xx	<i>Kosto të reduktuara transporti për njësi prodhimi</i>					

II b. Përmbledhje e nivelit të aksionit për sektor [p.sh., Transport]

Marrëveshja e Financimit/ referenca e programit	Aksioni	Gjendja aktuale/progresi për aksion të veçantë (p.sh., termat e referencës në përgatitje, tenderi i nisur, kontraktuar, në zbatim, i përfunduar)	Arritjet kryesore dhe vlerësimi i tyre	Probleme të rëndësishme të hasura në zbatimin e detyrave të besuara dhe masat e marra/të planifikuara për kapërcimin e tyre	Zhvillimet që ndikojnë në procesin e zbatimit në të ardhmen	Rekomandime për masa të mëtejshme korrigjuese
[Programi i vendit 2014]	<i>Elektrifikimi i linjës bekurudhore nga xxx në kufirin me xxx</i>	<i>P.sh., kontratë shërbimi për përgatitjen e termave të referencës për kontratën e punimeve të nënshkruar dhe në zbatim, tender për kontratën e punimeve që do të fillojnë në tremujorin e dytë të vitit 2015</i>		<i>P.sh., kontratë shërbimi për përgatitjen e termave të referencës, sepse kontrata e punimeve u vonua ndërsa procedura e negocimit dështoi dhe duhej të rifillohej</i>	<i>P.sh., ndryshimi i së drejtës vendëse, si dhe qasja me zbatimin e paketës së katërt të bekurudhave</i>	

Në menaxhimin e tërthortë duhet të parashikohen edhe shtojcat e mëposhtme:

Shtojcë 1

Përmbledhje e funksionimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit (duke përfshirë ndryshimet në strukturën institucionale) (maks. një faqe).

Transparenca, vizibiliteti, aktivitetet e informimit dhe komunikimit, në përputhje me MK (marrëveshja kuadër, maks. një faqe).

Shtojcë 2

Histori suksesi (Shënim. kjo pjesë mund të përdoret për raportin vjetor të asistencës financiare të përgatitur nga Komisioni Evropian.)

Shtojcë 3

Plani vjetor i prokurimit.

Për menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë duhet të parashikohen edhe shtojcat e mëposhtme:

Shtojcë 4

Udhëzuesi për qasjen e sektorit – arritjet (duke theksuar nëse janë përmbushur apo jo objektivat e planifikuar).

³⁶ Këto duhet të jenë kryesisht rezultate, si dhe tregues të prodhimit përkatës të përzgjedhur.

³⁷ Duhet të jetë në përputhje me mënyrën e raportimit (vjetor, shumëvjeçar ose pa angazhime të ndara) dhe me raportin e ZKA-së.

³⁸ Numri i kolonave të përshtatet për të gjitha vitet nga 2014 deri në vitin e periudhës së raportimit. Vlerat duhet të jenë kumulative.

Raportul financiar i përfutuesit IPA III ("")

Referencia e Programi	Bachelori i Programi			Specializime të reja të masterit										Korsetat i Shkencave			Referencat Shkencë të EDE			Shkencat e përbashkëta
	Shkencat e Përbashkëta e Masterit	Shkencat e Përbashkëta e Cilësive të Masterit	Shkencat e Përbashkëta e Cilësive të Masterit	Shkencat e Përbashkëta e Cilësive të Masterit	Shkencat e Përbashkëta e Cilësive të Masterit	Shkencat e Përbashkëta e Cilësive të Masterit	Shkencat e Përbashkëta e Cilësive të Masterit	Shkencat e Përbashkëta e Cilësive të Masterit	Shkencat e Përbashkëta e Cilësive të Masterit	Shkencat e Përbashkëta e Cilësive të Masterit	Shkencat e Përbashkëta e Cilësive të Masterit	Shkencat e Përbashkëta e Cilësive të Masterit	Shkencat e Përbashkëta e Cilësive të Masterit	Shkencat e Përbashkëta e Cilësive të Masterit	Shkencat e Përbashkëta e Cilësive të Masterit	Shkencat e Përbashkëta e Cilësive të Masterit	Shkencat e Përbashkëta e Cilësive të Masterit			
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19		
2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20		
3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21		
4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22		
5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23		
6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24		
7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25		
8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26		
9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27		
10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28		
11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29		
12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30		
13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31		
14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32		
15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33		
16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34		
17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35		
18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36		
19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37		
20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38		
21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39		
22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40		
23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	3										

0.15 absorb

Abdullah F. Fikri
Minister of Education and Science
Ministry of Education and Science
Republic of Albania

Shadrin / Péterfői Zsolt, Ministre des Écoles, Republika e Shqipërisë
Service des Trésoriers Officiels du Ministère de la Justice de la République d'Albanie
Boudieri / Adams, Ministre de Justice, Official Translation Service

SHTOJCË IV (b)
RAPORTI VJETOR FINANCIAR - KONTRIBUTET E BE-së PËR PROGRAME TË VEÇANTA
Raporti financiar i përfituesit IPA II (*)

Referenca e programit	Numri i kontratës së marrëveshjes së financimit	Buxheti i programit kontribut i BE-së	Veprimtaritë vendore të kontratës								
			Shuma e përgjithshme e kontraktuar	Shuma e kontraktuar	% e çlirimit	Shuma e përgjithshme e disbursuar	% e disbursimit	Kostot e përgjithshme të përcaktuara	% e kostove	Totali i para-financimeve të hapura	% e para-financimeve
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
NP2010	2010/123-456			4/3*100 %	6/4*100 %		8/4*100 %		10/4*100 %		12/4*100%
Nën-programi											
Veprimi											

(*) 15 shkurt

SHTOJCË IV (c)
RAPORTI VJETOR FINANCIAR - KONTRIBUTET E BE-SË TË THJESHITUARA KONSOLIDUARA

Raporti financiar i përfituesit IPA II (*)

Referenca e programit	Numri i kontratës së Marrëveshjes së Financimit	Buxheti i programit kontribut i BE-së	Veprimtaritë vendore të kontratës					Balancat Bankare
			Shuma e përgjithshme e kontraktuar	Shuma e përgjithshme e çliruar pas përfundimit	Shuma e përgjithshme e disbursuar	Kostot e përgjithshme të përcaktuara	Totali i para-financimeve të hapura	Gjithsej
1	2	3	4	5	6	7	8	9
NP2010	2010/123-456							

SHTOJCË IV (d)
PARASHIKIMI I PAGESAVE

Referenca e programit	Parashikimet e planifikuara të disbursimeve (shtoni vite sipas nevojës)														
	Parashikimi i disbursimeve mujore (viti 1)												Gjithsej Viti 1	Viti 2	Viti 3
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12			
NP2010													0		
CBC AA/BB 2010													0		

SHTOJCË V E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT

Specifikimet minimale të sistemit të kontabilitetit rritës

Sistemi i kontabilitetit të përfituesit IPA II duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

1. Të pasqyrojë strukturën organizative të vënë në funksion për sistemet e kontrollit të brendshëm të përshtatura për kryerjen e detyrave. Në veçanti, para autorizimit të një operacioni, të gjitha aspektet (si ato operationale dhe financiare) e operacionit duhet të verifikohen nga anëtarë të personelit dhe jo nga personi që ka filluar operacionin. Personi që merret me procesin e verifikimit nuk mund të jetë nën varësinë e iniciuesit të transaksionit.

2. Të përfshijë gjurmën e auditimit për të gjitha transaksionet dhe ndryshimet (amendimet).

3. Të ketë sigurinë e duhur fizike dhe elektronike, duke përfshirë sistemet mbështetëse dhe ato të rikuperimit.

4. Sistemi i kontabilitetit duhet të mbajë të paktën informacionet e mëposhtme për kontratat lokale të menaxhuara sipas secilit program:

- a) referenca e kontratës;
- b) vlera e kontratës, duke përfshirë çdo ndryshim;
- c) datat e nënshkrimit të kontratës (nga të dyja palët);
- d) data për fillimin e zbatimit të kontratës;

Kjo datë jepet përveç datës së nënshkrimit të kontratës dhe mund të ndryshojë prej saj, si në rastin kur data për fillimin e punimeve të kontratës jepet pas nënshkrimit të kontratës me anë të një urdhri administrativ.

- e) data për përfundimin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë çdo ndryshim.

Kjo është data e fundit në të cilën mund të krijohen kosto të pranueshme. Kjo datë nuk përfshin asnjë periudhë garancie apo kohën e lejuar për përgatitjen e raportit nga kontraktuesi.

- f) totali i paguar (me para në dorë) me kontratë;
- g) parafinancimi i paguar me kontratë;

Njohja e shprehur dhe regjistrimi në pasqyrën financiare të parafinancimit të kërkuar me kontratë.

- h) kostot e pranuar – të drejtpërdrejta (me kontratë);

Njohja e qartë e kostos si pagesë e shpenzimeve të vitit. Disa pagesa do të mbulojnë drejtpërdrejt shpenzimet që janë bërë. Nuk përfshihet parafinancimi. Pagesat mund të jenë përfundimtare kur parafinancimi është shlyer ose mund të jenë pagesa të përkohshme kur parafinancimi është shlyer ose kur kontrata nuk përfshin dispozitën e parafinancimit.

- i) kostot e pranuar – indirekte (me kontratë);

Njohja eksplicite e kostos si pagesë e shpenzimeve të vitit. Disa fatura apo pasqyra shpenzimesh të paraqitura nga kontraktuesi apo përfituesi i grantit do të kenë lidhje me kostot që janë mbuluar nga parafinancimi i paguar më parë gjatë periudhës së zbatimit të kontratës apo marrëveshjes së grantit. Në këto raste pagesa e bërë do të jetë më e vogël se kostoja e raportuar. Ajo mund të jetë edhe zero, nëse e gjithë kostoja mbulohet nga parafinancimi, (me siguri ajo do të jetë zero nëse kostot e raportuara janë të pamjaftueshme për të absorbuar parafinancimin dhe për bilancin e pashfrytëzuar të parafinancimit nxirret një urdhër rikuperimi). Në të gjitha këto raste sistemi duhet të regjistrojë vlerën e plotë të kostos së pranueshme të raportuar si shpenzime për vitin dhe të reduktojë bilancin e parafinancimit nga shuma e kostos së kompensuar kundrejt parafinancimit kur përcakton shumën që do të paguhet;

- j) urdhra rikuperimi për të reduktuar parafinancimin (sipas kontratës);

Pranimi i reduktimit të parafinancimit në pasqyrën financiare pas rikuperimit të parafinancimit të pashfrytëzuar;

- k) urdhra rikuperimi për të reduktuar koston (me kontratë);

Kur një rikuperim është bërë kundrejt kostos që është pranuar më parë – mundësisht pas një hetimi për mashtrim. Në raste të tilla, kostot e regjistruara për vitin duhet të ulen nëse kostoja është pranuar në të njëjtin vit si rikuperim pasues; ose të ardhurat duhet të regjistrohen kur kostoja është pranuar në një vit më herët se ato të rikuperimit;

l) data e faturës së furnizuesit për çdo faturë apo dokument tjetër të shoqëruar me një raport financiar që mundësojnë kostot e pranuar;

m) të dhëna në kontekstin e rikuperimit për kostot e papranueshme dhe rikuperimet.

SHTOJCË
E VENDIMIT ZBATUES TË KOMISIONIT
QË MIRATON PROGRAMIN VJETOR TË VEPRIMIT PËR SHQIPËRINË PËR VITIN 2018

Programi Vjetor i Punës
Ky dokument përbën programin vjetor të punës në kuptimin e nenit 110, pika 2 e rregullores financiare (rregullore [BE, Euratom] 2018/1046 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 18 korrik 2018 për rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të BE-së)

1. IDENTIFIKIMI

Përfutuesi	Shqipëria
Akti bazë	Rregullorja (BE) nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11 mars 2014, për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)
Referencat e angazhimeve CRIS/ABAC	2018/040-211 objektivi 1
Kostoja totale	65 613 671 EURO
Kontributi i BE-së	64 000 000 EURO
Linja e buxhetit	22.02.01.01
Referencat e angazhimeve CRIS/ABAC	2018/040-215 objektivi 2
Kostoja totale	86 800 000 EURO
Kontributi i BE-së	30 100 100 EUR
Linja e buxhetit	22.02.01.02
Kostoja totale e programit	152 413 671 EURO
Kontributi i BE-së për programin	94 100 000 EURO
Metodat e zbatimit	<i>Veprimi 1: Mbështetja e BE-së për pjesëmarrjen në programet dhe agjencitë e BE-së</i>
	Menaxhim indirekt me Shqipërinë
	<i>Veprimi 2: BE-ja për shtetin e së drejtës – lufta kundër krimit të organizuar dhe drogës</i>
	Menaxhim direkt i Komisionit Evropian për aktivitetet:
	1.4 Forcimi i kapaciteteve kombëtare për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe rendin publik duke ngritur trajnim të institucionalizuar për Policinë e Shtetit, Akademinë e Sigurisë dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese.
	3.1 Mbështetje për zhvillimin dhe zbatimin e alternativave ekonomike rentabël ndaj kultivimit dhe tregimit të kanabisit, me fokus te femrat dhe meshkujt e rinj.
	3.2 Mbështetje për forcimin e aksesit të femrave dhe meshkujve të rinj në shërbime cilësore shëndetësore, sociale dhe arsimore.
	3.3 Mbështetje për forcimin e kapaciteteve të bashkive në lidhje me organizimin dhe menaxhimin e shërbimeve.
	4.1 Mbështetje për zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse në mbledhjen e të dhënave për përdorimin e drogës dhe për vendimmarrjen dhe politikëbërjen bazuar në evidenca, duke përdorur modele dhe standarde të krijuara dhe të promovuara nga Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësinë nga Droga (EMCDDA).
	Menaxhim indirekt nga subjektet e ngarkuara si më poshtë:
	Organ publik i shtetit anëtar të BE-së për aktivitetet.
	1.1 Forcimi kapaciteteve menaxhuese të prokurorisë për hetim efektiv të krimit të organizuar.
	1.2 Mbështetje për luftë efektive kundër krimit të organizuar me metoda speciale hetimi dhe analize mjekoligjore.
	1.3 Forcimi kapaciteteve dhe këshillim për hetime kryesisht bazuar në inteligjencë, me të gjitha dimensionet ekonomike të përfshira si hetimet financiare dhe konfiskimet.

	Menaxhim indirekt nga Agjencia Evropiane e Kufirit dhe Rojës Bregdetare (EBCGA)
	1.2 Forcim kapacitetesh për menaxhimin efektiv të kufirit të gjelbër, kufirit blu dhe kufirit ajror.
	<i>Veprimi 3: BE-ja për reformën në drejtësi</i>
	Menaxhim direkt nga Komisioni Evropian
	<i>Veprimi 4: BE-ja për mjedis më të pastër – mbështetje për trajtimin e ujërave të ndotura</i>
	Menaxhim indirekt nga subjekti i ngarkuar: <i>Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW)</i>
	<i>Veprimi 5: BE-ja për zhvillim ekonomik – zhvillimi ekonomik vendor i orientuar drejt turizmit me fokus të trashëgimia kulturore:</i>
	Menaxhim indirekt nga subjekti i ngarkuar: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)
Afati për lidhjen e marrëveshjeve të financimit me Përfituesin e IPA II	Jo më vonë se 31 dhjetor 2019
Afati për kontraktimin, përfshirë lidhjen e marrëveshjeve të kontributit/delegimit	3 vjet nga data e lidhjes së Marrëveshjes së Financimit
Periudha treguese e zbatimit	6 vjet nga data e lidhjes së Marrëveshjes së Financimit
Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit (data kur ky program duhet të përfundojë dhe të mbyllet)	12 vjet nga data e lidhjes së Marrëveshjes së Financimit

2. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË MASAVE

2.1 SEKTORËT E PËRZGJEDHUR NË KËTË PROGRAM MASASH

Arsyeja e përzgjedhjes së sektorëve specifikë për këtë program:

Dokumenti Strategjik Indikativ për Shqipërinë (2014–2020) përcakton se asistencë e paraanëtarësimit për periudhën 2014–2020 do të fokusohet te: demokracia dhe qeverisja, shteti i së drejtës dhe qeverisja ekonomike, konkurrueshmëria dhe rritja.

Shqipëria do të përfitojë nga pjesëmarrja e saj në një sërë **programesh të BE-së**.

Programi IPA 2018 parashikon dy masa në sektorin shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore. Objektivat e tyre janë krijimi i një sistemi ligjzbatues efikas dhe efektiv, që është i aftë të prodhojë një historik të besueshëm arritjesh në luftën kundër krimit të organizuar dhe të mbështetë krijimin e një sistemi drejtësie llogaridhënës, të pavarur dhe efikas, harmonizuar me legjislacionin e BE-së dhe praktikën më të mira të saj. Masa **“BE-ja për shtetin e së drejtës – lufta kundër krimit të organizuar dhe drogës”** do të kontribuojë për një sistem ligjzbatues efektiv dhe efikas për të luftuar kundër krimit të organizuar dhe trafikut të drogës dhe do të mbështetë zhvillimin social dhe ekonomik në komunitetet e prekura. Masa synon të përmirësojë kapacitetet e Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve përkatëse që luftojnë krimin e organizuar, përfshirë trafikun e drogës dhe kultivimin e kanabisit, si edhe të përmirësojë kapacitetet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bashkë me Institutin e Shëndetit Publik që të analizojnë përdorimin e drogave. Gjithashtu, masa do të mbështetë bashkitë e përzgjedhura që të ofrojnë shërbime dhe mënyra jetese alternative për komunitetet e cenuara ndaj kultivimit dhe trafikut të kanabisit.

Masa **“BE-ja për reformën në drejtësi”** synon të kontribuojë në forcimin e shtetit të së drejtës, ligjzbatimin dhe të ulë korrupsionin në institucionet qeveritare dhe në gjyqësor. Masa do të kontribuojë në forcimin e pavarësisë, transparencës, efikasitetit, llogaridhënies dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë në Shqipëri në përputhje me standardet evropiane, si edhe do rritë mbrojtjen e të drejtave të njeriut në sistemin (penitenciar) e vuajtjes së dënimit.

Masa mbështet zbatimin e Strategjisë në sektorin e drejtësisë, që synon të përmirësojë kuadrin institucional dhe funksionimin efikas të sistemit gjyqësor, të konsolidojë edukimin ligjor dhe të përmirësojë specializimin e magjistratëve dhe administratës gjyqësore. Gjithashtu, synon të rritë efikasitetin e sistemit të drejtësisë penale dhe masave kundër korrupsionit; përmirësimin e sistemit të drejtësisë duke përdorur procedura të modernizuara, sisteme të TI-së dhe pajisjeve e mjete elektronike

për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Masa do të forcojë edhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në sistemin e vuajtjes së dënimit dhe do të përmirësojë cilësinë e shërbimit të ofruar nga profesionistët e ligjit.

Masa **“BE-ja për mjedis më të pastër”** do të japë mbështetje për trajtimin e ujërave të ndotura dhe është vijimësi e masës së IPA 2016, për menaxhimin e integruar të ujërave dhe shërbimet e trajtimit të ujërave të ndotura. Masa synon të përmirësojë cilësinë e ujit dhe kështu të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social, mjedisor dhe territorial dhe do ta bëjë vendin më tërheqës për turizëm. Masa ndjek kërkesën e dokumentit strategjik tregues për të mbështetur zhvillimin ekonomik, social dhe territorial, si dhe të përmirësojë aftësinë e përfituesve që të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në BE, duke mbështetur harmonizimin progresiv me *acquis* të BE-së. Kjo masë kontribuon edhe në arritjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim lidhur me Ujin për njerëzit.

Një tjetër prioritet i dokumentit strategjik tregues është forcimi i konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare. Për këtë qëllim, Programi Vjetor i Veprimit 2018 do të mbështetë zhvillimin e ekonomisë vendore. Masa **“BE-ja për zhvillimin ekonomik – zhvillim ekonomik i orientuar drejt turizmit me fokus te trashëgimia kulturore”** ka për qëllim të rritë kontributin e turizmit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm në rritjen ekonomike të Shqipërisë, duke rigjeneruar kështu bazën e ekonomisë vendore dhe mjedisin urban. Masa do të zbatojë një modeli zhvillimi ekonomik të udhëhequr nga turizmi me fokus te një vend trashëgimie kulturore dhe/ose natyrore.

- Vështtrim i masave të shkuara dhe të tanishme të BE-së, donatorëve të tjerë dhe/ose përfituesve të IPA II në sektorët përkatës”.

BE-ja i ka dhënë Shqipërisë mbështetje të konsiderueshme në fushat e **demokracisë dhe qeverisjes**, shtetit të së drejtës dhe të drejtave thelbësore, mjedisit, konkurrueshmërisë; pothuaj gjysma e buxhetit kombëtar nga IPA II është alokuar në mbështetje të këtyre sektorëve në përputhje me parimet e IPA II, që fokusohet fillimisht në elementet bazë. Siç theksohet në Dokumentin Strategjik Tregues për Shqipërinë 2014–2020³⁹, mësimet e rëndësishme të nxjerra nga IPA I (2007–2013), janë: a) forcimi i kapaciteteve dhe investimet kërkojnë një nivel minimal të burimeve njerëzore në kuptimin e aftësisë dhe shifrave; b) autorësia (zotërimi) për investimet e financuara prej BE-së vihet në rrezik, nëse nuk lidhen me strategjitë sektoriale dhe buxhetet e ministrive përgjegjëse, si edhe me nevojën për vlerësim të kujdesshëm të *due diligence* institucionale.

Për **shtetin e së drejtës**, asistenca e mëparshme e IPA-s është fokusuar në reformat institucionale kryesore dhe forcimi i kapaciteteve për aktorët e ndryshëm të gjyqësorit, së pari përmes asistencës për modernizimin e sistemit të drejtësisë. Një numër projektesh infrastrukturore kanë rritur kapacitetet e gjyqësorit dhe sistemit të vuajtjes së dënimit që të përmbushin standardet ndërkombëtare. Vlerësimi i mbështetjes së mëparshme evidentoi se një sërë asistencash kanë një historik arritjesh të suksesshme në sektorë, por ndikimi i tyre frenohet nga dobësitë sistematike, që do të merrnin hov të madh sapo reforma në drejtësi të heqë pengesat strukturore ekzistuese e cila mbështetet nga masa. Ekziston nevoja për një strukturë efektive bashkërendimi sektorial për politikat dhe aktivitetet e projekteve, burime njerëzore të përshtatshme dhe kapacitete financiare për mirëmbajtjen dhe ndjekjen (vijimësinë).

Për **konkurrueshmërinë**, projektet e financuara nga BE-ja kanë pasur si qëllim kryesor përmirësimin e kushteve të punës dhe jetesës të banorëve në zonat e përzgjedhura, rrijetëzimi i rajoneve, diversifikimi i ekonomisë dhe shtimi i aktiviteteve historike rreth atyre vendeve historike. Projektet synonin rehabilitimin dhe rinovimin e shërbimeve infrastrukturore ekzistuese dhe rrugëve për të përmirësuar aksesin në ato zona. Qasja e re e integruar përfshin lidhjen e objekteve turistike, transportit, shërbimeve mjedisore dhe mundësive kulturore me menaxhimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Vlerësimet e asistencës IPA 2007–2013, nënvizuan nevojën për tregues më të mirë dhe harmonizimin me prioritetet kombëtare. Kjo masë është në të njëjtën linjë me dokumentet strategjike kryesore, sepse e njeh turizmin si sektor parësor dhe po hartohet strategjia e turizmit, mungesa e së cilës rezultoi në ndërhyrje të copëtuara dhe jo të bashkërenduara.

Për sektorin e **mjedisit**, mbështetja e mëparshme përfshinte asistencë teknike të ndryshme, pajisje dhe investime, me qëllim që Shqipëria të vihej në linjë me kuadrin rregullator gjithëpërfshirës dhe të ndërlikuar të BE-së për mjedisin dhe ujin, si edhe të përmirësonte hartimin e politikave. Asistencë përfshinte një sërë projektesh infrastrukturore për ndërtimin e impianteve të grumbullimit dhe trajtimit

³⁹ Dokumenti Strategjik Tregues për Shqipërinë (2014–2020), faqe 20.

të ujërave të ndotura përgjatë brigjeve të Jonit dhe të Adriatikut, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujërave bregdetare. Mbështetja për planifikimin dhe performancën operationale do të përshtatet sipas fushave prioritare që kërkojnë investime, si edhe do të konsolidojë (bazohet në) aktivitetet dhe rezultatet e IPA 2016, duke garantuar që mbështetja të jetë plotësuese dhe jo e mbivendosur. Vlerësimi i ndërhyrjeve të mëhershme në sektorin e ujit tregon se projektet ishin në një linjë me objektivat sektoriale të përcaktuar në strategjitë përkatëse të BE-së (d.m.th., Dokumenti Strategjik Tregues, 2014–2020) dhe pati rezultate pozitive në mbarë sektorin. Problematikat kyçe që duhen pasur parasysh në këtë sektor ishin kapacitetet e burimeve njerëzore, monitorimi i cilësisë së ujit, zbatimi i qasjes së baseneve lumore të direktivës kuadër të BE-së për ujin, planifikimi strategjik dhe programimi i infrastrukturës ujore me prioritetizim solid investimesh dhe metodologjia e përzgjedhjes së projekteve, përmirësimi i kapaciteteve inxhinierike dhe shqyrtimit të planprojekteve gjatë procesit të miratimit të projektit.

Lista e veprimeve të parashikuara në sektorët/prioritetet e përzgjedhura

Sektori: Demokracia dhe qeverisja

MENAXHIM INDIREKT ME SHQIPËRINË (EUR)		MËNYRA TË TJERA ZBATIMI (EUR)	
<i>Veprimi 1:</i> Mbështetje e BE-së për pjesëmarrjen në programet dhe agjencitë e BE-së	3 000 000	NA	NA
TOTALI	3 000 000	TOTALI	NA

Sektori: Shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore

MENAXHIM INDIREKT ME SHQIPËRINË (EUR)		MËNYRA TË TJERA ZBATIMI (EUR)	
NA	NA	<i>Veprimi 2:</i> BE-ja për shtetin e së drejtës – lufta kundër krimit të organizuar dhe drogës	19 000 000
		<i>Veprimi 3:</i> BE-ja për reformën në drejtësi	42 000 000
TOTALI	NA	TOTALI	61 000 000

Sektori: Masat për mjedisin dhe klimën

MENAXHIM INDIREKT ME SHQIPËRINË (EUR)		MËNYRA TË TJERA ZBATIMI (EUR)	
NA	NA	<i>Veprimi 4:</i> BE-ja për mjedis më të pastër – mbështetje për trajtimin e ujërave të ndotura	24 100 000
TOTALI	NA	TOTALI	24 100 000

Sektori: Konkurrueshmëria dhe novacioni

MENAXHIM INDIREKT ME SHQIPËRINË (EUR)		MËNYRA TË TJERA ZBATIMI (EUR)	
NA	NA	<i>Veprimi 5:</i> BE-ja për zhvillim ekonomik – zhvillimi ekonomik vendor i orientuar drejt turizmit me fokus te trashëgimia kulturore:	6 000 000
TOTALI	NA	TOTALI	6 000 000

2.2 PËRSHKRIMI DHE ZBATIMI I MASAVE

Asistenca e parashikuar për Programin Vjetor të Veprimit për Shqipërinë për vitin 2018 gjykohej se do të ndjekë kushtet dhe procedurat e përcaktuara në masat shtrënguese të miratuara në zbatim të Traktatit Themelues të Bashkimit Evropian⁴⁰.

SEKTORI	DEMOKRACIA DHE QEVERISJA	3 000 000 EUR
<i>Veprimi 1</i>	Mbështetje e BE-së për pjesëmarrjen në programet dhe Menaxhim indirekt me Shqipërinë	1 000 000 EUR

⁴⁰ https://ec.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage_en/8442/Consolidated%20list%20of%20sanctions

1. Përshkrimi i masës, objektivit, rezultateve të pritshme dhe treguesve kyç të performancës

Përshkrimi i masës dhe objektivave

Objekti i këtij veprimi është pjesëmarrja e Shqipërisë në Programet e BE-së duke bashkëfinancuar koston e biletës së hyrjes/tarifave të pjesëmarrjes që paguhet në programe, si: Evropa Krijuese, Punësimi dhe Novacioni Social, Evropa për Qytetarët, *Fiscalis* 2020 etj. Masa do të mbështesë edhe pjesëmarrjen e Shqipërisë me status vëzhguesi në Agjencinë për të Drejtat Themelore.

	Emërtimi i programit të BE-së	Institucione të përfshira në pjesëmarrje
1	Doganat 2020	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
2	<i>Fiscalis</i> 2020	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
3	Programi për Punësimin dhe Novacionin Social (EaSI)	Ministria e Financave dhe Ekonomisë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
4	Erasmus+	Ministria e Arsimit dhe Sportit
5	COSME	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
6.1	Evropa Krijuese – nënprogrami Kultura	Ministria e Kulturës
6.2	Evropa Krijuese – nënprogrami Media	Ministria e Kulturës
7	Evropa për Qytetarët	Ministria e Kulturës Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
8	Horizont 2020	Ministria e Mjedisit dhe Turizmit Ministria e Arsimit dhe Sporteve Ministria e Financave dhe Ekonomisë
9	Drejtësia	Ministria e Drejtësisë
10	Agjencia e BE-së për të drejtat themelore	Ministria e Drejtësisë

- Rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i aktiviteteve, janë:

1. Pjesëmarrja më e madhe e institucioneve shqiptare në programet dhe agjencitë e BE-së, përfshirë rritjen e shkëmbimeve me shtetet anëtare të BE-së.

2. Rritje e autorësisë dhe përgjegjësisë së institucioneve shqiptare (përfshirë në kuptimin financiar, d.m.th. pagimi i pjesshëm i biletës së hyrjes) për pjesëmarrjen në programet dhe agjencitë e BE-së.

3. Forcimi i kapaciteteve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe institucioneve të tjera shtetërore që të bashkërendojnë pjesëmarrjen në programet e BE-së.

4. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve përfituese shqiptare që të aplikojnë dhe të marrin pjesë me sukses në programet e BE-së.

5. Forcimi i kapaciteteve të Shqipërisë që të bëhet shtet programi në Erasmus+.

Treguesit kryesorë të performancës, janë: i. numri i programeve për të cilat është lidhur një marrëveshje ndërkombëtare; ii. numri total i aplikimeve; 3) numri i aplikimeve të suksesshme.

2. Supozime dhe kushte

Nga qeveria shqiptare pritet të nënshkruajë marrëveshjen e anëtarësimit për secilin Program/ Agjenci të BE-së në kohën e duhur dhe të alokojë në buxhetin vjetor shumat e nevojshme për financimin e koston vjetore të pjesëmarrjes (biletës së hyrjes). Qeveria shqiptare duhet jo vetëm të japë bashkëfinancimin, por edhe fondet e nevojshme për pagimin e biletës së hyrjes të plotë, para se të marrë rimbursimin e pjesshëm nga IPA II. Mosrespektimi i kërkesave më lart mund të çojë në rikuperimin e fondeve nën këtë program dhe/ose rialokimin e financimeve në të ardhmen.

3. Mënyrat e zbatimit

Zbatimi do të konsistojë në pagimin e pjesës së IPA-së të kontributit financiar për programet nga Fondi Kombëtar.

4. Objekti i kriterit gjeografik për prokurimet dhe grantet

N.A.

SEKTORI	SHTETI I SË DREJTËS DHE TË DREJTAT THEMELORE	61 000 000 EUR
	Menaxhim direkt	7 500 000 EUR
	Menaxhim indirekt me Agjencinë Evropiane të Kufirit dhe Rojës Bregdetare (EBCGA)	6 000 000 EUR
Veprimi 2	BE-ja për shtetin e së drejtës – lufta kundër krimit të organizuar dhe	

	drogës	Menaxhim indirekt me organ publik të një Shteti Anëtar të BE-së	5 500 000 EUR
		TOTAL	19 000 000 EUR

1. Përshkrimi i masës, objektivit, rezultateve të pritshme dhe treguesve kyç të performancës **Përshkrimi i veprimit dhe objektivave**

Objekti i përgjithshëm i kësaj mase është të kontribuojë në një sistem ligjzbatues efikas dhe efektiv që të luftojë krimin e organizuar dhe trafikun e drogës dhe të mbështetë zhvillimin social dhe ekonomik në komunitetet e prekura.

Objektivat e veçantë, janë: i. përmirësimi i kapaciteteve të Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë së Përgjithshme dhe agjencive përgjegjëse që merren me luftën kundër krimit të organizuar përfshirë trafikun e drogës dhe kultivimin e kanabisit; ii. përmirësimi i kapaciteteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të Institutit të Shëndetit Publik në analizimin e përdorimit të drogave. Masa do të mbështetë bashkitë e përzgjedhura në ofrimin e shërbimeve dhe mënyrave alternative të jetesës për komunitetet e cenuara ndaj kultivimit dhe trafikut të kanabisit.

- Rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

1. Kapacitete të përmirësuara në kryerjen e hetimeve penale shoqëruar me hetime financiare për luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikut të drogës bazuar në metoda hetimi bazuar në inteligjencë dhe proaktive.

2. Kapacitete të përmirësuara për kontrollin e kufirit, me fokus luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikut ndërkufitar të drogës.

3. Akses i përmirësuar në zhvillimin social dhe ekonomik rural dhe në mundësitë për punësim, shërbimet dhe lehtësirat për komunitetet e cenuara përkundrejt kultivimit dhe trafikut të kanabisit;

4. Monitorim i përmirësuar i statistikave për drogën.

Treguesit kyç të performancës:

- numri i hetimeve të kryera duke përdorur mjete TI dhe të tjera që futen për herë të parë për kryerjen e hetimeve kryesisht bazuar në inteligjencë kundër krimit të organizuar dhe trafikut të drogës;

- numri i hetimeve financiare të mbështetura.

Numri pajisjeve shtesë në dispozicion të policisë kufitare për diktimin e krimit të organizuar ndërkufitar;

- numri i efektivëve të policisë kufitare të trajnuar për bashkëpunimin rajonal dhe metodat e luftës kundër krimit të organizuar ndërkufitar;

- numri i individëve (sipas gjinisë gra/burra) që kanë përfutur nga shërbimet;

- numri i Raportit Vjetor për Drogën publikuar në përputhje me udhëzimet e Qendrës Evropiane të Monitorimit për Drogat dhe Varësinë nga Droga.

2. Supozimet dhe kushtet

Supozimet për këtë masë, janë: i. mbetet në të njëjtin nivel stabiliteti politik dhe ekonomik i Shqipërisë dhe rajonit; ii. është ruajtur zbatimi adekuat i politikave për bashkëpunimin rajonal, azilin dhe migrimin në rajon; iii. personeli përkatës vazhdon të punojë në sektor dhe përdor rregullisht mjetet e reja të TI-së, instrumentet, njohuritë dhe aftësitë në punën e përditshme; iv. bashkëpunimi dhe bashkërendimi efektiv ndërmjet të gjitha institucioneve përgjegjëse në Shqipëri.

Kushtet e masës përfshijnë si më poshtë:

i. grupi i punës sektorial ku përfshihen të gjitha institucionet përgjegjëse, i cili mbështetet nga kjo masë, të ngrihet dhe të funksionojë; ii. institucionet që përfitojnë asistencën të sigurojnë burime njerëzore dhe buxhet të përshtatshëm për zbatimin dhe ndjekjen e asistencës, përfshi edhe kushtin që Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet e tjera të sektorit të kenë në buxhetin vjetor të tyre fonde për mirëmbajtjen dhe përdorimin e të gjitha investimeve të financuara prej BE-së; iv. bashkitë e përzgjedhura të garantojnë mirëmbajtjen dhe funksionimin e të gjitha qendrave komunitare dhe të mbulojnë ofrimin e asistencës edhe pas përfundimit të Masës. Mosrespektimi i kërkesave më lart mund të çojë në rikuperimin e fondeve nën këtë program dhe/ose rialokimin e financimeve në të ardhmen.

3. Mënyrat e zbatimit

3. a) Menaxhim indirekt me organizatën e një shteti anëtar dhe agjencinë e BE-së të specializuar për aktivitetet 1.1, 1.2, 1.3 dhe 2.1.

Për aktivitetet 1.1, 1.2, 1.3, subjekti ende nuk është identifikuar. Një pjesë e kësaj mase mund të zbatohet me menaxhim indirekt me një subjekt që përzgjidhet prej Komisionit bazuar në kriteret më poshtë:

Kriteret e përzgjedhjes, janë: i. mandati i subjektit; ii. përvoja dhe vlera e shtuar e subjektit veçanërisht në kontekstin e Bashkimit Evropian dhe në Shqipëri; iii. ekspertiza teknike, kapacitete logjistike dhe menaxhuese të subjektit potencial, përfshirë edhe në nivel vendor; iv. ndikimi, rezultatet, potenciali i bashkëpunimit me subjektet/donatorët e tjerë, duke marrë parasysh efektivitetin e detyrave të ngarkuara, përfshirë edhe në Shqipëri; v. kosto të reduktuara transaksionesh; iv. vlerësimi i shtyllës.

Zbatimi nga ana e këtij subjekti nënkupton që organi publik i shtetit anëtar të BE-së do të jetë përgjegjës për kryerjen e të gjitha detyrave që lidhen me zbatimin, përfshirë detyrat e ekzekutimit të buxhetit. Në veçanti, subjekti i ngarkuar mban përgjegjësinë për menaxhimin e thirrjeve për tender, thirrjeve për propozime, kontraktimin, zbatimin, administrimin e pagesave, informimin dhe vizibilitetin, monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve të IPA II, si edhe vlerësimin e tyre kurdo që është e nevojshme, në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe garanton ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve të kryera për zbatimin e programit.

Për aktivitetin 2.1, subjekti i ngarkuar është identifikuar. Një pjesë e kësaj mase mund të zbatohet me menaxhim indirekt me subjektin e përzgjedhur sipas vlerësimit të shtyllës që është Agjencia Evropiane e Kufirit dhe Rojës Bregdetare (EBCGA).

Ky zbatim nënkupton që EBCGA-ja do të jetë përgjegjëse për kryerjen e të gjitha detyrave që lidhen me zbatimin, përfshirë detyrat e ekzekutimit të buxhetit. Në veçanti, subjekti i ngarkuar mban përgjegjësinë për menaxhimin e thirrjeve për tender, thirrjeve për propozime, kontraktimin, zbatimin, administrimin e pagesave, informimin dhe vizibilitetin, monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve të IPA II, si edhe vlerësimin e tyre kurdo që është e nevojshme, në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe garanton ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve të kryera për zbatimin e programit.

Subjekti i parashikuar është përzgjedhur në bazë të këtyre kriterëve të përzgjedhjes: i. përvoja dhe funksioni i subjektit si agjenci e specializuar e Bashkimit Evropian në çështjet e menaxhimit të kufirit, që ngarkohet në zbatim dhe në nxitje të konceptit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe me praktikën dhe standardet e përbashkëta të BE-së në fushën e menaxhimit të kufirit; ii. njohuritë unike, ekspertizën teknike të nivelit të lartë, kapacitetet logjistike dhe menaxhuese; iii. avantazhi krahasues për shkak të sinergjive me aktivitetet e tjera të EBCGA-së në Shqipëri; iv. ndikimi, rezultatet, potenciali i bashkëpunimit me subjektet/donatorët e tjerë, duke marrë parasysh efektivitetin e delegimit të detyrave, përfshirë edhe në Shqipëri; v. kosto të reduktuara transaksionesh nga subjekti delegues.

Përzgjedhja e EBCGA-së është në përputhje me nenin 8 të rregullores financiare kuadër (Rregullorja e Delegimit e Komisionit [BE] 1271/2013).

EBCGA-ja ka nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi operacional me Shqipërinë që iu mundëson ekipeve të EBCGA-së dislokim të shpejtë në territorin shqiptar me kompetenca ekzekutive.

Nëse bisedimet me EBCGA-në dështojnë, kjo pjesë e masës mund të zbatohet me menaxhim indirekt me një subjekt që do të përzgjidhet prej Komisionit bazuar në këto kriterë: i. përvoja dhe funksioni i subjektit të specializuar në funksioni i subjektit të specializuar në çështjet e menaxhimit të kufirit në Bashkimin Evropian; ii. ekspertiza teknike e nivelit të lartë, kapacitetet logjistike dhe menaxhuese; iii. avantazhi krahasues për shkak të sinergjive me aktivitete të tjera, përfshirë në Shqipëri; iv. ndikimi, rezultatet, potenciali i bashkëpunimit me subjektet/donatorët e tjerë, përfshirë në Shqipëri.

Nëse dështon përzgjedhja e një subjekti apo bisedimet me subjektin/et e përzgjedhura, ajo pjesë e kësaj mase mund të zbatohet me menaxhim direkt në përputhje me mënyrat e zbatimit të përcaktuara në seksionin 3(b).]

3. b) Menaxhim direkt nga Delegacioni i BE-së për aktivitetet 1.4, 3.1, 3.2, 3.3, 4.1

Prokurimi – Aktivitetet 3.3 dhe 4.1:

Zarfi buxhetor global i rezervuar për prokurimin: 2 000 000 EUR

Prokurimi – Aktivitetet 2.1:

Zarfi buxhetor global i rezervuar për prokurimin: 6 000 000 EUR

Grantet

Grant – Thirrje për propozim për aktivitetet 3.1, 3.2

a) Qëllimi i grantit:

Objektivi i aktiviteteve të lartpërmendura është përmirësimi i kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve dhe mënyrave alternative të jetesës për komunitetet e cenuara ndaj kultivimit dhe trafikut të kanabisit.

Rezultatet e parashikuara janë akses i përmirësuar në mundësitë e zhvillimit social dhe ekonomik rural dhe në shërbimet jetike për komunitetet e cenuara ndaj kultivimit dhe trafikut të kanabisit.

b) Kategoritë e aplikantëve që synohen:

Për të fituar të drejtë e aplikimit për grant, aplikanti, duhet:

- të jetë person juridik i regjistruar në Shqipëri;
- të jetë autoritet vendor përgjegjës ose organ publik përgjegjës në fushat që përfshijn kjo masë dhe të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e masës me partnerë, nëse ka, dhe jo të veprojë si ndërmjetës.

Grant – binjakëzim – thirrje për propozim për aktivitetin 1.4

a) Qëllimi i Binjakëzimit: Përmirësimi i kapaciteteve të Policisë së Shtetit dhe sidomos të Akademisë së Sigurisë në përgatitjen e trajnimeve të institucionalizuara për forcimin e kapaciteteve të tyre në luftën kundër krimit të organizuar bashkë me trafikun e drogës dhe kultivimin e kanabisit. Rezultatet përfshijnë përgatitjen dhe institucionalizimin e programeve të trajnimit dhe zhvillimin e platformave të mbi tema të përzgjedhura.

b) Kategoria e aplikantëve që synohen: aplikantët duhet të jenë nga administratat apo organe të mandatuara të një shteti anëtar të BE-së.

Zarfi buxhetor global i rezervuar për grantet është 5 500 000 EUR.

4. Kriteri gjeografik për pjesëmarrjen në prokurime dhe grante

Kriteri gjeografik lidhur me selinë (vendosjen) subjekteve zbatohet në lidhje me pjesëmarrjen në prokurime dhe procedurat e dhënies së granteve, si edhe në lidhje me origjinën e furnizimeve që blihen dhe që evidentohen në aktin themelor dhe në dokumentet kontraktuale përkatëse. Zyrtari përgjegjës autorizues i Komisionit mund të zgjerojë kriterin gjeografik në raste urgjente apo kur produktet dhe shërbimet nuk gjenden në tregjet e vendeve përkatëse, apo në raste të justifikuara siç duhet ku kriteret e aplikimit e bëjnë realizimin e kësaj mase të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë.

SEKTORI	SHTETI I SË DREJTËS DHE TË DREJTAT THEMELORE	42 000 000 EUR
---------	--	----------------

1. Përshkrimi i masës, objektivit, rezultateve të pritshme dhe treguesve kyç të performancës.

Veprimi 3	BE-ja për reformën në drejtësi	Menaxhim direkt	34 000 000 EUR (mbështetje buxhetore)
			8 000 000 EUR (asistencë teknike plotësuese)
		TOTAL	42 000 000 EUR

- Përshkrimi i masës dhe objektivave

Objektivi i përgjithshëm është të kontribuojë në forcimin e shtetit të së drejtës, zbatimin e ligjit dhe uljen e korrupsionit në institucionet shtetërore dhe në gjyqësor.

Objektivat specifikë, janë: forcimi i pavarësisë, transparencës, efikasitetit, llogaridhënies dhe besimit të publikut te sistemi i drejtësisë në Shqipëri në përputhje me standardet evropiane; dhe ii. forcimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e vuajtjes së dënimit.

- Rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

Rezultatet e pritshme, janë:

- institucione të sistemit të drejtësisë që janë të pavarura, efikase dhe llogaridhënëse, duke garantuar përfaqësim të barabartë gjinor;
- sistemi i drejtësisë ka transparencë dhe aksesueshmëri të përmirësuar;
- edukim dhe trajnim ligjor i konsoliduar;
- efektivitet i përmirësuar i sistemit të drejtësisë penale;

- sistemi i menaxhimit elektronik të drejtësisë ka infrastrukturë dhe funksionalitet të përmirësuar;
- funksionim i përmirësuar i Ministrisë së Drejtësisë;
- akses i shtuar në drejtësi, përmes përmirësimit të cilësisë të profesioneve ligjore dhe arbitrazhit;
- masa riintegrimi dhe rehabilitimi për të dënuarit sipas standardeve evropiane.

Treguesit kyç të performancës:

- indeksi i performancës së gjyqësorit për normën e përfundimit të çështjeve;
- numri i çështjeve pezull (të mbartura) në Gjykatën e Lartë;
- përqindja e mbipopullimit në burgje kundrejt ambienteve ekzistuese;
- përqindja e personave të dënuar me dënime alternative ndaj burgosjes krahasuar me totalin e personave të dënuar;
- numri i institucioneve të ngritura rishtas në kuadrin e paketës së reformës në drejtësi dhe që janë funksionale;
- raporti i ankesave të shqyrtuara ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve kundrejt ankesave të depozituara;
- përqindja e procedimeve disiplinore të filluara ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve që rezultojnë në sanksione;
- numri i çështjeve të akumuluar në performancën vjetore të gjyqtarëve;
- numri i kurrikulave të zbatuara nga Shkolla e Magjistraturës;
- numri i kurseve *online* për Shkollën e Magjistraturës;
- raporti i personave përfitues dhe që marrin ndihmë juridike parësore/dytësore;
- përqindja e dënimeve pa burgosje ndaj totalit të dënimeve.
- përqindja e dënimeve penale për vepra të dënueshme deri në 5 vjet burg, që përfshijnë aplikimin e dënimeve alternative ndaj burgosjes;
- numri i studimeve, analizave, statistikave të kryera në fushën e gjyqësorit;
- numri i çështjeve që janë zgjidhur përmes zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve;
- numri i personave me liri të kufizuar që përfshihen në aktivitetet e riintegrit;
- përqindja e kësteve/transheve të disbursuara;
- numri i platformave teknike, strategjike dhe të nivelit të lartë për dialog mbi politikat që zhvillohen për zbatimin e Strategjisë për Drejtësinë.

2. Supozime dhe kushte

Supozohet se autoritetet shqiptare (Qeveria, Parlamenti dhe institucionet e Gjyqësorit) do të kenë angazhimin e plotë për arritjen e objektivave të programeve, si edhe do të garantojnë qëndrueshmërinë e tyre. Ministria e Drejtësisë, si institucion udhëheqës për bashkërendimin e aktorëve në zbatimin e Strategjisë, do të drejtojë një strukturë bashkërenduese për monitorimin periodik të zbatimit të Strategjisë, si edhe çdo përditësim të nevojshëm.

Gjithashtu, supozohet se në buxhetin kombëtar dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm do të parashikohen/alokohen çdo vit fonde të mjaftueshme për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë, sidomos për funksionimin e institucioneve të reja dhe ekzistuese, si edhe të Shkollës së Magjistraturës.

Kushtet e përgjithshme për disbursimin e të gjitha kësteve janë si vijon:

- progres i kënaqshëm në zbatimin e Strategjisë për Reformën në Sektorin e Drejtësisë dhe vijimësia e besueshmërisë dhe relevancës së saj;
- zbatimi i një politike makroekonomike të besueshme të orientuar drejt stabilitetit;
- progres i kënaqshëm në zbatimin e Strategjisë për Reformën në Menaxhimin Financiar Publik;
- progres i kënaqshëm në informimin e publikut duke i dhënë informacion të shëndoshë buxhetor në kohën e duhur dhe të plotë.

Kushtet specifike për disbursimin, që mund të vihen për disbursimin e kësteve të ndryshme përcaktohen në shtojcën 1A dhe përfshijnë:

- numri i institucioneve të reja gjyqësore të ngritura dhe funksionale;
- përqindja e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të shqyrtuara;
- cilësi e përmirësuar e performancës së Shkollës së Magjistraturës;
- niveli i kapacitetit për edukimin ligjor të Shkollës së Magjistraturës;
- çështjet e mbartura në Gjykatën e Lartë;
- Përqindja e përdorimit të dënimeve alternative ndaj burgosjes.

Mosrespektimi i kërkesave më lart mund të çojë në rikuperimin e fondeve nën këtë program dhe/ose rialokimin e financimeve në të ardhmen.

3. Mënyrat e zbatimit

3. a) Menaxhim direkt përmes mbështetjes buxhetore

a) Kriteret për mbështetje buxhetore

Politika publike

Në vijim të punës analitike të Komisionit të Posaçëm Parlamentar, në nëntor 2016 u miratuan Strategjia Ndërsektoriale për Drejtësinë dhe Plani i saj i Veprimit.

Strategjia shënjestron mangësitë dhe sfidat kryesore siç përcaktohen në Dokumentin Analitik të përgatitur nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi. Mangësitë kanë të bëjnë me ndarjen e pamjaftueshme të pushteteve ndërmjet ekzekutivit dhe gjyqësorit; kriteret e emërimit dhe procedurat për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm; statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve; procesi i procedimeve disiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët; kapacitetet e dobëta administrative në sektorin e drejtësisë; buxheti i pamjaftueshëm i alokuar për infrastrukturën e gjykatave dhe rrogat e gjyqtarëve; trajnimin bazë dhe në vazhdimësi për gjyqtarët dhe prokurorët; nivelin e lartë të korrupsionit në gjyqësor dhe shkeljet e të drejtave të njeriut në sistemin e vuajtjes së dënimit si rezultat i mbipopullimit dhe mungesën e qendrave të paraburgimit dhe burgimit të përshtatshme për të miturit dhe të sëmurët mendorë.

Strategjia e Sektorit të Drejtësisë lidhet me prioritetet e politikave kombëtare të përcaktuara në dokumente të ndryshme strategjike dhe të politikave. Ajo adreson objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim në lidhje me drejtësinë që synon “ndërtimin e një vendi bazuar në shtetin e së drejtës, garantimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, me një sistem drejtësie të hapur dhe të barabartë që garanton drejtësi për të gjithë”, si edhe objektivat e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017–2020 “ndërtimi i një sistem drejtësie të pavarur, llogaridhënës dhe efikas në Shqipëri që është i aftë të japë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe transparente, si edhe zbatim i legjislacionit të përafëruar në përputhje me *acquis* të BE-së”.

Gjithashtu, adreson mangësitë e evidentuara në raportet e progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2018, në lidhje me krijimin e institucioneve gjyqësore të reja dhe të pavarura, duke ndjekur një qasje sektoriale për zbatimin e reformës në drejtësi në kuadrin e Strategjisë Ndërsektoriale, 2017–2020, dhe siguron mekanizma adekuatë qeverisjeje, monitorimi dhe raportimi përmes treguesve të mirëzhvilluar kombinuar me mbështetje financiare adekuate për zbatimin e saj. Ajo lidhet me Strategjinë Antikorrupsion 2015–2020 në kuadrin e “qasjes represive” që përfshin: efikasitet dhe efektivitet i përmirësuar i hetimeve penale kundër korrupsionit; përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive ligjzbatuese në procedimin penal dhe ndëshkimin e korrupsionit; përmirësimin e kuadrit ligjor për procedimin penal të krimeve ekonomike dhe financiare; përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar ligjor dhe policor në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar.

Strategjia merr parasysh Strategjinë Afatmesme të Prokurorisë shqiptare 2015–2017, e cila fokusohet në rritjen e efektivitetit të hetimeve, në forcimin e kapaciteteve hetimore profesionale dhe teknike, si dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional etj.

Ajo lidhet edhe me Strategjinë për Reformën e Administratës Publike (RAP) me qëllim forcimin e kapaciteteve të hartimit ligjor të Departamentit të Kodifikimit dhe departamenteve të tjera në Ministrinë e Drejtësisë (objektivi 2 i Strategjisë RAP): *Sistem transparent dhe gjithëpërfshirës të hartimit të ligjeve, që bazohet në politika dhe që garanton harmonizim me acquis*. Ekzistojnë edhe një sërë lidhjesh të tjera me Strategjinë RAP për sa i përket reformës së shërbimit civil.

Punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë dhe të institucioneve të saj të varësisë, përfshirë sidomos sistemin e vuajtjes së dënimit, janë kryesisht nëpunës civilë. Objektivat e mëposhtëm të Strategjisë RAP kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e performancës së nëpunësve civilë në këto institucione. Përmirësimi i kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë dhe Departamentit të Kodifikimit do të mbështetë harmonizimin e legjislacionit sektorial me Kodin e Procedurës Administrative dhe garanton zbatimin e duhur të këtij Kodi në mbarë administratën publike. Strategjia lidhet edhe me Strategjinë ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014–2020 e cila, mes të tjerash, do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në riorganizimin e hartës gjyqësore dhe rrjedhimisht në aksesin në drejtësi për qytetarët.

Për më tepër, Strategjia përfshin nevojat e identifikuara nga të gjitha institucionet përkatëse. Çështjet gjinore dhe të pakicave, si edhe aksesin në drejtësi për grupet e cenuara mbulohen në mënyrë implicite në disa prej masave, por prapë duhet të nënvizohen më tej. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (2016–2020) e miratuar së fundmi nga Qeveria e Shqipërisë, ka një objektiv strategjik për uljen e dhunës

me bazë gjinore dhe dhunës në familje dhe një mekanizëm kombëtar funksional për barazinë gjinore. Për sa i përket relevancës, Strategjia e reformës në drejtësi shënjestron tetë objektiva që shtjellohen me disa masave që adresojnë sfidat kryesore të sektorit:

- forcimi i pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë;
- konsolidimi i edukimit ligjor dhe trajnimit si edhe specializimi i magistratëve dhe personelit të gjykatave;
- përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe aksesueshmërinë në përputhje me standardet evropiane;
- rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave kundër korrupsionit përmes konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale;
- përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë përmes procedurave dhe pajisjeve të sistemeve elektronike për zhvillimin e një bashkëpunimi të fuqishëm ndërkombëtar;
- forcimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e vuajtjes së dënimit;
- përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të sa të varësisë;
- përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të profesioneve ligjore dhe miratimi i kuadrit ligjor për arbitrazhin.

Reforma në Sektorin e Drejtësisë përfshin një Plan Veprimi 2017–2020 që mbulon të gjitha shtyllat. Treguesit, të dhënat bazë dhe objektivat e treguesve janë përcaktuar. Plani i Veprimit rishikohet çdo vit, me qëllim që të përshtatet me progresin e zbatimit të masave dhe të përditësohet në përputhje me programin buxhetor afatmesëm. Në raportin e parë të monitorimit, institucionet pohuan nevojën e rishikimit të Strategjisë dhe të Planit të Veprimit 2017–2020 për t'i përshtatur më mirë me nevojat e institucioneve nisur nga disa vonesa në ngritjen e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, ndryshimi i rrethanave dhe përgjegjësia institucionale që ndikojnë në zbatimin e aktiviteteve, përditësimi i kostove dhe alokimet buxhetore adekuate, ndryshimet në nivelin drejtues ndër aktorët kryesorë të përfshirë në zbatimin e disa masave.

Për masat në këtë Plan Veprimi që ende nuk kanë mbulim financiar, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat buxhetore në programet buxhetore përkatëse si pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe procesit të buxhetimit vjetor. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave në Bashkëpunim me komunitetin e donatorëve do të identifikojnë alternativat e financimeve. Për sa i përket besueshmërisë, në nëntor 2014 u arrit një marrëveshje politike për të zhvendosur përgjegjësinë për hartimin dhe miratimin e reformës në drejtësi nga Ministria e Drejtësisë te Parlamenti. Ky i fundit garantoj pjesëmarrje më të gjerë nga të gjitha partitë politike, duke siguruar kështu mbështetje politike për reformën në drejtësi dhe duke shmangur etiketimin se kjo reformë po zbatohet ekskluzivisht nga qeveria, pra, nga pushteti ekzekutiv.

Strategjia është konsultuar me shoqërinë civile dhe publikun e gjerë, si dhe është hartuar nga miratuar nga një grup pune sektorial që përfshinte të gjithë aktorët kryesorë të sektorit të drejtësisë. Hartimi reflektoi vlerësimet dhe konsultimet me të gjithë këta aktorë në nivel operacional, përfshirë këtu edhe shoqërinë civile, në tetor 2015 dhe shtator 2016, duke lejuar kohë të mjaftueshme për dhënien e komenteve. Komisioni i Posaçëm parlamentar bashkëpunoi ngushtë me një bërthamë prej 10 organizatash të shoqërisë civile aktive në fushën e drejtësisë, duke i ftuar rregullisht në tryezat e konsultimeve⁴¹. Edhe të tjera organizata të shoqërisë civile luajtën rol aktiv duke i dërguar komente me shkrim Komisionit të Posaçëm. Komentet janë pasqyruar në Strategjinë përfundimtare. Në maj 2018, Kuvendi ngriti Komisionin e Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Ky Komision do të monitorojë zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të organeve qeverisëse të sistemit të drejtësisë; do të koordinojë zbatimin e ligjit nr. 115/2016 nga institucionet përkatëse; do të raportojë pranë Kuvendit për ecurinë e zbatimit të tij; si edhe do të regjistrojë rastet e moszbatimit të ligjit nga institucionet përgjegjëse. Pra, mund të konkludohet se hartimi i Strategjisë ka qenë proces gjithëpërfshirës që inkadronte aktorët përkatës shtetërorë dhe joshetërorë.

I njëjti nivel pjesëmarrjeje dhe përfshirjeje është garantuar për zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të saj. Për këtë detyrë është ngritur një mekanizëm institucional i ndihmuar nga një Sekretariat Teknik, nën udhëheqjen e Ministrisë së Drejtësisë.

⁴¹ <http://www.reformanedrejttesi.al/rrejeti-i-organizatave-jofitimprur%C3%ABse>

Raportet vjetore të progresit/monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit për vitin 2017, janë publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë.⁴² Sipas raportit të parë, nga 210 nënaktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë, 59 ose 29% të totalit të aktiviteteve janë zbatuar, 35 ose 18% janë në proces dhe 107 ose 53% e zbatimit nuk ka filluar ende. Shumica e aktiviteteve që ende nuk kanë nisur të zbatohen (65 nënaktivitete) bien në fushën e përgjegjësisë të institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë që ende nuk janë krijuar. Për sa i përket historikut të arritjeve, shtatë aktet ligjore që janë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të Strategjisë janë miratuar dhe raporti i parë i monitorimit tregon se reforma në drejtësi po përparon.

Qëndrueshmëria e ndërhyrjeve varet nga faktorë politikë, financiarë dhe strukturorë. Reforma në drejtësi, që të jetë e plotë dhe tërësore ashtu sikurse është miratuar me ndryshimet në Kushtetutë, është rezultat i negociatave politike dhe marrëveshjeve ndërmjet partive politike, me mbështetje të qenësishme të komunitetit ndërkombëtar.

Reforma në drejtësi që është në zbatim ka arritur progres të mirë. Rivlerësimi i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve (procesi i vetëvlerësimit) ka filluar tashme dhe po jep rezultatet e para. Ky proces ka mbështetje ndërpartiake, kryhet nga një autoritet i pavarur, po monitorohet nga ndërkombëtarët dhe Komisioni i Venecias e ka konfirmuar përputhshmërinë e tij me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nën kujdesin e Komisionit Evropian, është dislokuar një Operacion Ndërkombëtar Monitorimi për të mbikëqyrur procesin gjatë të gjithë ciklit të zbatimit⁴³. Në Kuvend është ngritur Këshilli i Legjislacionit, si strukturë bipartiake me përfaqësim të barabartë të shumicës dhe pakicës, për të dhënë opinionin e vet në lidhje me projektligjet sipas kërkesës së komisioneve të tjera parlamentare. Këshilli i Legjislacionit po punon për të trajtuar ndërhyrjet e nevojshme në disa prej ligjeve kyçe të reformës në drejtësi, pas shqyrtimit të tyre nga Gjykata Kushtetuese. Qëndrueshmëria politike e reformës kështu është e sigurt përgjithësisht, por vullneti i plotë politik dhe brendësimi ka ende nevojë të sigurohet nga të gjitha partitë politike.

Qëndrueshmëria e reformës varet edhe nga ekzistenca e burimeve njerëzore të kualifikuara. Procesi i vetëvlerësimit po kontribuon në spastrimin e sektorit të drejtësisë nga elementet e korruptuara. Legjislacioni i ri siguron procedura rekrutimi personeli me bazë merite dhe parashikon institucionet e reja që do të krijohen shumë shpejt. Reforma përfshin edhe një rritje thelbësore të trajnimeve për personelin ekzistues dhe të ri, që shtrihet deri në formimin e vazhdueshëm, kryesisht në drejtimin e Shkollës së Magjistraturës, e ndërthurur me asistencë teknike nga ekspertë ndërkombëtarë. Masat e Strategjisë për forcimin e kapaciteteve u garantojnë institucioneve përgjegjëse kapacitete të mjaftueshme në periudhën afatmesme që të zbatojnë siç duhet planet e miratuara për të arritur objektivat e përcaktuara.

Strategjia dhe Plani i Veprimit i detajuar është vlerësuar se kapin një kosto prej 98.4 milionë euro, nga të cilat 59 milionë euro do të mbulohen nga buxheti i shtetit. Janë bërë alokimet buxhetore për të përballuar ndikimin financiar të legjislacionit kryesor të reformës, por efektet afatmesme të reformës në drejtësi për aspektet e tjera, si p.sh., sistemi i pensioneve, nuk është marrë në konsideratë dhe nuk janë planifikuar buxhete për to deri tani. Nga ana tjetër, në periudhën afatmesme duhet të mbahen parasysh edhe kursimet e mundshme që mund të rezultojnë nga masat antikorrupsion dhe rritja e efikasitetit për shkak të automatizimit. Afatet dhe kostot e Planit të Veprimit do të rishikohen çdo vit, për ta përshtatur me ecurinë e zbatimit dhe për ta përditësuar në përputhje me Programin Buxhetor Afatmesëm dhe anasjellas. Mbi bazën e vlerësimeve të kryera, Strategjia e Reformës në Drejtësi, 2017–2021, konsiderohet relevante dhe e besueshme.

Politika makroekonomike

Siç vihet në dukje në Raportin Vjetor 2018 të KE-së, Shqipëria e përmirësoi stabilitetin makroekonomik gjatë vitit 2017 dhe është relativisht e përgatitur për të zhvilluar një ekonomi tregu funksionale. Rritja ekonomike shkoi deri në 3.9%, një nga normat më të mëdha të rritjes ekonomike në rajon, duke ulur deficitin publik me 2% në vitin 2017 dhe duke mbajtur inflacionin nën kontroll në 2%. Edhe pse është ulur, papunësia vazhdon të jetë e lartë, sidomos për rininë. Progres është arritur në përmirësimin e stabilitetit makroekonomik, si dhe projeksionet e rritjes u përmirësuan me ecurinë e reformës së menaxhimit të financave publike. Ky evolucion konfirmohet nga Raporti i Bankës Botërore “Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënia Financiare 2017” (PEPA) që tregon se rreth gjysma e treguesve

⁴² <http://www.drejtesia.gov.al/plani-i-veprimit-te-strategjise-ndersektorale-te-drejtises/>

⁴³ http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-18-3403_en.htm

të PEPA-së janë përmirësuar. Megjithatë, ende mbeten sfida të qenësishme dhe Shqipëria duhet të vazhdojë konsolidimin fiskal për të arritur objektivin afatmesëm për uljen e borxhit publik dhe për të zgjeruar hapësirën e manovrimit për politikën fiskale dhe fortifikimin e kuadrit të menaxhimit buxhetor. Reformat thelbësore për përmirësimin e mjedisit të biznesit kanë shënuar progres, por nevojiten përpjekje të mëtejshme. Reforma gjithëpërfshirëse në drejtësi ka avancuar, por duhet zbatuar plotësisht. Ligji i ri për falimentin ka hyrë në fuqi dhe do të forcojë regjimin e paaftësisë pague. Shkalla e papunësisë dhe punësimi informal mbeten të larta. Në përputhje me rekomandimet e Programit të Reformave Ekonomike (PRE) Programin Ekonomik të Reformave (PER) dhe me qëllim mbështetjen e rritjes afatgjatë, Shqipëria duhet t'u kushtojë vëmendje të veçantë në vitet në vazhdim: i. qëndrueshmërisë së konsolidimit fiskal dhe forcimit të kuadrit të menaxhimit buxhetor; ii. të zgjidhjeve nivelin e lartë të kredive me probleme; iii. përmirësimit të mjedisit të biznesit duke zbatuar në praktikë ligjin e ri për falimentin; dhe iv. reduktimit të ekonomisë informale, përfshirë punën e padeklaruar.

Zbatimi i marrëveshjes së financimit 3-vjeçar me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) për forcimin e stabilitetit makroekonomik dhe reformave që nxisin rritjen është përmbyllur me sukses në mars 2017. Në mars 2018, FMN-ja realizoi të parin mision monitorimi pas programit me fokus të dobësitë dhe risqet. FMN-ja i rekomandon Shqipërisë të vazhdojë përpjekjet që të konsolidojë rritjen dhe rezistencën e ekonomisë me përpjekje për uljen e borxhit publik dhe nevojat për huamarrje, reformën e tatimit mbi pasurinë dhe reduktimin e përjashtimeve tatimore, ta bëjë menaxhimin financiar publik më efikas dhe ta modernizojë administratën tatimore, të zgjidhë problemin e borxheve ndaj bankave që pengon huadhënien, dhe të përshpejtojë si reformën në drejtësi të shpallur së fundmi dhe e mbështetur nga BE-ja, por edhe reformat strukturore përkatëse që zgjidhin shqetësimet e qeverisjes dhe të sistemit të drejtësisë joefikas.

Vlerësimi që Komisioni Evropian i bën Programit të Reformave Ekonomike (PRE) 2018–2020 konfirmon se kuadri ekonomik i paraqitur në PRE i janarit 2018 është koherent, konsistent dhe gjithëpërfshirës në masë të mjaftueshme, si dhe shërben si bazë adekuate për vlerësimin dhe për diskutimin e politikave. Pas mosarritjes së objektivit të ardhurave në vitin 2015, përmirësimet në projeksionet e të ardhurave në dy vitet e fundit sugjerojnë që qeveria ka miratuar procedura më të mira për supozimet makroekonomike, si dhe për vlerësimin e politikave të reja. Të ardhurat tatimore janë rritur qenësishëm nga 22% e PBB-së në vitin 2013, në 26% në vitin 2017, duke bërë që të ardhurat totale të arrijnë 28% të PBB-së. Është i dukshëm progresi i kënaqshëm në fushat e PRE-së, ku disa reforma janë në proces dhe vazhdojnë të zbatohen⁴⁴. PRE-ja e angazhon Shqipërinë drejt një rruge ambicioze konsolidimi fiskal, me qëllim trajtimin e dobësive që lindin nga borxhi i lartë publik që ishte 71.2% e PBB-së në fund të vitit 2017 dhe tronditjet e jashtme potenciale. *Në tërësi, është përmbushur kriteri kualifikues për të pasur një politikë makroekonomike të orientuar drejt stabilitetit që është e besueshme dhe relevante.*

Menaxhimi financiar publik

Qeveria përfundoi vitin e tretë të zbatimit të **Strategjisë MFP 2014–2020 dhe Planin e saj të Veprimit**, objektivi i së cilës është të përmirësojë kuadrin fiskal, procesin e buxhetimit, zbatimin e rregullave dhe procedurave, menaxhimin e matur të fondeve publike, si edhe të forcojë mekanizmat e transparencës dhe të llogaridhënies. Raporti i fundit i monitorimit të MFP-së 2017, i publikuar në mars 2018, vinte në dukje se nga 14 treguesit e përgjithshëm MFP, tetë janë realizuar (57%), pesë nuk janë realizuar dhe për një nuk ka të dhëna. Për sa u përket treguesve *specifikë* të performancës që mbulojnë shtatë shtyllat e programit të reformave MFP, janë realizuar 19 nga 36 tregues (53%), shtatë nuk janë realizuar dhe shtatë janë realizuar pjesërisht, ndërkohë që për tre tregues mungojnë të dhënat.

Nga 73 masa/aktivitete që ngelen për periudhën 2015–2020, 18 janë realizuar gjatë vitit 2017, 54 janë në proces, një fillon këtë vit dhe një është braktisur. Ky progresion krahasuar me vitin 2016 tregon që ka njëfarë ritmi.

Nevoja për përmirësime në transparencë dhe gjithëpërfshirje të raportimit dhe shqyrtimit buxhetor përmendet veçanërisht nga projekti SIGMA (Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit) të OECD-së. Megjithatë, krahasimi mes vendeve të rajonit tregon se Shqipëria ka arritur rezultat më të mirë sesa vendet e tjera në planifikimin afatmesëm buxhetor dhe në treguesit e procesit të buxhetimit. FMN-ja sugjeron që Shqipëria të shpejtojë hapat në konsolidimin fiskal për të krijuar amortizues politikash, duke parë nivelin e lartë të borxhit publik (70% i PBB-së në fund të vitit 2017,

⁴⁴ Raporti i Monitorimit 2017 për Reformën në Menaxhimin e Financave Publike, Ministria e Financave, mars 2018.

përfshirë detyrimet e prapambetura të pushtetit qendror dhe vendor ndaj biznesit në masën 2.2% e PBB-së). Në periudhën në vijim, reformat do të fokusohen në këto fusha: përmirësimi i planifikimit dhe menaxhimit buxhetor; forcimi i standardeve të kontrollit të brendshëm në tërë qeverisjen; parandalimi i akumulimit të detyrimeve ndaj biznesit, si nga qeverisja qendrore edhe vendore; ndjekja e rekomandimeve për auditimin e brendshëm dhe të jashtëm; përmirësimi i planifikimit dhe menaxhimit të investimeve, përmirësimi i shqyrtimit të prokurimeve publike dhe respektimi i rregullave të prokurimit; dhënia e aksesit *online* në degën e thesarit për më shumë institucione; dhe analizimi i risqeve fiskale të ndërmarrjeve shtetërore. *Në tërësi, është vlerësuar si i përmbushur në vitin 2017 kriteri për një program të besueshëm dhe relevant për përmirësimin e menaxhimit të financave publike.*

Transparenca buxhetore dhe mbikëqyrja e buxhetit

Ekziston informacion i përgjithshëm për transparencën buxhetore dhe mekanizmat mbikëqyrës të buxhetit në Shqipëri. Kriteri minimal i publikimit buxhetor 2017 është përmbushur me publikimin e buxhetit në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave⁴⁵. Qeveria publikoi edhe një buxhet për qytetarin në buxhetin 2017⁴⁶. Kriteri për publikimin e informacionit shtesë është miratuar në ligjin organik për buxhetin. Qeveria publikoi dokumentet Buxheti Transparent 2016 dhe 2017 për Kuvendin, në gjuhën shqipe dhe angleze. Për herë të parë, Qeveria publikoi një listë të plotë investimesh publike bashkëlidhur Programit Buxhetor Afatmesëm 2016–2018⁴⁷.

Në anketën e Indeksit të Buxhetit të Hapur (OBS) 2017, Shqipëria arrin rezultatin 50, që shënon përmirësim të konsiderueshëm nga viti 2015 kur kishte rezultatin 38. Shqipëria publikon shtatë nga tetë dokumente buxhetore në kohën e duhur, ku mungon raportimi për Buxhetin e Mesvitet⁴⁸. Pjesëmarrja e publikut në procesin e buxhetimit shënoi vetëm 2 pikë nga 100 në OBS 2017, duke shënuar trend negativ nga viti 2015 me rezultatin 15 nga 100. Vlerësimi i FMN-së “Kodi i Transparencës Fiskale”⁴⁹ publikuar në janar 2016 vinte në dukje se nja 10 prej 36 parimeve të Kodit vlerësohen “mirë” dhe “avancuar” dhe 14 parime janë vlerësuar me “bazike”. Megjithatë, në tetë fusha, kriteret bazike të Kodit nuk janë përmbushur.

Qeveria publikon informacion për nxjerrjen e naftës, gazit dhe mineraleve, kontributin e kësaj industrie në buxhetin e shtetit dhe alokimin dhe shpenzimin e këtyre të ardhurave. Në dhjetor 2016, Nisma e Transparencës së Industrive Nxjerrëse (EITI) publikoi hartën përfituese të Shqipërisë që tregon se si Shqipëria synon të publikojë pronarët përfitues të kompanive aktive në sektorin e nxjerrjes. Qëllimi është që të promovohet transparenca për të parandaluar korrupsionin dhe të rritet sensibilizimi i qytetarëve që të kërkojnë nga qeveria e tyre përdorim të duhur të ardhurave fiskale dhe jofiskale nga kerkimi dhe shfrytëzimi i burimeve natyrore në Shqipëri. Në qershor 2017, EITI vlerësoi Shqipërinë dhe konstatoi se ka shënuar progres të kënaqshëm. Të gjitha aspektet e kriterit janë zbatuar dhe objektivi kryesor i kriterit është përmbushur. Në tërësi, kriteri për transparencën e buxhetit është përmbushur.

b) Objektivat

Objektivi i përgjithshëm i kësaj kontrate reforme sektoriale është të kontribuojë në forcimin e shtetit të së drejtës, zbatimit të ligjit dhe uljes së korrupsionit në institucionet shtetërore dhe në gjyqësor.

Objektivat specifikë, janë: i. forcimi i pavarësisë, transparencës, efikasitetit, llogaridhënies dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, në përputhje me standardet evropiane; dhe ii. forcimi i të drejtave të njeriut në sistemin e vuajtjes së dënimit.

c) Rezultatet e pritshme

Rezultatet e pritshme janë:

- institucione të sistemit të drejtësisë që janë të pavarura, efikase dhe llogaridhënëse, duke garantuar përfaqësim të barabartë gjinor;
- sistemi i drejtësisë ka transparencë dhe aksesueshmëri të përmirësuar;
- edukim dhe trajnim ligjor i konsoliduar;
- efektivitet i përmirësuar i sistemit të drejtësisë penale;

⁴⁵ <http://www.financa.gov.al/al/legjislacioni/buxheti-thesariborxhi/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2016>

⁴⁶ <http://www.financa.gov.al/al/legjislacioni/buxheti-thesariborxhi/buxheti/buxheti-i-qytetairt-2016>

⁴⁷ http://www.ekonomia.gov.al/al/files/userfiles/Invstimet_PBA_2016-2018.pdf

⁴⁸ <http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2017>

⁴⁹ <http://www.imf.org/external/np/sec/pr/2016/pr1611.htm>

- sistemi i menaxhimit elektronik të drejtësisë ka infrastrukturë dhe funksionalitet të përmirësuar;
- funksionim i përmirësuar i Ministrisë së Drejtësisë;
- akses i shtuar në drejtësi, përmes përmirësimit të cilësisë të profesioneve ligjore dhe arbitrazhit;
- masa riintegrimi dhe rehabilitimi për të dënuarit sipas standardeve evropiane;

d) Aktivitetet kryesore mbështetëse të buxhetit

Aktivitetet kryesore në zbatim të paketës mbështetëse buxhetore janë dialogu për politikën, transferi financiar, vlerësimi i performancës, raportimi dhe zhvillimi i kapaciteteve.

Angazhimi në dialog rreth kushteve dhe prioritetet e reformës qeveritare, verifikimi i kushteve dhe pagimi i mbështetjes buxhetore.

Aktivitetet e hollësishme, janë:

- angazhimi në dialogun e politikave rreth kushteve dhe prioritetet e reformave qeveritare, verifikimi i kushteve, objektiveve dhe pagesa e mbështetjes buxhetore;
- transferimi i 34 milionë euro vendit përfitues gjatë viteve fiskale 2019, 2020, 2021 dhe 2022 me lëvrimin e kësteve/transheve fikse dhe variabël;
- vazhdimi i mbështetjes për përfundimin e kapaciteteve institucionale të qeverisë për të zbatuar reformën në sektorin e drejtësisë, përfshirë institucionet e reja dhe mandatet që rezultojnë nga ndryshimet në kuadrin normativ;
- forcimi i koordinimit të donatorëve përmes forcimit të kapaciteteve të sektorit të drejtësisë me anë të asistencës teknike;
- krijimi i sistemeve të monitorimit dhe të vlerësimit për ndjekjen e zbatimit të Strategjisë së Reformës në Drejtësi përmes forcimit të kapaciteteve;
- monitorimi sistematik i kriterëve të pranueshmërisë për mbështetjen buxhetore,

e) Asistenca teknike plotësuese (menaxhimi direkt)

Objekti i asistencës së parë plotësuese nën menaxhimin direkt është të forcojë kapacitetet e Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të sektorit të drejtësisë që të operojnë një mekanizëm efektiv për koordinimin, menaxhimin, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Strategjisë për Sektorin e Drejtësisë.

Rezultati i pritshëm i asistencës teknike plotësuese është që kapacitetet për koordinimin dhe zbatimin e Strategjisë për Sektorin e Drejtësisë të forcohen përmes trajnimit dhe këshillimit në punë të personelit përkatës të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera të sektorit të drejtësisë.

Numri i treguesve kyç të performancës, janë: i. numri i ditëve të trajnimit për person që ofrohet ose mundësohet; ii. numri i takimeve monitoruese të mundësuar; iii. numri i aktiviteteve për dialogun e politikave me grupet e interesit shtetëror, donatorët, organizatat e shoqërisë civile (OSHC) etj. të mundësuar; iv. numri i aktiviteteve për komunikimin dhe sensibilizimin si pjesë e planit të komunikimit për rritjen e ndërgjegjësisë publike për reformat në drejtësi që po zbatohen; v. numri i anketave/pyetësorëve se sa të kënaqur janë përdoruesit e gjykatave dhe personeli i gjykatave të realizuara⁵⁰.

Objekti i masës së dytë plotësuese nën menaxhimin direkt është të mbështetë monitorimin e zbatimit të mbështetjes buxhetore si edhe forcimi i dialogut të politikave për zbatimin. Kjo masë e dytë plotësuese do të japë kontribut në formën e analizave, të dhënave/informacionit, misionëve faktmbledhëse dhe përgatitjes së dokumenteve që të vlerësohet zbatimi dhe të mbështetet dialogu i politikave, përfshirë paralajmërimin e hershëm dhe analizën e riskut.

Rezultatet e pritshme, janë: i. forcimi i dialogut të politikave për zbatimin e reformës, përmes kontributit që japin vlerësimet e pavarura; ii. kërkesat për pagesë plotësohen dhe dorëzohen në përputhje me kalendarin tregues të pagesave. Treguesi kyç i performancës lidhet me numrin e dialogëve të politikave të mundësuar nga vlerësimi, si edhe i kërkesave për pagesë të dorëzuara.

Objekti i masës së tretë plotësuese nën menaxhimin direkt është të kontribuojë në rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo asistencë e tretë plotësuese do të japë mbështetje për operacionin e pavarur të monitorimit. Rezultatet e pritshme janë që rivlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të forcohet prej operacionit të pavarur të monitorimit. Treguesi kyç i performancës do të matë numrin e procedurave të vlerësimit për gjyqtarët dhe prokurorët të monitoruara.

⁵⁰ Në përputhje me raportin dhe modelin e anketës CEPEJ shoqëruar me udhëzime metodologjike përgatitur nga Jean-Paul Jean dhe Hélène Jorry.

Zarfi buxhetor global i rezervuar për prokurimin: 8 000 000 EUR.

4. Kriteri gjeografik për pjesëmarrjen në prokurime dhe grante

Kriteri gjeografik lidhur me selinë (vendosjen) e subjekteve zbatohet në lidhje me pjesëmarrjen në prokurime dhe procedurat e dhënies së granteve, si edhe në lidhje me origjinën e furnizimeve që blihen dhe që evidentohen në aktin themelor dhe në dokumentet kontraktuale përkatëse.

Zyrtari përgjegjës autorizues i Komisionit mund të zgjerojë kriterin gjeografik në raste urgjente apo kur produktet dhe shërbimet nuk gjenden në tregjet e vendeve përkatëse, apo në raste të justifikuara shterueshëm ku kriteret e aplikimit e bëjnë realizimin e kësaj mase të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë.

SEKTORI	MJEDISI, MASAT PËR KLIMËN DHE ENERGJETIKA		24 100 000 EUR
Veprimi 4	BE-ja për mjedis më të pastër – mbështetje për trajtimin e ujërave të ndotura	Menaxhim indirekt me KfW-në	24 100 000 EUR

1. Përshkrimi i masës, objektivit, rezultateve të pritshme dhe treguesve kyç të performancës

- Përshkrimi i masës dhe i objektivave

Kjo masë është ideuar që mbështetë sektorin e ujit në funksion të trajtimit të ujërave të ndotura në Shqipëri. Objektivi i përgjithshëm i kësaj mase është të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social, mjedisor dhe territorial, si edhe në atraktivitetin e turizmit. Objektivi i ndërmjetëm është të përmirësohet cilësia e ujit dhe kushtet sanitare të popullatës në Shqipëri.

Objektivat specifikë, janë: i. rritja e qëndrueshmërisë së ndërmarrjeve bashkiake, duke përmirësuar planifikimin dhe menaxhimin e operacioneve; dhe ii. rritja e aksesit në grumbullimin e ujërave të ndotura me sisteme trajtimi të centralizuara, monitoruar në përputhje me direktivat e BE-së.

- Rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

Rezultatet e pritshme, janë: i. forcimi i menaxhimit të infrastrukturës së ujërave të ndotura në nivel bashkie, duke vënë në zbatim sisteme ujësjellës-kanalizimesh të përbalueshme dhe të kombinuara që garantojnë rikuperim të kostove përmes tarifave; ii. përmirësimi i rrjeteve të kanalizimeve dhe i performancës së impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura.

Treguesit kyç të performancës:

- mbulimi në % i kostove operacionale (arkëtimi direkt i kostove operacionale) në ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve;

- popullata totale me lidhje efektive në sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura me sisteme trajtimi të centralizuara (urbane/rurale), monitoruar në përputhje me direktivat e BE-së.

2. Supozime dhe kushte

Supozohet se: i. Programi Kombëtar Sektorial miratohet, Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore dhe Strategjia Sektoriale e Ujësjellës-Kanalizimeve zbatohen; ii. përfshirja dhe angazhimi i palëve të interesuara vazhdon dhe koordinimi ndërministror lidhur me sektorin e ujit është efektiv; iii. përgjegjësitë ndërmjet Agjencisë për Menaxhimin e Burimeve Ujore, Ministrisë së Energjetikës dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me ujërat e ndotura qartësohen; iv. angazhimi në mbështetje të zbatimit të menaxhimit të integruar të ujit dhe zhvillimi i infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve vazhdon; v) administrata bashkiake dhe drejtimi i ndërmarrjeve ka kapacitete personeli të mjaftueshme; vi. popullatat përfituese dhe qeverisja vendore paguajnë për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve në përputhje me parimin “ndotësi pagan”; vii. institucionet që përfitojnë direkt kanë kapacitete të mjaftueshme, përfshirë personel drejtues financiar të kualifikuar në ndërmarrjet, si dhe kapacitetet planifikuese dhe programuese të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve në nivel qendror sigurohen dhe janë funksionale; viii. akti normativ për trajtimin e ujërave të ndotura urbane miratohet dhe zbatohet në mënyrë strategjike, si edhe përgatitet një listë projektet prioritare dhe miratohet për financim; ix. miratohen studime fizibiliteti dhe projekte; miratohen marrëveshjet e pronësisë mbi tokën, planifikimin dhe ndërmarrjet dhe lëshohen lejet e

ndërtimit; xi. personeli i shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura caktohen/sigurohen.

Zbatimi i masës kërkon si kusht përfundimin e metodologjisë së përzgjedhjes, si edhe aplikimin e plotë dhe transparent për miratim nga bashkitë/ndërmarrjet. Përzgjedhja bazohet në listën prioritare të investimeve të masterplanit kombëtar. Ato i janë nënshtruar një prioritizimi, që është miratuar nga të gjitha grupet e interesit të sektorit. Përveç kësaj, do të aplikohen kritere specifike dhe “filtra performance”. Janë përzgjedhur dhjetë ndërmarrje prioritare mbi bazën e dy misioneve faktmbledhëse të porositura nga KfW-ja dhe sipas metodologjisë së përzgjedhjes dhe maturitetit të projekteve (përfshirë Berat–Kuçovë, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Lushnjë, Sarandë, Shkodër, Kamzë dhe Vlorë), vendndodhja përfundimtare e projekti dhe objekti do të përcaktohet bazuar në studimet e fizibilitetit që janë në proces.

Mekanizmi përzgjedhës transparent dhe kriteret kyçe të përzgjedhjes do të shtjellohen më tej në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet përgjegjëse shqiptare si edhe në konsultim të ngushtë me institucionet financuese (KfW, SECO⁵¹, BE) për përgatitjen e programit.

Kriteret kyçe për përzgjedhjen e bashkive përfituese shtesë nga një listë bashkish përfituese potenciale e nxjerrë nga lista e projekteve prioritare të Masterplanit Kombëtar të Ujësjiellës-Kanalizimeve do të mbulojnë aspekte të shumta dhe do të specifikohen në marrëveshjen e delegimit.

Disa aspekte kyçe për t'u pasur parasysh janë:

vendndodhja në klasterat bregdetare të bashkive⁵² (motori i zhvillimit ekonomik);

Plotësimi/rritja e investimeve të kaluara për ujësjiellës-kanalizimet të dhëna nga BE-ja apo donatorë të tjerë, që janë pjesërisht joefektive për shkak të sistemeve të paplota;

Situata e dobët në mjedis/shëndet publik, sidomos në bashki dhe qyteza, si edhe aftësia për të ndikuar pozitivisht në cilësinë e ujërave bregdetare të Adriatikut dhe Jonit;

Efikasitet minimal të pranueshëm për arkëtimin e tarifës dhe mbulimit të Kostove Direkte Operacionale;

Tarifë e përballueshme, përfshirë për grupet në nevojë/popullatat më të varfra;

Kontribut në modelin e ekselencës për ndërmarrjet (orientuar drejt performancës, ndërkombëtarizim i reformës territoriale/agregimi i ndërmarrjeve, autorësia/nxitja bashkiake;

Sipas rastit, ndikim ndërkufitar pozitiv i investimeve.

Dokumentacioni i bashkive/ndërmarrjeve të përzgjedhura duhet të japë evidenca për: i. nivelin e trajtimit dhe proceset/teknologjitë e trajtimit që duhen vënë në zbatim për të balancuar rentabilitetin e investimeve dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm me nevojën për të avancuar të paktën në përmbushjen e kriterëve të Direktivës për Trajtimin e Ujërave të ndotura Urbane; ii. uljen e pritshme të ndotjes së ujërave që shkarkohet në trupat ujorë; dhe ii. përmirësimin e pritshëm të cilësisë së ujit; iii. llogaritjen e hendekut financues CAPEX për të justifikuar financimin me grant si dhe rilëvrimin e fondeve nga grantet (BE, SECO, KfW dhe të tjerë).

Mosrespektimi i kërkesave më lart mund të çojë në rikuperimin e fondeve nën këtë program dhe/ose rialokimin e financimeve në të ardhmen.

3. Mënyrat e zbatimit

3. a) Menaxhim indirekt me organizatën e një shteti anëtar të BE-së

Masa mund të zbatohet me menaxhim indirekt me Kreidenstalt für Wiederaufbau (KfW).

Kjo mënyrë zbatimi është zgjedhur për të rritur koordinimin dhe efektivitetin e ndihmës së donatorëve dhe për të përfituar nga avantazhi krahasues dhe ekspertiza e zhvilluar në sektor në lidhje me infrastrukturën bashkiake dhe qasjet me bazë performance në Shqipëri. Për më tepër, mundëson rritje të mekanizmave për përthithje fondesh duke ndërthurur huat dhe grantet për financimin e investimeve, të cilat do të nxitin zhvillimin e infrastrukturës dhe do t'i shtojnë vlerë efektivitetit të fondeve të BE-së.

Kriteret e përzgjedhjes ishin: i. mandati ndërkombëtar i subjektit potencial të deleguar; ii. prania dhe përvoja e subjektit potencial të deleguar në sektorin e ujit, sidomos në Shqipëri (përfshirë vëllimet e asistencës në sektor dhe asistencën e projektuar në të ardhmen e afërt); iii. ekspertiza teknike,

⁵¹ SECO: Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike i Zvicrës.

⁵² Përfshirë zonat si Velipojë, Lezhë/Shëngjin, Durrës, Kavajë, Vlorë, Ksamil dhe Sarandë, Orikum, por edhe Divjakë, Spille, si dhe rivierën e detit Jon nga Dhërmiu në Sarandë.

kapacitetet logjistike dhe meanxhuese të subjektit potencial të deleguar, përfshirë në nivel vendor; iv. ndikimi, rezultatet dhe efekti multiplikues i bashkëpunimit me subjektet/donatorët e tjerë, që mbulon edhe efektivitetin e delegimit të detyrave, përfshirë në Shqipëri; v. vlera e shtuar e masave në sektorin e ujit nën zbatim nga subjekti potencial i deleguar apo të planifikuara për të ardhmen e afërt, si edhe sinergjitë e parashikuara apo të propozuara me programin IPA 2018; dhe vi. ulja e nivelit të kostove për transaksionet nga subjekti potencial i deleguar.

Zbatimi nga subjekti përfshin kryerjen e të gjitha detyrave lidhur me zbatimin e masës. Në veçanti, subjekti i ngarkuar do të jetë përgjegjës për kontraktimin, zbatimin, informimin dhe vizibilitetin, monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve të IPA II, si edhe vlerësimin e tyre kurdo që nevojitet, në respektim të parimit të menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe për garantimin e ligjshmërisë dhe rregullsisë së shpenzimeve që bëhen për zbatimin e programit.

Nëse bisedimet me KfW dështojnë, kjo pjesë e Masës mund të zbatohet me menaxhim indirekt me një subjekt që përzgjidhet prej Komisionit bazuar në këto kritere: i. prania dhe përvoja e subjektit potencial të deleguar në sektorin e ujit, përfshirë në Shqipëri; ii. ekspertiza teknike, kapacitetet logjistike dhe menaxhuese të subjektit potencial të deleguar; iii. ndikimi, rezultatet dhe efekti multiplikues i bashkëpunimit me subjektet/donatorët e tjerë, që mbulon edhe efektivitetin e delegimit të detyrave, përfshirë në Shqipëri; iv. vlera e shtuar e masave në sektorin e ujit nën zbatim nga subjekti potencial i deleguar apo të planifikuara për të ardhmen e afërt, si edhe sinergjitë e parashikuara apo të propozuara.

Nëse përzgjedhja e një subjekti apo bisedimet me subjektin/et potencial/e të deleguar dështojnë, një pjesë e kësaj mase mund të zbatohet me menaxhim direkt në përputhje me mënyrat e zbatimit të specifikuar në seksionin 3 (b).

3. b) Menaxhim direkt nga Delegacioni i BE-së

Prokurimi

Zarfi buxhetor global i rezervuar për prokurimin: 24 100 000 EUR

4. Kriteri gjeografik për pjesëmarrjen në prokurime dhe grante

Kriteri gjeografik lidhur me selinë (vendosjen) e subjekteve zbatohet në lidhje me pjesëmarrjen në prokurime dhe procedurat e dhënies së granteve, si edhe në lidhje me origjinën e furnizimeve që blihen dhe që evidentohen në aktin themelor dhe në dokumentet kontraktuale përkatëse.

Zyrtari përgjegjës autorizues i Komisionit mund të zgjerojë kriterin gjeografik në raste urgjente apo kur produktet dhe shërbimet nuk gjenden në tregjet e vendeve përkatëse apo në raste të justifikuara shterueshëm ku kriteret e aplikimit e bëjnë realizimin e kësaj mase të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë.

SEKTORI	KONKURRUESHMËRIA, NOVACIONI, BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL		6 000 000 EUR
Veprimi 5	BE-ja për zhvillim ekonomik – zhvillimi ekonomik vendor i orientuar drejt turizmit me fokus te trashëgimia kulturore:	Menaxhim indirekt me BERZH-in	6 000 000 EUR

1. Përshkrimi i masës, objektivit, rezultateve të pritshme dhe treguesve kyç të performancës

- Përshkrimi i masës dhe objektivave

Në përputhje me objektivin e Dokumentit i Treguesit Strategjik, kjo masë është ideuar që të mbështetë zhvillimin ekonomik, social dhe territorial të vendit. Kjo masë do të kontribuojë në arritjen e objektivit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për të mbështetur një industri turizmi të njohur dhe tërheqëse.

Objekti i përgjithshëm i masës është të rritë kontributin e turizmit cilësor dhe të qëndrueshëm në rritjen ekonomike dhe konkurrueshmërinë e rajoneve shqiptare.

Objekti i specifik i masës është të ruajë dhe të konsolidojë atraktivitetin e pasurive të trashëgimisë kulturore në një zonë të synuar.

- Rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

Rezultatet e pritshme përfshijnë: i. trashëgimi kulturore e ruajtur dhe e restauruar në zonën e synuar; ii. aksesueshmëri e përmirësuar dhe qëndrueshmëri e konsoliduar e trashëgimisë kulturore; iii. aftësi të përmirësuara të ekspertëve në ruajtjen, restaurimin dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore.

Treguesit kyç të performancës:

numri i turistëve që frekuentojnë pasuritë e trashëgimisë kulturore/natyrore në destinacionet e synuara në vit.

2. Supozime dhe kushte

Zbatimi i masës kërkon miratimin e Strategjisë Kombëtare të Turizmit dhe Strategjisë për Kulturën. Mosrespektimi i kërkesave më lart mund të çojë në rikuperimin e fondeve nën këtë program dhe/ose rialokimin e financimeve në të ardhmen.

Supozimet për këtë masë janë: i. rezultatet/objektivat e Strategjisë Kombëtare për Përshtatjen dhe Ndryshimet Klimatike lidhur me efektet negative të ndryshimeve klimatike merren parasysh; ii. një Komitet Drejtues ndërmarrës do të krijohet me përfshirjen e grupeve të interesit dhe Ministria e Kulturës do të shërbejë si Sekretariat Teknik; iii. mobilizimi i grupeve të interesit në territoret e synuara, përfshirë autoritetet vendore, shoqërinë civile dhe sektorin privat, është efektiv; iv. pasuritë e trashëgimisë kulturore të restauruara me ndërhyrjet nën IPA II vazhdojnë të mirëmbahen dhe të ruhen prej përfituesve.

Mosrespektimi i kërkesave më lart mund të çojë në rikuperimin e fondeve nën këtë program dhe/ose rialokimin e financimeve në të ardhmen.

3. Mënyrat e zbatimit:

3. a) Menaxhim indirekt me një organizatë ndërkombëtare

Kjo Masë mund të zbatohet me menaxhim indirekt me Bankën Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim (BERZH).

Kjo mënyrë zbatimi është zgjedhur për të rritur koordinimin dhe efektivitetin e ndihmës së donatorëve dhe për të përfituar nga avantazhi krahasues dhe ekspertiza e zhvilluar në sektor. Përfituesi ka nevojë për mbështetje praktike nga një partner institucional homolog me përvojë menaxhimi projektesh në sektor. Për më tepër, BERZH-i posedon: a) mandatin për të promovuar potencialet e sipërmarrjes dhe zhvillimit ekonomik; b) ekspertizë specifike në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, konkurrueshmërisë dhe mjedisit mundësues për biznesin që synohet në kontekstin e zonës së trashëgimisë kulturore; c) prani afatgjatë në vend për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të mbështetur shërbimet këshillimore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të); dhe ka Strategji Kombëtare të miratuar në vitin 2016.

Në krahasim me subjektet e tjera, vlera e shtuar e bashkëpunimit me BERZH-in, do të jetë: a) akses në Kuadrin e Investimeve të Ballkanit Perëndimor për asistencë teknike dhe studime fizibiliteti të nevojshme për këtë apo të tjera investime; b) akses në kompetenca për konkurrueshmëri dhe investime lidhur me turizmin dhe trashëgiminë kulturore; c) përfitime efikasiteti për shkak të koordinimit dhe kapaciteteve të dislokuara për zbatimin e IPA 2017; d) absorbim më i mirë i produkteve dhe programeve IPA dhe lidhje më e mirë e tyre me mbështetjen për konkurrueshmërinë, biznesin e vogël, efikasitetin e energjisë dhe mjedisin.

Kriteret e përzgjedhjes ishin: i. mandati ndërkombëtar i subjektit; ii. prania dhe përvoja e subjektit në sektorin e turizmit dhe zhvillimit vendor (që zhvillohet në kontekstin e trashëgimisë kulturore) dhe sidomos në Shqipëri (përfshirë vëllimet e asistencës në sektor dhe asistencën e projektuar në të ardhmen e afërt); iii. ekspertiza teknike, kapacitetet logjistike dhe menaxhuese të subjektit, përfshirë në nivel vendor; iv. ndikimi, rezultatet dhe efekti multiplikues i bashkëpunimit me masat e tjera (koordinimi me programin IPA 2017) dhe me subjektet/donatorët e tjerë, që mbulon edhe efektivitetin e delegimit të detyrave, përfshirë në Shqipëri; v. vlera e shtuar e masave nën zbatim nga subjekti në sektor apo të planifikuara për të ardhmen e afërt; dhe vi. ulja e nivelit të kostove për transaksionet nga subjekti.

Zbatimi nga BERZH-i përfshin kryerjen e të gjitha detyrave lidhur me zbatimin e masës. Në veçanti, subjekti i ngarkuar do të jetë përgjegjës për kontraktimin, zbatimin, informimin dhe vizibilitetin, monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve të IPA II, si edhe vlerësimin e tyre kurdo që nevojitet, në respektim të parimit të menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe për garantimin e ligjshmërisë dhe rregullsisë së shpenzimeve që bëhen për zbatimin e programit.

Nëse bisedimet me BERZH-in dështojnë, kjo pjesë e masës mund të zbatohet me menaxhim indirekt me një subjekt që përzgjidhet prej Komisionit bazuar në këto kriteret: i. prania dhe përvoja e subjektit në sektorin e turizmit dhe zhvillimit vendor, përfshirë në Shqipëri; ii. ekspertiza teknike, kapacitetet logjistike dhe menaxhuese të subjektit; iii. ndikimi, rezultatet dhe efekti multiplikues i

bashkëpunimit me masat e tjera dhe subjektet/donatorët e tjerë; iv. vlera e shtuar e masave në sektor nga subjekti, apo të planifikuara për të ardhmen e afërt.

Nëse përzgjedhja e një subjekti apo bisedimet me subjektin/et potencial/e të deleguar dështojnë, një pjesë e kësaj mase mund të zbatohet me menaxhim direkt në përputhje me mënyrat e zbatimit të specifikuara në seksionin 3(b).

3. b) Menaxhim direkt nga Delegacioni i BE-së

Prokurimi

Zarfi buxhetor global i rezervuar për prokurimin: 6 000 000 EUR.

4. Kriteri gjeografik për pjesëmarrjen në prokurime dhe grante

Kriteri gjeografik lidhur me selinë (vendosjen) e subjekteve zbatohet në lidhje me pjesëmarrjen në prokurime dhe procedurat e dhënies së granteve, si edhe në lidhje me origjinën e furnizimeve që blihen dhe që evidentohen në aktin themelor dhe në dokumentet kontraktuale përkatëse.

Zyrtari përgjegjës autorizues i Komisionit mund të zgjerojë kriterin gjeografik në raste urgjente apo kur produktet dhe shërbimet nuk gjenden në tregjet e vendeve përkatëse, apo në raste të justifikuara shterueshëm ku kriteret e aplikimit e bëjnë realizimin e kësaj mase të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë.

3. BUXHETI (SHUMAT NË MILION EURO)

3.1 TABELA TREGUESE E BUXHETIT – PROGRAMI I MASAVE PËR SHQIPËRINË PËR VITIN 2018

		Menaxhim indirekt		Menaxhim direkt	Totali i kontributit të BE-së (EUR)	Kontribut nga përfituesi i IPA II ose palë e tretë (EUR)	Totali (EUR)
		Me përfitues IPA II	Me subjektin e ngarkuar				
		Kontributi i BE-së (EUR)	Kontributi i BE-së (EUR)	Kontributi i BE-së (EUR)			
Objektivi 1 2008/040 211	01: Demokracia dhe qeverisja	3 000 000	0	0	3 000 000	1 263 671	4 263 671
	Veprimi 1: Mbështetje e BE-së për pjesëmarrjen në programet dhe agjencitë e BE-së	3 000 000	0	0	0	1 263 671	4 263 671
	02: Shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore	0	11 500 000	49 500 000	61 000 000	350 000	61 350 000
	Veprimi 2: BE-ja për shtetin e së drejtës – lufta kundër krimit të organizuar dhe drogës	0	11 500 000	7 500 000	19 000 000	350 000	19 350 000
	Veprimi 3: BE-ja për reformën në drejtësi	0	0	42 000 000	42 000 000	0	42 000 000
Objektivi 2 2018/040 215	03: masa për mjedisin dhe klimën	0	24 100 000	0	24 100 000	56 700 000	80 800 000
	Veprimi 4: BE-ja për mjedis më të pastër – mbështetje për trajtimin e ujërave të ndotura	0	24 100 000	0	24 100 000	56 700 000	80 800 000
	06: Konkurrueshmëria dhe novacioni	0	6 000 000	0	6 000 000	0	6 000 000
	Veprimi 5: BE-ja për zhvillim ekonomik – zhvillimi ekonomik vendor i orientuar drejt turizmit me fokus te trashëgimia kulturore	0	6 000 000	0	6 000 000	0	6 000 000
	TOTAL	3 000 000	41 600 000	49 500 000	94 100 000	58 313 671	152 413 671

4. MËNYRAT E MONITORIMIT TË PERFORMANCËS

Në kuadrin e matjes së performancës, Komisioni do të monitorojë dhe do të vlerësojë progresin drejt arritjes së objektivave specifike të përcaktuar në rregulloren IPA II mbi bazën e treguesve të paracaktuar, të qartë, transparentë dhe të matshëm. Raportet e progresit të parashikuara në nenin 4 të rregullores IPA II do të merren si pikë referimi për vlerësimin e rezultateve të asistencës IPA II.

Komisioni do të mbledhë të dhënat e performancës (treguesit e proceseve, kontributeve dhe rezultateve) nga të gjitha burimet, të cilat konsolidohen dhe vlerësohen për të gjurmuar progresin e bërë përkundrejt objektivave dhe parametrave të përcaktuar për secilën masë të këtij programi, si edhe Dokumentin e Treguesit Strategjik.

Në kontekstin specifik të menaxhimit indirekt nga përfitues IPA II, Koordinatorët Kombëtarë IPA II (KKIPA-t) do të mbledhin informacion mbi performancën e masave dhe programeve (treguesit e proceseve, kontributeve dhe rezultateve) dhe do të koordinojnë mbledhjen dhe prodhimin e treguesve që vijnë nga burimet kombëtare.

Progresi i përgjithshëm do të monitorohet përmes këtyre mjeteve: a) sisteme Monitorimi të Orientuara drejt Rezultateve (MOR); b) vetëmonitorimi i përfituesve IPA II; vetëmonitorimi i kryer nga delegacionet e BE-së; c) monitorimi i përbashkët nga DP-ja e zgjerimit dhe Përfituesit IPA II, ku do të monitorohet sistematikisht nga një Komitet Monitorimi IPA përputhshmëria, koherenca, efektiviteti, efikasiteti dhe koordinimi në zbatim i asistencës financiare, i mbështetur nga Komitete Monitorimi Sektoriale, që do të garantojnë një proces monitorimi në nivel sektorial.

5. VLERËSIMI

Nisur nga rëndësia e masës, mund të kryhet një vlerësim i ndërmjetëm, përfundimtar apo *ex post* i masës apo komponentëve të saj nga konsulentë të pavarur, përmes një misioni të përbashkët apo një partneri zbatimi. Vlerësimi kryhet për qëllime llogaridhënieje dhe nxjerrje mësimesh në nivele të ndryshme (edhe për rishikimin e politikave), duke pasur parasysh sidomos faktin që gjetjet mund të ndihmojnë në përgatitjen e aktiviteteve të reja në të njëjtët sektorë.

Nëse nuk parashikohet vlerësim, Komisioni mund të vendosë që gjatë zbatimit të ndërmarrë një vlerësim të tillë për arsye të justifikuara shterueshëm, ose me vendim të vet kryesisht, ose me nismën e partnerit.

Raportet e vlerësimit vihen në dispozicion të përfituesit IPA II dhe të grupeve të tjera të interesit. Partneri i zbatimit dhe Komisioni analizojnë përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, sipas rastit, vendosin bashkërisht dhe në marrëveshje me përfituesin IPA II për masat ndjekëse që duhen ndërmarrë dhe për modifikime të nevojshme, përfshirë këtu edhe riorientimin e projektit nëse duhet.

